
BULETIN INFORMATIV

JANAR 2026

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Janar, 2026

Përmbajtje

Aktivitete	7
Redaksia qendrore miratoi fjalësin përfundimtar të projektit “Enciklopedia shqiptare”	8
U zhvillua veprimtaria “Ismail Kadare në 90-vjetorin e lindjes”	10
Përkujtojmë me nderim shkrimtarin akademik Ismail Kadare në 90-vjetorin e lindjes.....	14
Fjala përshëndetëse e Kryesisë së Akademisë së Shkencave në promovimin e veprës “Kadareja në kritikën botërore” në 90-vjetorin e lindjes së shkrimtarit akademik	16
U mbajt konferenca shkencore "Tish Daija në 100 vjetorin e lindjes"	19
U përurua botimi shkencor "Vepra të zgjedhura në fushën e sizmologjisë" me autor akademik Eduard Sulstarova	23
Akademiku Albert Doja publikon një sintezë shkencore mbi arritjet e fundit në modelet strukturale shpjegimore të antropologjisë në Enciklopedinë e Sistemeve Matëse në Shkencat Sociale.....	27
 Mbledhja e komisioneve të përhershme pranë ASH.....	30
Komisioni i Përhershëm i Arkeologjisë realizon analizën e punës për vitin 2025 dhe projeksionet për vitin 2026	31
Komisioni i Përhershëm i Arteve zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive për vitin 2025 dhe propozimet për vitin 2026	35
Komisioni i mjekësisë zhvilloi takimin për analizën vjetore të punës për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026	37
Komisioni i Matematikë-Informatikës realizoi analizën për vitin 2025 dhe projektet për vitin 2026.....	40
Komisioni i historisë zhvilloi takimin për analizën e punës për vitin 2025 dhe propozimet për vitin 2026	43

Komisioni i Inxhinierisë prezantoi çështjet kryesore të analizës së punës vjetore të vitit 2025 dhe veprimtarive të vitit 2026.....	47
Komisioni fizikë-kimi prezantoi çështjet kryesore të analizës së punës vjetore të vitit 2025 dhe veprimtarive të vitit 2026.....	50
U zhvillua mbledhja e Komisionit të përhershëm të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.....	53
Mbledhje të Instituteve dhe Qendrave.....	55
Instituti i arkeologjisë zhvilloi takimin për analizën e punës vjetore për vitin 2025 dhe projektet e vitit 2026	56
Instituti i Antropologjisë zhvilloi mbledhjen për analizën e punës kërkimore-shkencore të vitit 2025 dhe projeksionet kryesore për vitin 2026.....	60
Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë zhvilloi takimin për analizën e punës për vitin 2025 dhe projektet për vitin 2026	63
Instituti i Historisë zhvilloi takimin për analizën vjetore të punës dhe projektet për vitin 2026.....	67
Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të vitit 2025 dhe projeksionet e vitit 2026.....	71
Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës zhvilloi takimin për analizën vjetore të punës dhe projektet për vitin 2026	75
Qendra e Studimit të Arteve zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të vitit 2025 dhe projeksionet e vitit 2026	79
Qendra e Projekteve dhe e Koordinimit të Kërkimit Shkencor zhvilloi takimin për analizën e punës për vitin 2025 dhe planin e punës për vitin 2026	81
Qendra kërkimore e nanoteknologjisë NanoAlb zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të vitit 2025 dhe projeksionet e vitit 2026.....	84
Njësia Kërkimore e Inteligjencës Artificiale zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të vitit 2025 dhe projeksionet e vitit 2026.....	86
Njësia Kërkimore e Gjeoshkencave dhe Gjeoinxhinierive zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të vitit 2025	88
Nxjtja e interesit të brezave të rinj për matematikën mbetet një nga synimet e punës së Institutit Kombëtar të Matematikës.....	91
Veprimtaria e Bibliotekës Shkencore dhe Qendrës për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor të ASHSH për vitin 2025	93

Të tjera.....92

Akademia e Shkencave uron në ditën e tij të lindjes shkrimtarin dhe akademikun e saj
Fatos Kongoli 96

Akademia e Shkencave uron në datën e tij të lindjes albanologun Bernd Jürgen
Fischer.....98

Akademia e Shkencave uron në datën e tij të lindjes albanologun Titos Jochalas 100

In memoriam.....102

Kujtojmë Gjergj Kastriot Skënderbeun, një nga figurat më mëdha të historisë
shqiptare dhe të Europës së shekullit XV 103

Sot, kujtojmë ditëlindjen e Ismail Qemalit, udhëheqës i Lëvizjes Kombëtare
Shqiptare.....105

Akademia e Shkencave përkujton me nderim në 10-vjetorin e ndarjes nga jeta
akademik Kristo Frashërin..... 107

Përkujtojmë akademik Besim Dajën në ditën e lindjes..... 110

Përkujtojmë në ditën e lindjes poetin, shkrimtarin dhe dramaturgun e shquar Viktor
Eftimiu 112

Përkujtojmë në ditën e lindjes regjisorin dhe skenaristin e shquar Dhimitër
Anagnostin 114

Përkujtojmë në ditën e lindjes Elena Gjickën, personalitet i ndritur i periudhës së
Rilindjes Kombëtare..... 116

Përkujtojmë në ditën e lindjes Xhorxh Gordon Bajronin, shkrimtarin romantik anglez,
mik i shqiptarëve 118

Kujtojmë në ditën e lindjes, fizikanen, akademikën e asociuar Afërdita Veveçka 120

Përkujtojmë në ditën e lindjes akademik Kristaq Priftin..... 122

Akademia e Shkencave përkujton presidentin historik të Kosovës Ibrahim Rugovë në
20-vjetorin e ndarjes nga jeta 124

Përkujtojmë në ditën e lindjes akademik Farudin Hoxhën, projektues i disa veprave
madhështore të energjitikës në Shqipëri..... 126

Përkujtojmë në ditën e lindjes shkrimtarin, përkthyesin dhe intelektualin e shquar
Skënder Petro Luarasin 128

Përkujtojmë në ditën e lindjes akademik Teki Tartarin.....	130
Përkujtojmë në ditën e lindjes veprimtarin e shquar të Rilindjes Kombëtare Bajram Curri.....	132
Akademia e Shkencave kujton me nderim shkrimtarin dhe përkthyesin Ernest Koliqi.....	134
Akademia e Shkencave kujton me nderim akademik Eduart Sulstarovën	136
Akademia e Shkencave kujton me nderim akademik Ylli Popën në ditën e lindjes.....	137
Ndahet nga jeta akademik Nexhat Daci, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë	138

Aktivitete

Redaksia qendrore miratoi fjalësin përfundimtar të projektit “Enciklopedia shqiptare”

Në datën 28 janar 2026 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u mbajt takimi i parë me anëtarët e redaksisë qendrore Tiranë-Prishtinë për vitin 2026.

Mbledhja u drejtua nga kryeredaktori i “Enciklopedisë shqiptare” akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe zv.kryeredaktori akad. Mehmet Kraja, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës.

Ishin të pranishëm akad. Shaban Sinani, akad. Marenglen Verli, akad. Dhimitër Haxhimihali, akad. Sabri Hamiti, akad. Fejzulla Krasniqi, akad. Jusuf Bajraktari, prof. dr. Ajula Jubani, prof. dr. Valbona Toska, drejtori i Qendrës së Botimeve Albanologjike dhe Enciklopedike, z. Andreas Dushi dhe koordinatore Drisela Diamanti e Enkelejdë Misha.



Akad. Skënder Gjinushi, pasi u uroi mirëseardhjen të pranishmëve, u shpreh se materiali i paraqitur për miratim është përgatitur në zbatim të detyrave e rekomandimeve të përcaktuara nga redaksia qendrore në dy mbledhjet e mëparshme për paraqitjen dhe shqyrtimi e fjalësve përfundimtarë.

Akad. Mehmet Kraja falënderoi redaktorët e redaksive Tiranë-Prishtinë për bashkëpunimin e ngushtë, përgatitjen e mirë të takimit, dhe përgatitjen e mirë të materialeve përcjellëse. Ai informoi se janë realizuar tre takime të ndara për hartimin e teksteve model për artikujt e rezultatet duken pozitive.



Më tej, sipas rendit të ditës u shqyrtuan e miratuan fjalësit e fushave të plotësuar me saktësimet e propozimet e dakortësuara me redaksitë e fushave në plotësim të rekomandimeve të Redaksisë Qendrore, sipas parashtrimeve nga QBEA.


Me këtë miratim u përmbyll procesi i hartimit të fjalësit të “Enciklopedisë shqiptare”, për të kaluar në fazën e përcaktimit të madhësisë së artikujve e të autoreve deri në fund të marsit e pas kësaj fillon shkrimi i artikujve. Gjatë kësaj kohe, do të evidentohen dublimet në fjalës dhe do të sistemohet alfabetikisht e tërë lënda.

Në fund u paraqit dhe u diskutua projekt-kalendari i punës për vitin 2026.



U zhvillua veprimtaria “Ismail Kadare në 90-vjetorin e lindjes”

Në këtë ditë të shënuar Akademia e Shkencave botoi dhe promovoi veprën me tri volume "Kadareja në kritikën botërore"-



Veprimtaria u zhvillua në datën 28 janar 2026 me pjesëmarrjen e kryetarit të ASHSH-së akad. Skënder Gjinushi; zv. kryetarit të ASHSH-së akad. Vasil Tole; kryetares së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës akad. Justina Shiroka - Pula; sekretares shkencore akad. Anila Hoda dhe akademikëve, studiuesve e miqve të letërsisë.

Veprimtarinë e hapi akad. Anila Hoda. Ajo falënderoi pjesëmarrësit dhe organizatorët dhe i uroi punime të mbara konferencës.

Akad. Gëzim Hoxha mbajti fjalën përshëndetëse në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave. Ai tha se promovimi i veprës madhore me tri volume “Kadareja në kritikën botërore” përfaqëson një moment të rëndësishëm jo vetëm për studimet letrare shqiptare, por edhe për afirmimin ndërkombëtar të kulturës sonë. Akademia e Shkencave e Shqipërisë e konsideron këtë jubile si një akt kujtese kulturore, por njëkohësisht edhe si një përgjegjësi shkencore: përgjegjësinë për të studiuar,

sistemuar dhe transmetuar trashëgiminë intelektuale të një autori që i ka dhënë identitet dhe dinjitet letërsisë sonë në botë.



Akad. Justina Shiroka Pula përshëndeti në emër të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ajo tha se botimi në tri vëllime “Kadareja në kritikën letrare botërore” pasuron studimet letrare shqiptare dhe njëkohësisht shërben si një dëshmi e fuqishme e pranisë dhe e vlerësimit të veprës së Kadaresë në mendimin letrar ndërkombëtar.

Më tej ajo u ndal në raportin e Kadaresë me Kosovën. Për Kadarenë, Kosova ka qenë dhe mbetet një pjesë e pandashme e ndërgjegjes kombëtare shqiptare. Si intelektual me autoritet të lartë letrar dhe moral, Ismail Kadareja e bëri çështjen e Kosovës të pranishme në një dimension më të gjerë ndërkombëtar, duke denoncuar dhunën, mohimin e të drejtave dhe përpjekjet për shuarjen e identitetit shqiptar.

Studiuesi dhe profesori Pirro Misha e vlerësoi tërësinë e veprës së Ismail Kadaresë si një monument të pazëvendësueshëm për kulturën kombëtare dhe si pjesë të identitetit tonë kombëtar. Ai falënderoi Akademinë e Shkencave për festimin e veçantë të ditëlindjes me promovimin e veprës "Kadareja në kritikën botërore" dhe autorin Bashkim Kuçuku.



Z. Bujar Hudhri, botuesi i veprave të Kadaresë, foli për kujtimet që e lidhin me shkrimtarin. Ai e vlerësoi Kadarenë për personalitetin e tij të veçantë dhe u ndal në takimet e bisedat e viteve të fundit. Ai shprehu kënaqësinë dhe mirënjohjen e thellë për shkrimtarin që kishte një qëndrim miqësor dhe një nderim të veçantë për lexuesit. Në fund ai foli për projektet e reja, të cilat synojnë të shtojnë rrjetin e lexuesve ndërkombëtarë të veprave të Kadaresë.

Akad. Floresha Dado mbajti kumtesën me temën “Filozofia e veprës së Kadaresë: intuitë artistike dhe vetëdije shkencore”. Ajo e vlerësoi veprën e Kadaresë si shkencë të jetës dhe të shpirtit njerëzor dhe bëri një vështrim të thelluar të dukurive në procesin krijues, duke e vënë theksin në qasjen origjinale të Kadaresë ndaj mendimit shkencor. Krijimtarinë e Kadaresë akad. Dado e vlerësoi si dëshmi të një mendjeje shumëplanëshe, ku figura e trillimit dhe logjika e mendimit nuk do të mund të qëndronin veçmas, të dyja formësojnë njëra-tjetrën. Më tej ajo paraqiti një analizë të detajuar të strukturave përgjithësuese tematike e artistike të veprës së Kadaresë.

Prof. dr. Persida Asllani vlerësoi këmbënguljen e admirueshme të prof. Bashkim Kuçukut, që përkon natyrshëm me vetëdijen e Akademisë së Shkencave për t’i bërë pjesë të leximeve kritike në mbarë botën shqiptare e kudo tjetër përvojat e larmishme kritike të leximit dhe vlerësimit të veprës kadareane në mbi 50 vjet.

Ajo tha se sot ato vijnë me një kumbim të ri, në këtë homazh për shkrimtarin, por njëkohësisht dhe për autorët e këtij korpusi specifik, falë pasionit dhe punës së të cilëve mori udhë historia e gjatë e receptimit të veprës së Kadaresë, por edhe e Shqipërisë letrare në botë. Prof. dr. Asllani vuri në dukje se te ky korpus kritik në gjuhë të huaj gjetën shprehjen më të mirë leximet dhe interpretimet në liri të një vepre që shkruhej

paradoksalisht në mungesë të saj. Shkrimtari që po zbulonin dinte ta rrëfente këtë me forcën e pashtershme që i falte liria brendashkruar letërsisë. “Liria ime ka qenë letërsia” u pohoi ai sapo mundi të gjithëve.

Akad. Matteo Mandalà mbajti kumtesën “Kur Kadareja fliste italisht”. Ai u ndal në rezultatet e studimeve të kryera gjatë këtyre dhjetëvjeçarëve të fundit në Itali. Ai tha se është më e rëndësishme të përqendrojmë vëmendjen te kundërvëniet e mirëfillta që vazhdojnë të karakterizojnë përkthimet e veprave të Kadaresë dhe natyrisht të kushtëzojnë receptimin dhe analizën kritike të tyre. Aspekt ky i fundit që “enciklopedia” e re e mikut dhe e kolegut të palodhshëm Bashkim Kuçuku shqyrton më së miri.



Në fund, prof. dr., autori i veprës "Kadareja në kritikën botërore", tha se metavepra kadareane tashmë është disa mijëra shkrime të llojeve më të ndryshme në gjuhën shqipe dhe në shumë gjuhë të tjera.

Ai e vlerësoi akad. Ismail Kadarenë si një shkrimtar me përmasa shekspiriane. Gjatë gjithë jetës së tij ai është vërtitur në orbitën e veprave të shkrimtarëve të mëdhenj të letërsisë europiane dhe botërore, sidomos të Eskilit, Dantes, Shekspirit, për të cilët ka shkruar edhe në një ese.

Prof. dr. Kuçuku foli më tej për përbashkësitë mes Shekspirit dhe Kadaresë, të cilat kanë qenë edhe objekt studimesh në gjuhën frënge; tema e pushtetit, krimet për ta fituar ose për ta mbajtur. Motivet dhe toposet e saj mitike, eskiliane, danteske, shekspiriane shpërfaqen gjerësisht edhe nëpërmjet trajtimit në veprën e tij.

www.akad.gov.al

Përkujtojmë me nderim shkrimtarin akademik Ismail Kadare në 90-vjetorin e lindjes



Ismail Kadare është shkrimtari më i mirë i letërsisë shqipe, ndër shkrimtarët më të mirë të letërsisë botërore bashkëkohore dhe autori më i përkthyer jashtë vendit, fitues i disa çmimeve letrare ndërkombëtare dhe i nominuar me dhjetëra herë për çmimin Nobel.

Në këtë ditë të shënuar Akademia e Shkencave e Shqipërisë organizon promovimin e veprës me tri volume “Kadareja në kritikën botërore”, në shenjë respekti dhe vlerësimi të trashëgimisë së jashtëzakonshme letrare dhe shkencore të shkrimtarit të madh Ismail Kadare.

Ai lindi më 28 janar 1936 në Gjirokastrë, ku përfundoi edhe arsimin e mesëm. Në vitin 1958 mbaroi degën e gjuhës e të letërsisë në Universitetin e Tiranës. Më pas shkoi në Moskë me studime për dy vjet në Institutin e Letërsisë Botërore "Maksim Gorki" (1958-1960).

Rrugën e krijimtarisë letrare e nisi si poet që në vitet e gjimnazit me “Frymëzimet djaloshare” (1954); “Ëndërrimet” (1957), por u bë i njohur sidomos me vëllimin “Shekulli im” (1961), që u pasua nga vëllimet e tjera poetike, si: “Përse mendohen këto male”

(1964), "Motive me diell" (1968) dhe "Koha" (1976).

Vepra e tij i ka kaluar me kohë kufijtë e Shqipërisë, të letërsisë dhe gjuhës shqipe, të botës shqiptare dhe është bërë pjesë cilësore në trashëgiminë e letërsisë botërore.

Letërsia e Ismail Kadaresë është botuar në 50 gjuhë dhe numri i titujve të botuar e ribotuar jashtë gjuhës amtare është mbi 1500. Vepra e tij studiohet në universitete në kuadër të historisë së letërsisë europiane dhe të asaj botërore. Shkencës së albanologjisë tashmë i është shtuar një degë e re, ajo e kadareologëve, e studiuesve dhe përkthyesve të veprës së tij. Nën ndikimin e kësaj dege të re edhe vendi i gjuhës shqipe në universitete është rritur me hapjen e katedrave dhe të njësive të reja, që nga Japonia në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që nga Franca në Rusi. Sot, vepra e Kadaresë përkthehet e studiohet edhe në ndonjë vend ku ka pasur kufizime.

Që nga viti 1994 ai është anëtar i Akademisë së Shkencave Morale dhe Politike të Francës dhe anëtar i jashtëm i ASHAK-ut.

Akademiku dhe shkrimtari i shquar shqiptar Ismail Kadare është fitues i çmimeve letrare më të rëndësishme në Europë e në botë: "International Booker Man Prize", "Prince of Asturias Award", "Jerusalem Prize", "Neustadt International Prize", "Nonino", "Park Kyong-ni".

Ai është dekoruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë me Urdhrin "Nderi i Kombit" dhe nga shteti francez me urdhrat "Kryqi i Legjionit të Nderit" e "Oficer i Legjionit të Nderit".

U nda nga jeta më 1 korrik 2024.

www.akad.gov.al

Fjala përshëndetëse e Kryesisë së Akademisë së Shkencave në promovimin e veprës “Kadareja në kritikën botërore” në 90-vjetorin e lindjes së shkrimtarit akademik

-Ismail Kadare është shkrimtari që i dha letërsisë shqipe një hapësirë të re universale. Ai arriti të shndërrojë historinë, mitin dhe kujtesën e një kombi të vogël në kategori estetike dhe morale me domethënie globale-

Në veprimtarinë e organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë për promovimin e veprës me tri volume “Kadareja në kritikën botërore” akad. Gëzim Hoxha, Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe albanologjike, mbajti fjalën përshëndetëse në emër të Kryesisë së ASHSH-së.



“Në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, kam nderin e veçantë t’ju përshëndes në këtë veprimtari solemne, kushtuar 90-vjetorit të lindjes së shkrimtarit të madh Ismail Kadare, një prej figurave më të ndritura të letërsisë evropiane dhe një zë unik i kulturës shqiptare në botë.

Promovimi i veprës madhore me tri volume “Kadare në kritikën botërore” përfaqëson

një moment të rëndësishëm jo vetëm për studimet letrare shqiptare, por edhe për afirmimin ndërkombëtar të kulturës sonë. Kjo vepër dëshmon se krijimtaria e Kadaresë nuk është thjesht objekt leximi, por një korpus i qëndrueshëm kritik, i pranishëm në tradita të ndryshme akademike dhe në gjuhët kryesore të kulturës botërore.

Ismail Kadare është shkrimtari që i dha letërsisë shqipe një hapësirë të re universale. Ai arriti të shndërrojë historinë, mitin dhe kujtesën e një kombi të vogël në kategori estetike dhe morale me domethënie globale. Vepra e tij flet për fatin e njeriut, për pushtetin dhe lirinë, për dhunën e historisë dhe qëndresën e shpirtit – tema që e vendosin atë natyrshëm në dialog me traditën e madhe evropiane, nga antikiteti e deri te moderniteti.

Në këtë kuptim, Kadareja nuk është vetëm një autor kombëtar i përkthyer në shumë gjuhë; ai është një shkrimtar botëror, i lexuar, i studiuar dhe i debatuar në universitete, akademi dhe qendra studimore anembanë globit. Kritika ndërkombëtare, e reflektuar në mënyrë sistematike në këto tre volume, e konfirmon këtë status dhe e vendos veprën e tij në një kontekst të qëndrueshëm krahasues me autorët më të mëdhenj të letërsisë bashkëkohore.



Programi shkencor i kësaj veprimtarie, me kontribute që trajtojnë dimensionin filozofik, kritik, gjuhësor dhe ndërkulturor të veprës kadareane, dëshmon për pluralitetin e leximeve dhe për vitalitetin e studimeve kadareane sot. Ai reflekton një hapësirë

dialogu mes shkollave kritike shqiptare dhe atyre evropiane, duke e forcuar më tej praninë e Kadaresë në horizontin e mendimit letrar ndërkombëtar.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë e konsideron këtë jubile si një akt kujtese kulturore, por njëkohësisht edhe si një përgjegjësi shkencore: përgjegjësinë për të studiuar, sistemuar dhe transmetuar trashëgiminë intelektuale të një autori që i ka dhënë identitet dhe dinjitet letërsisë sonë në botë.



Duke shprehur mirënjohjen tonë për autorët, studiuesit, botuesit dhe të gjithë bashkëpunëtorët që kanë kontribuar në realizimin e kësaj vepre përmbledhëse dhe të kësaj veprimtarie, ju ftoj ta shohim këtë përvjetor jo vetëm si një nderim për Ismail Kadarenë, por edhe si një ftesë për brezat e ardhshëm të studiuesve që ta lexojnë, ta rishikojnë dhe ta vendosin veprën e tij në dialog të vazhdueshëm me kulturën botërore. Ju faleminderit për vëmendjen dhe uroj që të kemi, sot dhe përherë, punime të frytshme e të suksesshme në kujtim të veprës së përjetshme të Ismail Kadaresë.

www.akad.gov.al

U mbajt konferenca shkencore "Tish Daija në 100 vjetorin e lindjes"

Veprimtaria për mjeshtrin e muzikës shqiptare, kompozitorin Tish Daija, u zhvillua më 30 janar 2026 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë nga Komisioni i Përkohshëm i Arteve në bashkëpunim me Qendrën e Studimit të Arteve, Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit dhe Universitetin e Arteve.

Konferencën e hapi akad. Stefan Çapaliku, drejtor i QSA-së. Ai tha se Tish Daija konsiderohet kompozitori i parë i baletit shqiptar me veprën "Halili dhe Hajria", që u ngjit në skenë në vitin 1963. Është një moment historik, jo vetëm për muzikën, por për gjithë kulturën shqiptare. Akad. Çapaliku e vlerësoi Tish Dainë jo vetëm si kompozitor, por edhe si arkitekt institucional të muzikës shqiptare moderne. Rëndësia e Tish Daisë qëndron në mënyrën sesi i përpunoi motivet popullore shqiptare (sidomos ato të veriut), i shndërroi ato në material simfonik e skenik pa folklorizëm të sipërfaqshëm, duke e ruajtur identitetin pa izolim estetik.

Në këtë veprimtari jubilarë përshëndetën: prefektja e Shkodrës z. Holta Duda; Rektori i Universitetit të Arteve prof. dr. Erald Bakalli; dirigjenti Sokol Marsi (Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit) dhe Gusti Daija, i biri i kompozitorit Tish Daija.



Akad. Vasil Tole, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave dhe kryetar i Komisionit të përhershëm të arteve (ASHSH) falënderoi organizatorët dhe pjesëmarrësit e konferencës dhe foli për rëndësinë që ka veprimtaria për 100-vjetorin e kompozitorit Tish Daija. Ai u shpreh se muzika qytetare dhe ajo skenike u detyrohet tre mjeshtërve të mëdhenj Çesk Zadesë, Kol Jakovës e Tish Daisë dhe Tish Daija renditet mes krijuesve të parë të këtyre gjinive. Ai kompozoi gati në të gjitha format e gjinitë muzikore dhe dha kontribut edhe në muzikën e filmit shqiptar. Më tej akad. Tole e vlerësoi kompozitorin Daija si një ndër përfaqësuesit më origjinalë të këngës shqiptare, ku së bashku me Çesk Zadenë krijuan klasën e kompozicionit dhe dhanë mësim për breza me radhë në Konservatorin Shtetëror të Tiranës.



Pas fjalëve përshëndetëse vijuan punimet e konferencës, të cilat u drejtuan nga dr. Kreshnik Duqi dhe dr. Denis Bizhga.

Seancën plenare e hapi prof. dr. Zana Shuteriqi me kumtesën “Tish Daija dhe tradita muzikore shkodrane”. Ajo përshkroi të gjithë karrierën muzikore të mjeshtrit Daija, duke e nisur nga mësimet e tij të para në qytetin e tij të lindjes. Kori i Kishës Françeskane dhe fryma qytetare shkodrane shënjuan krijimtarinë e tij. Ajo foli më tej për edukimin në Konservatorin e Shkodrës në linjën e kompozitorëve të parë Prenk Jakova e Palok Kurti, ku Shkodra ishte një laborator i gjinisë muzikore skenike. Prof. dr.

Shuteriqi vlerësoi veprat muzikore dhe gjurmët e thella që Tish Daija la më muzikën shqiptare.

Prof. asoc. dr. Rreze Kryeziu Breznica (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës) mbajti kumtesën “Opusi krijues i kompozitorit Tish Daija në skenën koncertale dhe performuese në Kosovë (1972–2025)”. Ajo e vlerësoi Tish Dainë për krijimin e një gjuhe muzikore moderne dhe autentike që i kapërcen kufijtë. Ai mbeti pikë referimi jo vetëm i traditës muzikore, por edhe i mjeshtërisë së krijimit muzikor.

Prof. asoc. dr. Mikaela Minga mbajti kumtesën “Portret i një artisti në rini”, ku spikati portretin qytetar të mjeshtrit të muzikës dhe më tej foli për tiparet origjinale të krijimtarisë së tij muzikore.

Dr. Kreshnik Duqi përshkroi krijimtarinë muzikore të Tish Daisë pas viteve '90, si një prodhimtari artistike që erdhi duke u stilizuar e pasuruar me aftësi komunikuese.

Prof. Pjetër Guralumi zgjeroi tematikën e kontributeve të Tish Daisë duke paraqitur kompozimet që ka bërë për repertorin e violonçelit në periudhën 1990-2000.

Me interes ishte edhe kumtesa e dr. Suzana Turkut, e cila foli për individualitetin krijues të kompozitorit Tish Daija në muzikën vokale, korale”. Ajo tha se figura e kompozitori zë një vend të rëndësishëm në procesin e formësimit dhe konsolidimit të gjuhës muzikore kombëtare. Duke analizuar individualitetin krijues të Tish Daisë, u ndal në ndërthurjen e elementëve muzikorë për të ndërtuar një stil të veçantë, të dallueshëm dhe me vlera të qëndrueshme në historinë e muzikës.

Qamil Gjyrezi foli për semiotikën e baletit dhe veprave instrumentale të kompozitorit Tish Daija, duke u ndalur te “Poema për violinë”.

Seancën e parë e mbylli akad. Vasil S. Tole me kumtesën “Tish Daija dhe kontributi i tij si kompozitor në Luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare” (rasti i himnit të divizionit garibaldin “Antonio Gramshi”, 1943, i kompozuar prej tij). Ai tha se Tish Daija që në moshë të re ka kontribuar për luftën Nacionalçlirimtare. Më tej akad. Tole vlerësoi disa nga kontributet themelore që ka dhënë Tish Daija në të gjitha gjinitë muzikore, që nga muzika simfonike, e dhomës, baleti, opera, operetta, si dhe muzika e filmit. Tish Daija kontribuoi në modernizimin e këngës shqiptare dhe në lëvrimin e muzikës moderne shqiptare.

Seanca e dytë vijoi me një koncert të pasur me krijimtari të kompozitorit Tish Daija. U interpretua suitë nga baleti “Bijtë e peshkatarit” nga ansambli i harqeve "Harmonica Albania" nën drejtimin e dirigjentit Eno Koço. Më tej koncerti vijoi me një fragment nga muzika e filmit “Tingujt e luftës” për piano solo që u interpretua nga Ardita Bufaj. U interpretuan, gjithashtu, pjesë të krijimtarisë së Tish Daisë si “Rapsodi për flaut e piano nga Elvis Rudi e Ardita Bufaj.



Sopranoja e njohur Mariana Leka gjatë koncertit këndoi “Aria e Dritës” nga opera “Pranvera”; “Aria e Vjosës” nga opera “Vjosa”; Kënga e krushqve”; “Këngë nga fletorja e 1945”, “Çikë moj çikë”, “Me lule t’bukra”, që u shoqëruan nga Ansambli i Harqeve. Lorenc Radovani dhe Ansambli i Harqeve interpretuan “Valle për violinë” të Daisë, ndërsa vepra “Kërcimi i kecape për 4 flaute (3. The Shepherd’s Pipe & 4. Dance of the kids) u interpretuan nga Elvis Rudi dhe kuarteti i flauteve.

Në kuadër të 100-vjetorit të lindjes së Tish Daisë në mjediset e Akademisë së Shkencave u hap edhe një ekspozitë me dorëshkrime origjinale muzikore, foto dhe postera të premierave të veprave të tij ndër vite.

www.akad.gov.al

U përurua botimi shkencor "Vepra të zgjedhura në fushën e sizmologjisë" me autor akademik Eduard Sulstarova



-Akad. Skënder Gjinushi: Kontributi i akad. Sulstarovës në ngritjen e shërbimit sizmologjik kombëtar, në studimin e strukturës së brendshme të Tokës, në analizën e proceseve tektonike aktive dhe në vlerësimin e rrezikut sizmik për territorin shqiptar përbën një pasuri të çmuar shkencore dhe shoqërore-

-Akad. asoc. Ormëni: Seria me katër vëllime "Vepra të zgjedhura në fushën e sizmologjisë" me mbi 2000 faqe, përbën sot një arkiv themelor të zhvillimit të sizmologjisë shqiptare për më shumë se katër dekada dhe do të shërbejë si burim i pazëvendësueshëm për studiuesit, pedagogët, studentët dhe vendimmarrësit-

Katër vëllime të librit "Vepra të zgjedhura në fushën e sizmologjisë" të botuara nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë u promovuan, sot, më 15 janar 2026, në përvjetorin e ndarjes nga jeta të akad. Eduard Sulstarovës, personalitet i shquar i shkencës shqiptare dhe një nga themeluesit e sizmologjisë moderne në vendin tonë.

Ceremonia promovuese u zhvillua me pjesëmarrjen e kryetarit të Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi, dhe anëtarëve të tjerë të Kryesisë, përfaqësuesve të institucioneve shtetërore dhe akademike, studiuesve, vajzave të akademik Eduard Sulstarovës, familjarëve, miqve, kolegëve dhe bashkëpunëtorëve.



Organizatori i veprimtarisë, akad. asoc. Rrapo Ormëni, në hapje të ceremonisë e vlerësoi si monumental botimin e veprës së akad. Sulstarovës. “Vepra të zgjedhura shkencore në fushën e sizmologjisë”, e miratuar nga Kryesia dhe asambleja e Akademisë së Shkencave, u botua nën kujdesin e veçantë të kryetarit të Akademisë, akad. Skënder Gjinushi. Kjo vepër përfaqëson dokumentin më të plotë shkencor mbi zhvillimin e studimit të tërmeteve në Shqipëri, ku janë përmbledhur mbi katër dekada kërkime, nga fundi i viteve '60 deri në vitin 2011.

Ai paraqiti për të pranishmit përmbajtjen e secilit vëllim, ku pasqyrohet jo vetëm evolucioni i mendimit shkencor, por edhe ndërtimi i institucioneve sizmologjike të vendit. Një dimension i veçantë i veprës është ai ndërkombëtar.

Akad. asoc. Ormëni theksoi se seria me katër vëllime, me mbi 2000 faqe, përbën sot një arkiv themelor të zhvillimit të sizmologjisë shqiptare për më shumë se katër dekada dhe do të shërbejë si burim i pazëvendësueshëm për studiuesit, pedagogët, studentët dhe vendimmarrësit.

Më tej, ai foli për kontributet vizionare të akad. Sulstarovës, si një nga themeluesit e monitorimit sistematik sizmik në Shqipëri në bashkëpunim me prof. Shyqyri Aliaj, prof.

Siasi Koçiaj, prof. Betim Muço dhe shumë kolegë të tjerë themeltar të shkollës shqiptare të sizmologjisë.

Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, në fjalën përshëndetëse e vlerësoi si kënaqësi të veçantë dhe një nder për Akademinë e Shkencave organizimin e ceremonisë së përrurimit kushtuar të veprës së akad. Sulstarovës.

Ky botim është një dëshmi e gjallë e një rruge të gjatë kërkimore, e përkushtimit intelektual dhe e përgjegjësisë qytetare që shoqëron gjithmonë shkencën e vërtetë. Ai pasqyron jo vetëm kontributin individual të autorit, por edhe një kapitull të rëndësishëm të historisë së zhvillimit të gjeoshkencave dhe të mendimit shkencor shqiptar në gjysmën e dytë të shekullit XX dhe në fillimet e shekullit XXI. Akad. Eduard Sulstarova është përfaqësues i atij brezi studiuesish që, në kushte jo gjithmonë të lehta, krijuan institucionet e para kërkimore funksionale dhe hodhën bazat metodologjike të disiplinave që sot i konsiderojmë të konsoliduara. Kontributi i tij në ngritjen e shërbimit sizmologjik kombëtar, në studimin e strukturës së brendshme të Tokës, në analizën e proceseve tektonike aktive dhe në vlerësimin e rrezikut sizmik për territorin shqiptar përbën një pasuri të çmuar shkencore dhe shoqërore. Në këtë rrugëtim, roli i tij ka qenë përcaktues, si në periudhën kur kërkimi sizmologjik zhvillohej pranë Akademisë së Shkencave, ashtu edhe në fazat e mëvonshme. Në të gjitha këto etapa, ai mbeti një pikë reference profesionale dhe morale, duke garantuar vazhdimësinë e shkollës shqiptare të sizmologjisë dhe ruajtjen e standardeve të larta akademike.



Gjithashtu, akad. Gjinushi e çmoi akademik Eduard Sulstarovën, për veprën e tij shumëvjeçare, për përkushtimin ndaj dijes dhe për kontributin e pazëvendësueshëm në ndërtimin dhe afirmimin e sizmologjisë shqiptare, duke falënderuar të gjithë bashkëpunëtorët, redaktorët dhe institucionet që kanë kontribuar në realizimin e këtij botimi me vlerë të veçantë shkencore dhe kulturore.

Për jetën dhe veprën e akad. Sulstarovës mbajtën ligjërata prof. dr. Niko Pojani, prof. dr. Shyqyri Aliaj (kumtesën e të cilit e lexoi dr. Anisa Dabërdini) dhe prof. dr. Arqile Teta, të cilët e vlerësuan si një personalitet historik të shkencës shqiptare, duke spikatur të gjitha kontribute që ka dhënë në krijimin e standardeve profesionale dhe etike në kërkimi shkencor, si dhe për kontributet e mëdha në rrugëtimin e sizmologjisë shqiptare nga fazat e para të institucionalizimit deri në konsolidimin e saj si shkencë moderne, integruese dhe e respektuar ndërkombëtarisht.

Pas kumtesave, të pranishmit shprehën fjalë mirënjohjeje dhe vlerësimi për personalitetin e akad. Sulstarovës.

E emocionuar nga vlerësimet e kolegëve dhe studiuesve dhe fjalët e dedikuara për akad. Sulstarovën, e bija Silva Sulstarova falënderoi përzemërsisht Kryesinë e Akademisë së Shkencave, botuesit e librit dhe organizatorët e veprimtarisë. Botimin e veprës ajo e konsideroi si një nga ëndrrat e fundit të përmbushura të akad. Eduard Sulstarovës.

www.akad.gov.al

**Akademiku Albert Doja publikon një sintezë shkencore mbi arritjet e fundit
në modelet strukturale shpjegimore të antropologjisë në Enciklopedinë e
Sistemeve Matëse në Shkencat Sociale**



Akademiku Albert Doja, Kryetari i Komisionit të përhershëm të antropologjisë dhe trashëgimisë kulturore pranë ASHSH-së, me botimin e tij më të ri shkencor, ka propozuar një sintezë përmbledhëse mbi arritjet e fundit në modelet strukturale shpjegimore të antropologjisë, që është botuar nga Elsevier Major Reference Works, si një Modul Reference për t'u përfshirë në Enciklopedinë e Sistemeve Matëse në Shkencat Sociale (Encyclopedia of Measurement in Social Sciences, 2025, ISBN 978-0-443-26629-4, <https://doi.org/10.1016/B978-0-443-26629-4.00002-2>).

Në këtë modul reference, akad. Albert Doja përshkruan një rrugëtim teorik drejt një metode shkencore për të hartografuar disa çështje të nxehta shoqërore bashkëkohore. Ai synon të përfaqësojë një perspektivë të rëndësishme mbi qasjet shkencore epistemologjike dhe sociale antropologjike, bazuar në metodologjinë antropologjike dhe sociologjike të traditës strukturale franceze, e cila mund të ndihmojë për sqarimin e drejtimit se ku po shkon ose mund të jetë duke shkuar antropologjia e sotme.



Structural models in anthropology

Albert Doja

[Show more](#) ✓

[+](#) Add to Mendeley [🔗](#) Share [📄](#) Cite

<https://doi.org/10.1016/B978-0-443-26629-4.00002-2> ↗

[Get rights and content](#) ↗

Abstract

In this article, I outline a theoretical path toward a scientific method to map some burning contemporary societal issues. It aims to represent an important perspective on social epistemological and anthropological scientific approaches, based on the anthropological and sociological methodology of the French structural tradition, which may help clarify what anthropology is or may be heading toward today. Lévi-Strauss's procedures of canonical formalization for the structural study of myth are proposed as innovative structural models in anthropology, which may radically help revise anthropological methods and goals to confront the pressing problems of the contemporary world. The morphodynamic formalization of larger unsuspected entities can be modeled, simulated, and visualized by means of these structural models built in software mechanisms, which may allow us to identify instrumental ideologies and to anticipate new social changes as a result of the mediating logical operation of a boundary condition within sociocultural systems and institutional frameworks. In particular, the boundary condition can be thought to anticipate the discursive activation of a particular cultural ideology acting as a hidden agency of instrumental politics.

Mbështetur në procedurat e formalizimit kanonik, të përdorura nga Lévi-Strauss për studimin struktural të mitit, akad. Albert Doja propozon se ato mund të përpunohen si modele strukturale inventive në antropologji, të cilat mund të ndihmojnë për rishikimin rrënjësor të metodave dhe pikësnyimeve antropologjike për t'u përballur me problemet urgjente të botës bashkëkohore.

Formalizimi morfodinamik i entiteteve të paparashikuara më të mëdha mund të modelohet, simulohet dhe vizualizohet me anë të këtyre modeleve strukturale të përpunuara në mekanizma matematikore të mbështetura me softuerë kompjuterikë, që mund të na lejojnë të identifikojmë ideologjitë instrumentale dhe të parashikojmë ndryshime të reja shoqërore si rezultat i funksionimit logjik ndërmjetësues të një kushti kufizues brenda sistemeve socio-kulturore dhe kornizave institucionale. Në veçanti, kushti kufizues mund të mendohet se parashikon aktivizimin diskursiv të një ideologjie të veçantë kulturore, që në raste empirike të identifikuara vepron si një agjent i fshehur i politikave instrumentale.

www.akad.gov.al

Mbledhja e komisioneve të përhershme pranë ASH

Komisioni i Përhershëm i Arkeologjisë realizon analizën e punës për vitin 2025 dhe projeksionet për vitin 2026



Komisioni i përhershëm i Arkeologjisë paraqiti më 13 janar 2026 raportin vjetor të punës. Të pranishëm ishin: kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi; sekretarja shkencore e ASHSH-së, akad. Anila Hoda; kryetari i SHSHA-së, akad. Gëzim Hoxha dhe anëtarë të komisionit.

Kryetari i komisionit, prof. Neritan Ceka, paraqiti raportin duke evidentuar disa nga arritjet kryesore të punës së tij. Veprimtaria e komisionit ka synuar forcimin e kërkimit albanologjik, aplikimin e metodave bashkëkohore dhe lidhjen e arkeologjisë me zhvillimin e qëndrueshëm kulturor dhe ekonomik të vendit. Gjatë vitit 2025 komisioni ka zhvilluar disa veprimtari shkencore dhe organizative, si dhe ka realizuar 6 mbledhje, duke kontribuar në mënyrë aktive në orientimin e kërkimit arkeologjik, vlerësimin e punës së institucioneve përkatëse, si dhe në promovimin e botimeve dhe projekteve shkencore me rëndësi kombëtare.

Në vazhdim të mbledhjes, prof. Neritan Ceka bëri një përmbledhje të punës për projektin “Lissus 2025”, një bashkëpunim i Akademisë së Shkencave me Universitetin Politeknik të Tiranës dhe bashkinë e Lezhës, duke përmendur se ky është projekti i dytë i financuar nga AKKSHI. Puna e realizuar për zbatimin e projektit “Lissus 2025” u vlerësua në veçanti për përdorimin e teknologjive bashkëkohore (GIS, skanim gjeofizik,

laser skaner) dhe rëndësinë për planifikimin e menaxhimit të territorit dhe zhvillimin lokal. Ai theksoi se për herë të parë është kryer skanim horizontal gjeofizik për një pjesë të monumenteve në funksion të studiuesve dhe komunitetit lokal dhe se projekti ka rëndësi për bashkinë e Lezhës, për kontributin që jep për hartimin e planit të menaxhimit të integruar të Parkut Arkeologjik të Lezhës.



Një çështje e analizuar ishte dhe puna për botimet shkencore të studiuesve të fushës në revistat “Iliria” dhe “Candavia”. Është e domosdoshme rritja e cilësisë dhe përfshirja e studiuesve të rinj me punime në këto revista, si dhe nxitja e botimeve të monografive në aspekte studimore me rëndësi për fushën e arkeologjisë. Në analizën e paraqitur, kryetari Ceka trajtoi edhe problematikat e hasura me zbatimin e projekteve shkencore të Institutit të Arkeologjisë dhe sugjerimet e dhëna nga anëtarët e komisionit për përmirësimin e punës në vijim. U diskutua për domosdoshmërinë për përfshirje më të gjerë të arkeologëve brenda dhe jashtë vendit dhe krijimin e një baze të dhënash kombëtare të arkeologëve shqiptarë.

Gjatë vitit 2025, me nismën e Komisionit të Arkeologjisë është punuar në mënyrë aktive për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Kërkimeve Arkeologjike (2025-2035). Drafti u diskutua në një grup pune të miratuar nga Kryesia e Akademisë. Mbi bazën e këtij diskutimi u përgatit drafti përfundimtar. Miratimi përfundimtar nga Komisioni i

Strategjisë së Kërkimeve Arkeologjike për vitet 2026-2036 duhet të realizohet brenda muajve të parë të vitit 2026.

Kryetari i komisionit u ndal dhe në vlerësimin e veprimtarisë përkujtimore “Tri jetë për arkeologjinë”, të mbajtur më 18 nëntor 2025, në bashkëpunim me Institutin e Arkeologjisë. Kjo veprimtari përkujtoi kontributin dhe rëndësinë e arkeologëve Hasan Ceka, Dhimosten Budina dhe Bep Jubani.



Në traditën e mbështetjes së kërkimeve arkeologjike në Bylis të krijuar nëpërmjet edhe gjatë këtij viti u realizua pjesëmarrja e prof. Neritan Ceka dhe prof. S. Muçaj në ekspeditën arkeologjike në Bylis në kuadër të Projektit ArkeoBylis.

Një tjetër veprimtari e përmendur ishte dhe përfaqësimi institucional i Komisionit të Arkeologjisë me pjesëmarrjen e prof. Neritan Ceka në konferencën “Roli i elitave të mijëvjeçarit I p.K. midis Evropës Qendrore dhe Ballkanit Jugor me rastin e studimit të "Kalit dhe Kalorësit të Babunjës" maj 2025.

Prof. Ceka u ndal dhe në paraqitjen e planifikimit të punës për këtë vit. Komisioni do të vijojë me zhvillimin e veprimtarive shkencore e përkujtimore, orientimin e gërmimeve arkeologjike, si dhe veprimtari promovuese për punën shkencore në fushën e arkeologjisë dhe disiplinave të lidhura me të. Është planifikuar të organizohen dy veprimtari të posaçme kushtuar 85-vjetorit të lindjes së prof. Neritan Ceka dhe 90-

vjetorit të lindjes së akad. Muzafer Korkuti, si dhe veprimtari shkencore me leksion akademik të dr. Shafit Gashit mbi kërkimet arkeologjike në Kosovë dhe të prof. Aleksandër Dhimës mbi gjendjen aktuale të studimeve antropologjike në Shqipëri. Nga mesi i vitit 2026 pritet të realizohet prezantimi i vëllimit I të “Historisë së shqiptarëve” nga prof. Neritan Ceka. Në përfundim të takimit, përfaqësuesit e Kryesisë dhe anëtarët e komisionit diskutuan për punën e realizuar dhe vlerësuan arritjet pozitive.

Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Gjinushi vlerësoi rolin e Komisionit si tepër të rëndësishëm dhe shprehu vlerësime për punën e bërë gjatë këtij viti. Me tej, ai dha udhëzime që të përmirësohet puna për rritjen e produktit shkencor, zgjerimin e veprimtarisë botuese, dhe t’u jepet prioritet bashkëpunimeve ndërinstitutionale për një angazhim më të mirë në projektet kërkimore-shkencore. Në fund të fjalës së tij, ai pohoi mbështetjen e Kryesisë së Akademisë së Shkencave në arritjen e synimeve, objektivave dhe thellimin e punës kërkimore shkencore të Komisionit të Përhershëm të Arkeologjisë.

www.akad.gov.al

Komisioni i Përhershëm i Arteve zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive për vitin 2025 dhe propozimet për vitin 2026



Mbledhja u zhvillua në datën 9 janar 2026 në praninë e akad. Skënder Gjinushit, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; akad. Gëzim Hoxhës, Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike; akad. Stefan Çapalikut, kryetar i Qendrës së Studimit të Arteve dhe anëtarëve të Komisionit.

Akad. Vasil Tole, zv. kryetari i ASHSH-së, si dhe kryetar i Komisioni të Përhershëm të Arteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, paraqiti raportin e analizës vjetore të veprimtarive për vitin 2025.

Gjatë vitit 2025 Komisioni ka zhvilluar gjithsej katër mbledhje. Një nga veprimtaritë më të rëndësishme ishte konferenca shkencore mbarëkombëtare “Muzika shqiptare si krijimtari, interpretim, muzikologji dhe edukim artistik”, e cila u organizua në bashkëpunim me Fakultetin e Muzikës në Universitetin e Arteve në kuadër të Muajit të Letërsisë dhe Arteve, me pjesëmarrjen e një sërë institucionesh akademike dhe kulturore kombëtare.

Gjatë vitit 2025, Komisioni ka organizuar dhe mbështetur gjithashtu një sërë veprimtarish, ndër to: Koncert-kumtesën “Kompozitorët e Alzasë – Lorenës në shekujt XIX-XX”; ligjëratën “Zogu i qiejve – Lasgush Poradeci ndërmjet pikturës dhe poezisë”, mbajtur nga studiuesja Suzana Varvarica Kuka; ligjëratë nga dr. Denis Bizhga “Thoma Nassi dhe banda kombëtare ‘Vatra’ në historiografinë muzikore shqiptare”; dy koncerte ndërkombëtare: formacioni piano quintet nga Italia dhe një ansambël ekselencash muzikore me qendër në Vjenë, të drejtura nga violinisti i Jonian Ilias Kadesha; ka mbështetur organizimin e koncert-recitalit të Kledis Rexhos dhe Elvina Gurrës, 29 dhjetor 2025.

Komisioni ka qenë i angazhuar edhe në promovimin e veprave letrare dhe studimore, kushtuar figurave të rëndësishme të kulturës shqiptare, si : “Antologji poetike (shqip-spanjisht)/Antología poética”, Namik Dokle; “Petro Marko, shkrimtar i lirisë” i studiuesit Behar Gjoka; “Edi Rama: Neuroestetika e një artisti” me autor Oltsen Gripshi; “Libri im i kujtimeve” nga Rafet Rudi.

Pas diskutimeve rreth raportit u bënë propozime dhe diskutime për draft-kalendarin e aktiviteteve për vitin 2026. Komisioni synon vijimin e trajtimit të temave me rëndësi në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, përmes këtyre veprimtarive:

Konferencë shkencore “Tish Daija në 100-vjetorin e lindjes” në bashkëpunim me Qendrën e Studimit të Arteve; bisedë tematike mbi artin nga Suzana Varvarica Kuka; promovim i botimit “Eposi në artet pamore” (Suzana V. Kuka); referim shkencor “Ibrahim Kodra (1918 -2006) përmes shtypit italian” nga S. V. Kuka; promovim ndërkombëtar botimi në Spanjë i Epikës legjendare – Cikli i Mujit dhe Halilit, Namik Dokle; aktiviteti “Shpëtim Kushta, 80-vjetori i lindjes”, bashkëpunim me QSA; veprimtari për 100-vjetorin e prof. Ymer Skënderit, bashkëthemelues i Konservatorit të Tiranës dhe themelues i klasës së violonçelit, në bashkëpunim me Fakultetin e Muzikës, në UART; referim shkencor “Jeta dhe vepra e akad. Zeqirja Ballata” nga Jetmir Zaganjori; referim shkencor “Promovim i punëve të prof. Albert Paparisto” nga Edmir Ballgjati; bisedë tematike “Menaxhim teatri” nga Abigeila Voshtina; bisedë tematike “David Selenica dhe gjuha ikonografike në artin shqiptar të shekullit XVIII”, dr. Ahilino Palusha, dr. Denis Bizhga.

Gjashtëmujori i dytë 2026 do të vijojë me kumtesën shkencore “Tre muzat e zërit shqiptar: Jorgjije Truja, Tefta Tashko Koço dhe Marie Kraja në themel të artit vokal kombëtar” nga dr. Denis Bizhga; bisedë tematike “Lahuta shqiptare në UNESCO. Vlera, identiteti dhe përgjegjësia” në bashkëpunim Qendrën për Hapje dhe Dialog (COD); aktivitet muzikor “Protokolli me Kosovën”, etj.

Në fund të takimit, akad. Gjinushi shprehu vlerësimet për punën e anëtarëve të Komisioni gjatë vitit 2025 si bashkudhëtar me Qendrën e Studimit të Arteve, në zgjerimin e bashkëpunimeve, duke u angazhuar në projekte të rëndësishme që i shërbejnë të artit, kulturës dhe dijes akademike, e duke kontribuar në mënyrë të ndjeshme në afirmimin e rolit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në jetën artistike kombëtare.

www.akad.gov.al

Komisioni i mjekësisë zhvilloi takimin për analizën vjetore të punës për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026



Mbledhja për analizën vjetore të Komisionit të mjekësisë u zhvillua sot, më 13 janar 2026, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë me pjesëmarrje fizike dhe online.

Në takim ishin të pranishëm kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi; sekretarja shkencore e ASHSH-së, akad. Anila Hoda; kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike akad. Neki Frashëri dhe anëtarët e komisionit.



Kryetari i Komisionit të Mjekësisë, akad. Genc Sulçebe paraqiti raportin përmbledhës për veprimtaritë e zhvilluara nga komisioni gjatë vitit 2025.

Ai tha se Komisioni i Mjekësisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ka zhvilluar gjatë periudhës vjetore një aktivitet të gjerë shkencor, këshillimor dhe organizativ, duke kontribuar në analizën dhe adresimin e disa prej çështjeve më të rëndësishme të shëndetit publik dhe mjekësisë bashkëkohore në vend.

Gjatë vitit 2025 Komisioni ka organizuar mbledhje periodike dhe veprimtari shkencore të fokusuar në fusha prioritare si: provat klinike dhe harmonizimi i tyre me standardet europiane, spektri i autizmit dhe nevoja për diagnostikim dhe ndërhyrje të hershme, siguria e barnave dhe farmakovigjilenca, si dhe shëndeti mjedisor dhe profesional. Nëpërmjet tryezave të rrumbullakëta, referimeve shkencore dhe diskutimeve me ekspertë të fushës, janë evidentuar problematika aktuale dhe janë formuluar rekomandime konkrete me vlerë për politikëbërjen shëndetësore dhe për institucionet përkatëse.

Akad. Sulçebe vuri në dukje se një ndër aktivitetet më të rëndësishme të vitit ishte organizimi i Konferencës së III Ndërkombëtare “Occupational and Environmental Health Advances”, në bashkëpunim me komisione të tjera shkencore dhe me Qendrën Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës, ku morën pjesë personalitete të njohura akademike nga Shtetet e Bashkuara dhe vende të ndryshme të Europës. Konferenca kontribuoi në shkëmbimin e përvojave dhe njohurive bashkëkohore në fushën e shëndetit publik, mjedisor dhe profesional.



Paralelisht me veprimtaritë shkencore, Komisioni ka mbështetur zhvillimin e kërkimit shkencor përmes propozimit dhe miratimit të projekteve kërkimore të financuara në nivel kombëtar, duke forcuar lidhjen midis kërkimit shkencor dhe praktikës mjekësore. Në përfundim të analizës së punës së realizuar gjatë vitit 2025, akad. Genc Sulçebe paraqiti një plan të strukturuar aktivitetesh për vitin 2026, që përfshin mbledhje tematike, prezantime të punëve kërkimore në fusha të ndryshme të mjekësisë dhe biomjekësisë, si dhe organizimin e konferencave dhe workshop-eve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Pjesëmarrësit në takim bënë propozime të reja dhe diskutuan për mënyrën e organizimit të veprimtarive, ku një vëmendje e veçantë do t'u kushtohet sëmundjeve kronike, shëndetit publik, cilësisë së jetës së pacientëve me kancer, sëmundjeve infektive dhe avancimeve në biomjekësinë humane.

Në fund, u bë përzgjedhja e temave më të rëndësishme që do të trajtohen gjatë vitit 2026.

Akad. Sulçebe falënderoi anëtarët e komisionit për diskutimet dhe propozimet e vlefshme dhe gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe për të shërbyer si komitete shkencore dhe organizative të veprimtarive të propozuara.

Ai theksoi se nëpërmjet këtyre veprimtarive, Komisioni i Mjekësisë synon të forcojë më tej rolin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë si një aktor i rëndësishëm në zhvillimin shkencor, në këshillimin e institucioneve publike dhe në promovimin e politikave të bazuara në evidencë në fushën e shëndetësisë.

www.akad.gov.al

Komisioni i Matematikë-Informatikës realizoi analizën për vitin 2025 dhe projektet për vitin 2026



Takimi i Komisionit të informatikë-matematikës u mbajt sot, më 12 janar 2026, me pjesëmarrje fizike dhe online.

Raporti i analizës vjetore u paraqit nga prof. dr. Fatmir Hoxha, kryetari i Komisionit të informatikë-matematikës, ku ishin të pranishëm akad. Anila Hoda, sekretare shkencore e ASHSH-së; akad. Neki Frashëri, kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike, akad. Kozeta Sevrani.

Prof. dr. Hoxha përmendi disa nga veprimtaritë vjetore të kryera nga Komisioni së bashku me Institutin Kombëtar të Matematikës (IKM) dhe Njësinë e Inteligjencës Artificiale (NJIA) si: Workshopi kombëtar “Inovacion në mësimdhënien e matematikës” i organizuar nga Komisioni IKM, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës. (Organizatorë: prof. dr. E. Sila, dr. F.Çela, prof. dr. F.Hoxha); Konferenca e 11-të Ballkanike në Informatikë BCI2025 (13-15 tetor 2025), me pjesëmarrjen e ligjëruesve nga vendi, rajoni dhe bota, si dhe me pjesëmarrjen e prof. Mira Mezinit, anëtare e jashtme e ASHSH-së; Konferenca e tretë kombëtare e matematikës (23-24 tetor 2025), me pjesëmarrjen e 40 referuesve nga Shqipëria dhe bota, si dhe nga universitetet e vendit, e organizuar nga prof. dr. Fatmir Hoxha, akad. Skënder Gjinushi, prof. dr. Eglantina Kalluçi, dr. Florion Çela.



Nga Komisioni janë zhvilluar 6 mbledhje, ku janë trajtuar çështje të organizimit të konferencave, propozime, ide e diskutime për veprimtarinë e tij dhe njësisë që mbulon. Këtë vit u konsolidua funksionimi i një seminari shkencor për problemet e matematikës, me synimin e paraqitjes nga specialistë të mirëfilltë të tematikave aktuale në matematikë, me një pjesëmarrje të konsiderueshme të grupeve nga diaspora (prof. dr. F.Cakoni, dr. F.Çela).

Gjatë vitit 2025 është punuar për Projektin “Baza e të dhënave e kërkimit shkencor në matematikë”, i cili është realizuar 80 për qind. Projekti drejtohet nga prof. dr. F.Hoxha.

Për vitin 2026, KMI së bashku me IKM dhe NJIA do vijojë punën për konsolidimin e një webinarit të matematikës me drejtimin e prof. dr. F. Cakoni, prof. dr. E. Kalluçi, prof. dr. F.Hoxha, dr. F.Çela.

Gjatë periudhës vjetore pritet të përfundohet edhe projekti “Data-bazë e kërkimit shkencor në matematikë”.

Në fushën e botimeve në kuadër të 20-vjetorit të numrit të parë të Revistës AJNTS të Akademisë së Shkencave parashikohet një numër special për Matematikën me punime cilësore nga kolegët e matematikës brenda dhe jashtë vendit.

Puna do të vijojë më tej edhe me mbajtjen e një woshkop-i, dy konferencave ndërkombëtare e një konference kombëtare.

Një nga objektivat kryesorë për vitin 2026 mbetet shtimi i përpjekjeve për hartimin dhe fitimin e projekteve në bashkëpunim me Departamente të Universiteteve shqiptare ose të huaja, si p.sh., ato të mbështetura nga AKKSHI, ERASMUS+, HORIZON etj.

www.akad.gov.al

Komisioni i historisë zhvilloi takimin për analizën e punës për vitin 2025 dhe propozimet për vitin 2026



Mbledhja e Komisionit të Përhershëm të Historisë për analizën e punës vjetore u zhvillua në 20 janar 2026 në praninë e Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, dhe kryetarit të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, akad. Gëzim Hoxha, si dhe me pjesëmarrjen e anëtarëve të Komisionit.

Kryetari i Komisionit, prof. dr. Paskal Milo, paraqiti raportin e punës për vitin 2025. Ai tha se puna e Komisionit për vitin 2025 është realizuar me sukses sipas programit dhe detyrave që u lanë në fillim të vitit të kaluar.

Një ndër projektet më të rëndësishme të zhvilluara nga Komisioni ishte konferenca shkencore “Shqipëria në periudhën bizantine”, e cila u vlerësua si një veprimtari dinjitoze që nderoi Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Pjesëmarrja në këtë konferencë ishte e gjerë dhe niveli i organizimit u vlerësua pozitivisht edhe nga studiuesit e huaj, të cilët shprehën surprizën dhe përshtypjet e tyre të mira për mënyrën se si u zhvillua veprimtaria. Merita për organizimin e konferencës i takon ASHSH-së dhe bashkorganizatorëve, si Universiteti i Tiranës, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Shoqata Shqiptare e Studimeve Bizantine, si dhe disa prej anëtarëve të Komisionit që morën pjesë me referime shkencore.



Një tjetër objektiv i rëndësishëm i Komisionit gjatë vitit ishte organizimi i tryezës shkencore me temën “Studimet historike shqiptare – sfida dhe probleme”, e cila kishte për qëllim trajtimin e problematikave aktuale të studimeve historike në Shqipëri, sfidat metodologjike dhe institucionale, si dhe nevojën për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet studiuesve dhe institucioneve kërkimore.

Prof. dr. Milo theksoi gjithashtu se anëtarë të komisionit kanë marrë pjesë dhe në veprimtari të tjera shkencore brenda e jashtë vendit, përfshirë pjesëmarrjen në Kongresin e AIESEE-së me referime shkencore. Gjatë vitit janë zhvilluar edhe aktivitete të shumta promovuese, si dhe veprimtari të veçanta kushtuar personaliteteve të shquara të fushës së historisë.

U bënë diskutime dhe u evidentua nevoja që propozimet e ardhshme për zgjerimin e anëtarëve të Komisionit, të bëhen duke dalë përtej kornizës së brendshme të tij dhe të synojnë bashkëpunime më të gjera me institucione të tjera. Gjithashtu u theksua se Komisioni, në bashkëpunim me Institutin e Historisë, duhet të përpunojë ide, qëndrime dhe projekte të përbashkëta, duke u shndërruar në një vatër aktive dhe jo formale diskutimi shkencor.

Më pas u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës “Propozime për veprimtari të komisionit për vitin 2026”. U propozua që komisioni të iniciojë dy ose tri aktivitete me peshë në kërkimin shkencor. U propozua një veprimtari me temën “Popullsia vllahe në Shqipëri dhe në Ballkan. Një analizë historike krahasuese”. Gjatë diskutimeve rreth temës, gjithashtu, u ra dakord për ngritjen e një grupi organizator, i cili do të nisë punën për përgatitjen e veprimtarisë, me synimin që ajo të zhvillohet gjatë muajit nëntor. U theksua rëndësia e ftesës së historianëve dhe gjuhëtarëve të huaj, si dhe përfshirja e të gjitha instituteve përkatëse në këtë aktivitet.



Prof. dr. Paskal Milo shprehu dakordësinë edhe mbështetjen e komisionit edhe për një propozim nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës për organizimin e një konference ndërkombëtare me temën “Albanologjia greke. Niveli dhe problemet e saj”. Kjo konferencë është përfshirë në protokollin e bashkëpunimit me ASHAK-un dhe organizimi i saj do të realizohet nga Seksioni, në bashkëpunim me Komisionin.

Një propozim i tretë lidhet me 70-vjetorin e Konferencës së Tiranës, që përkon në muajin prill, si një ngjarje me rëndësi historike për kohën. Komisioni sugjeron që kjo veprimtari të organizohet nga Instituti i Historisë, në bashkëpunim me Komisionin e përhershëm të Historisë, ndërsa Instituti i Historisë të marrë përsipër organizimin e plotë të saj.

U diskutua gjithashtu edhe mundësia e organizimit të një aktiviteti kushtuar Nikola Jorgës, me rastin e 130-vjetorit të lindjes së tij, që përkon me muajin mars. Ky propozim mbetet për diskutim të mëtejshëm, për të vendosur nëse do të përfshihet brenda konferencës për popullsinë vllahe apo do të organizohet si veprimtari më vete.

Tre propozimet u aprovuan që të përfshihen në kalendarin e veprimtarive për vitin 2026

Në fund, Kryetari i ASHSH-së, akad. Skënder Gjinushi, përshëndeti punën e Komisionit për vitin 2025 duke vlerësuar analizën dhe propozimet e paraqitura, të orientuara në drejtimin e duhur. Ai theksoi se ky vlerësim lidhet edhe me përbërjen cilësore të Komisionit.

Komisioni i Inxhinierisë prezantoi çështjet kryesore të analizës së punës vjetore të vitit 2025 dhe veprimtarive të vitit 2026



Takimi u zhvillua në datën 14 janar 2026, ku ishte i pranishëm kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike, akad. Neki Frashëri, dhe anëtarët e Komisionit.

Kryetari i Komisionit të Inxhinierisë, akad. Jorgaq Kaçani, prezantoi aktivitetet kryesore të zhvilluara në vitin 2025. Ai vuri në dukje se Komisioni ka zhvilluar një aktivitet të gjerë shkencor, këshillimor dhe organizativ dhe veçoi disa nga rezultatet e arritura në bashkëpunim me qendrat e njësitë e ngritura pranë Akademisë së Shkencave.

Konferenca shkencore me temën “Ndryshimet klimatike dhe uji: Mbyllja e hendekut të paralajmërimit të hershëm së bashku” (mars 2025), mbledhi bashkë 72 studiues dhe 22 institucione kërkimore universitare, administrative dhe biznesi nga Shqipëria e Kosova. Në këtë konferencë u paraqitën 30 studime shkencore.

Disa prej çështjeve më të rëndësishme në fushat e energjisë, sizmologjisë, ndryshimeve klimatike, arkitekturës, digjitalizimit etj., janë trajtuar si rezultat i veprimtarive më të spikatura si: Konferenca “Burimet ujore ndërkufitare Pogradec-Librazhd-Peshkopi (30 maj 2025); Forumi shkencor “Risku sizmik dhe zvogëlimi i tij” (12 qershor 2025); workshop-i shkencor: “Tektonika aktive dhe burimet sizmike për modelimin sizmotektonik në Shqipëri” (23-24 shtator 2025); konferencë shkencore me temën: “Reziqet gjeologjike dhe hidrogjeologjike” (7-8 nëntor 2025). Akad. Kaçani vlerësoi si një nga më të rëndësishmet edhe konferencën ndërkombëtare për energjinë dhe qëndrueshmërinë (ICES 2025), që u mbajt në datat 14-15 nëntor 2025, me synimin që të nxisë punën kërkimore për energjinë dhe të përhapë rezultatet e arritura për të

garantuar një zhvillim të qëndrueshëm të vendit në stadin e tranzicionit të gjelbër e digjital, sipas objektivave specifike të BE-së, të vendosura për energjinë. Në seancat plenare u trajtuan çështje që lidhen me prodhimin, shndërrimin e transportimin e energjisë, duke garantuar një mjedis të pastër.

Në muajin nëntor, këtyre veprimtarive iu bashkëngjitet edhe ekspozita “Modernizimi kosovar, një abetare e arkitekturës” me autorë dy arkitektët nga Kosova Ilir Gjinolli dhe Lulzim Kabashi.



Gjithashtu workshop-i shkencor me temën : “Zbatimi i kontabilitetit ligjor nëpërmjet digjitalizimit për një qeverisje efektive në administratën publike”, i cili u mbajt në dhjetor në kuadër të bashkëpunimeve institucionale, u fokusua në sfidat dhe mundësitë që sjell digjitalizimi në fushën e kontabilitetit ligjor dhe auditimit në sektorin publik, në përputhje me standardet e Bashkimit European, duke e zgjeruar fushën e kërkimeve shkencore mbi rolin e transformimit digjital në modernizimin e administratës publike dhe forcimin e përgjegjshmërisë institucionale.

Anëtarët e komisionit, pjesëmarrës në mbledhje, akad. Raimonda Buhaljoti, akad.asoc. Rrapo Ormeni, prof. dr. Niko Naska, prof. dr. Neritan Shodrani, prof. dr. Vladi Kolici, prof. asoc. Ilda Kazazi, prof. asoc. Aulon Shabani, prof. asoc. Flamur Bidaj, prof. asoc. Bardhyl Muceku diskutuan punën e kryer nga komisioni dhe rezultatet e arritura në aktivitetet e kryera, si dhe kontributin e të huajve nga Franca, Italia, Greqia, Gjermania, Kosova etj. në këto arritje.

Aktivitetet e vitit 2026 do të jenë në këto fusha të rëndësishme si; energjia, sizmologjia, klima, etj., ku fokusi do të jetë në interpretime dhe zgjidhje të reja për ndryshimet klimatike dhe ndikimin e tyre në rajonin e biosferës, menaxhimin e burimeve ujore, e më gjerë.

www.akad.gov.al

Komisioni fizikë-kimi prezantoi çështjet kryesore të analizës së punës vjetore të vitit 2025 dhe veprimtarive të vitit 2026



Takimi u zhvillua në datën 14 janar 2026, ku ishte i pranishëm kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike, akad. Neki Frashëri, dhe anëtarët e komisionit.

Kryetari i Komisionit fizikë - kimi, akad. emeritus Florian Vila prezantoi aktivitetet kryesore të zhvilluara në vitin 2025.

Një ndër veprimtaritë që ai e vlerësoi tepër të rëndësishme ka qenë forumi shkencor: “Programet e studimit të doktoraturës në fizikë e kimi. Vlerësime e mendime për të ardhmen”. Veprimtaria u fokusua në Shkollën e Doktoraturës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës UT (fizikë e kimi) dhe në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike UPT (fizikë). Në forum u vu theksi te arritjet, bazuar në mekanizmat ligjorë në fuqi, VKM respektive, eksperiencat në nivel institucional e individual, si dhe në problematikat dhe çështjet që kërkojnë një qasje tjetër apo përmirësime në vazhdim. Grupi përgatiti materialin “Problematikat e doktoraturave”, ku janë paraqitur çështjet që u diskutuan dhe u konkluduan në komision, si dhe eksperiencat europiane për to.

Një tjetër veprimtari, ku u trajtuan tematika të rëndësishme me përmbajtje shkencore dhe historike, është forumi shkencor me temën “Meteorologjia dhe aviacioni. 100 vjet në hapësirën shqiptare. 75-vjetori i Organizatës Botërore të Meteorologjisë”. U

prezantuan ligjërata në lidhje me fluturimet e para ajrore në hapësirën shqiptare, si dhe mbi ecurinë ndër vite; rëndësinë që ka monitorimi meteorologjik në vendin tonë, jo vetëm për aviacionin, por dhe për degët e tjera të ekonomisë. Në forum ishin të ftuar nga Instituti i Gjeoshkencave UPT, Albkontrolli, Aeroportet e Tiranës dhe Prishtinës, SHMU, etj, si dhe institucione të huaja nga Franca dhe Kosova. Forumi u përshëndet edhe nga personalitete të larta të Organizatës Botërore të Meteorologjisë (OBM).



Janë bërë propozime për zgjerimin e Komisionit me bashkëpunëtorë të jashtëm nga diaspora shkencore, që ka qenë një nga objektivat e Akademisë, për t'u dhënë një impuls komisioneve të saj të përhershme.

Janë shqyrtuar programet e punës për Njësinë Kërkimore Studimore “Pasuritë ujore” dhe IKF, për zgjatje afati, për periudhën dyvjeçare 2025-2027, si dhe për njësinë kërkimore studimore “Energjia e rinovueshme”, për të realizuar detyrën e vënë nga kryesia në miratimin e saj.

Pas prezantimit të raportit, u diskutua dhe u dhanë ide për aktivitetet e vitit 2026, që ndikojnë në reformimin e kërkimit shkencor si: ngritja e një qendre kombëtare kërkimore për ujërat, me kapacitete të mjaftueshme për të kryer studime e për të përgatitur skenarë lidhur me zhvillimin e sektorit, në përballje me sfidat e ndryshimeve klimatike, demografike e sociale; organizimin e forumit “Nga auditori në tregun e punës: Sfida dhe perspektiva”, që përfshin arsimimin e lartë, kualifikimin e punësimit, si dhe organizimin e forumit “Efikasiteti i shërbimeve meteorologjike” për një shfrytëzim më fitimprurës të të dhënave të monitorimit meteorologjik për degët e ndryshme të ekonomisë, sigurinë kombëtare dhe impaktit të ndryshimeve klimatike në ekonominë e vendit.



www.akad.gov.al

U zhvillua mbledhja e Komisionit të përhershëm të Gjuhësisë dhe të Letërsisë



Mbledhja u mbajt në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, në datën 8 janar 2026, me pjesëmarrjen e sekretares shkencore të ASHSH-së, akad. Anila Hoda; kryetarit të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, akad. Gëzim Hoxha, si dhe anëtarëve të komisionit dhe grupit të punës.

Prof. dr. Anila Omari, kryetare e Komisionit të përhershëm të gjuhësisë dhe të letërsisë paraqiti një raport mbi aktivitetin e Komisionit për vitin 2025.

Më pas, diskutimet u përqendruan në planifikimin e veprimtarive për vitin 2026.

U propozuan që të mbahen konferenca, tryeza shkencore apo ligjërata lidhur me nevojat për: kërkime shkencore në disa fusha të gjuhësisë si morfologjia dhe drejtshkrimi i shqipes; hartimin e platformave për kujdesin dhe kulturën e gjuhës; trajtimin e çështjeve terminologjike gjuhësore në bashkëpunim me disa komisione, si ai i drejtësisë, i matematikës dhe informatikës e më gjerë, si dhe problemet e mësimdhënies së gjuhës në shkolla.

Gjithashtu, u propozua dhe u diskutua organizimi i veprimtarive shkencore përkujtimore dhe jubilarë për të nxjerrë në dritë personalitete me vepra dhe kontribute të spikatura në fushat e gjuhësisë dhe albanologjisë.



Akad. Anila Hoda dhe akad. Gëzim Hoxha shprehën vlerësimet dhe falënderimet për punën e bërë nga Komisioni gjatë vitit 2025 dhe dhanë orientimet përkatëse për përgatitjen sa më të mirë të draft-projekteve të veprimtarive për vitin 2026.

www.akad.gov.al

Mbledhje të Instituteve dhe Qendrave

Instituti i arkeologjisë zhvilloi takimin për analizën e punës vjetore për vitin 2025 dhe projektet e vitit 2026



Mbledhja për analizën vjetore të Institutit të Arkeologjisë u zhvillua më 19 janar 2026.

Në takim ishte i pranishëm kryetari i ASHSH-së akad. Skënder Gjinushi, sekretarja shkencore e ASHSH-së akad. Anila Hoda dhe kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike akad. Gëzim Hoxha.

Akad. Adem Bunguri, drejtori i Institutit të Arkeologjisë, paraqiti raportin përmbledhës për punën kërkimore-shkencore dhe veprimtaritë e zhvilluara gjatë vitit 2025. Ai tha se ky është viti i dytë që IA-ja e ushtron veprimtarinë si pjesë e Akademisë së Shkencave, ku ka kryer një aktivitet të pasur kërkimor-shkencor, që pasqyrohet në realizimin e projekteve të gërmimeve sistematike në terren; realizimin e projekteve të bashkëpunimit me universitetet e huaja perëndimore; organizimin dhe zhvillimin e konferencave shkencore kombëtare, si dhe me pjesëmarrjen e lartë në konferenca shkencore ndërkombëtare.

Akad. Bunguri u ndal në vlerësimin e produktit shkencor të çdo studiuesi. Ai tha se etaloni i vlerësimit janë botimet. Puna kërkimore e bërë nga punonjësit e IA-së pasqyrohet nëpërmjet publikimit të artikujve shkencorë brenda dhe jashtë vendit; botimit të revistave "Iliria" dhe "Candavia", si dhe botimit të disa monografive shkencore. Tre numra të revistës "Iliria" (46, 47 dhe 48) dhe numri 10 i revistës

“Candavia” u çuan për shtyp në fund të vitit 2025. Të dy numrat e kësaj reviste janë në gjuhën angleze.

Instituti me departamentet përkatëse ka 29 punonjës të kualifikuar. Nga këta, 24 janë kërkues shkencorë dhe pesë ndihmës të nivelit master. Gjatë vitit 2025 IA-ja ka botuar monografitë: “Përkrenare ilire në Shqipëri dhe Kosovë” e A. Bungurit; “Kultura iliro-arbërore në luginën e Matit” e D. Kurtit; “Nga lindja në martesë: Bota femërore e paraqitur në skulpturën e vogël” e B. Mukës; “Aspekte të prodhimit qeramik nga antikiteti në mesjetën e hershme në territorin e Shqipërisë” e E. Shehit; “Organizimi territorial, politik dhe arkitektonik i koinave gjatë periudhës helenistike në Ilirinë e Jugut. Shembulli i Byllis” (“Territorial, political and architectural organisation of koina during the Hellenistic period in Southern Illyria. The example of Byllis”), doktoraturë e O. Cekës; “Populations et Interactions Culturelles en Aire Illyro-Épirote du VIIe au IIIe siècle av. J.-C.” E L. Jaupaj; “Butrinti 8” (Rezultate gërmimesh), e R. Hodges e N. Mollës. Kryetari i IA-së vuri në dukje edhe kontributin e studiuesve të Institutit Arkeologjik në mësimdhënie në katër universitete shqiptare.



Ndërsa foli për hartimin e miratimin nga grupi i punës të strategjisë së kërkimit arkeologjik për vitet 2025-2035, akad. Bunguri u ndal në gërmimet më të suksesshme. Në fushën e prehistorisë kërkimet u orientuan kryesisht në pellgun e Korçës dhe të Pogradecit, ku të dhënat e deritanishme kanë shtruar për zgjidhje çështje të kronologjisë

dhe intensitetit të proceseve të neolitizimit, si dhe të zhvillimeve transformuese kulturore në epokat e bronzit dhe të hekurit.

Në departamentin e antikitetit ilir tematikat e kërkimeve për vitin 2025 janë orientuar në qytetet ilire dhe epirote, kolonitë helene dhe në prapatokë. Në kolonitë helene kanë vazhduar kërkimet e zgjeruara në qytetin e Dyrrahut dhe në Apoloni. Kërkimet e këtij viti u përqendruan në zgjidhjet e problemeve të qyteteve ilire, si Bylis dhe Bushat. Në Epir kërkimet vijuan nëpërmjet projekteve në Antigonea, Cukën e Ajtoit, Foinike dhe Butrint. Kërkimet në territor vazhduan, gjithashtu, në zonën Memaliaj-Tepelenë (Qesarat). Departamenti i antikitetit të vonë dhe mesjetës ka bërë kërkime në hapësirën kohore nga shek. IV deri në shek. XV.

Gjatë vitit 2025 në IA janë realizuar 18 projekte arkeologjike, 11 prej të cilëve janë realizuar në bashkëpunim me universitetet europiane dhe 7 projekte nga IA-ja, ASHSH. Mbështetja financiare për të dyja kategoritë e projekteve vjen nga Akademia e Shkencave; për projektet e kategorisë së parë, pala e huaj mbulon kostot e ekipit shqiptar dhe të studentëve.

Instituti i Arkeologjisë, në bashkëpunim me institutet homologe dhe universitetet nga Franca, Gjermania, Italia, Zvicra, Polonia etj. realizoi në territorin e Shqipërisë rreth 15 projekte ndërkombëtare, përfshirë edhe projektet studimore. Falë këtyre projekteve, akad. Bunguri e vlerësoi si kryefjalën e gërmimeve zbulimin e varrit monumental të Strikçanit, gërmuar nga E. Nikolli.

Gjatë vitit 2025 IA-ja ka realizuar mbi 40 pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare. Në numrin e madh të konferencave, spikati konferenca ndërkombëtare e titulluar “The role of elites of the 1st millenium between Central Europe and the Southern Balkans” (Roli i elitave të mijëvjeçarit të parë para Krishtit midis Europës Qendrore), e zhvilluar në Vjenë në datat 13-15 maj 2025, me rastin e dërgimit të “kalorësit të Babunjës” në ekspozitën e artë të Natural History Museum (Muzeu i Historisë Natyrore) në Vjenë (Austri), e mbështetur financiarisht nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Në bazë të marrëveshjes së nënshkruar në vitin 2023 midis IA-së dhe MEKI-it është zgjidhur dhe çështja e fondeve arkeologjike. U ndërtua një godinë e re, me sipërfaqe 240 m², ku u vendosën fondet arkeologjike, që janë në administrimin e Institutit të Arkeologjisë dhe të Akademisë së Shkencave. Është përgatitur marrëveshja për nënshkrim midis Institutit të Arkeologjisë, pjesë e ASHSH-së dhe MTKS-së, për kalimin në administrim të aseteve tona në Durrës.

Pas analizës vjetore, akad. Bunguri u ndal në draftprojektet e vitit 2026. Ai e vuri theksin te projektet e bashkëpunimi me Institutin Arkeologjik të Kosovës. Memorandumi i bashkëpunimit midis IA-së së Shqipërisë dhe IA-së së Kosovës (IAK),

që po hartohet, parashikon: gjurmime të përbashkëta shkencore në fushën e prehistorisë, antikitetit dhe antikitetit të vonë dhe mesjetës në Shqipëri dhe Kosovë. Në këto gjurmime do të angazhohen specialistë dhe studentë të arkeologjisë të të dyja vendeve, si dhe do të krijohen mundësinë për financime të përbashkëta të kërkimeve në terren dhe në kabinet; botime të përbashkëta në organet shkencore të IA-së dhe IAK.

Në kuadër të bashkëpunimit me Institutin Arkeologjik të Kosovës, gjatë vitit 2026 do të zhvillohet edhe një konferencë e përbashkët shkencore me temën “Rezultatet e kërkimeve arkeologjike në Shqipëri dhe Kosovë” sipas projektit të Akademisë sonë të Shkencave.

Në vijim u diskutuan me drejtuesit e projekteve edhe problematika të kalendarit të ri vjetor dhe u dhanë ide për finalizimin me sukses të veprimtarive dhe kërkimeve shkencore.

Pas diskutimeve dhe pyetjeve për strategjitë e kërkimit shkencor dhe përfshirjen në projekte afatgjata, kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi vlerësoi punën e Institutit të Arkeologjisë dhe shprehu gatishmërinë e Kryesisë së ASHSH për të mbështetur dhe nxitur punën kërkimore. Në fund akad. Gjinushi e vuri theksin edhe te nevoja e rikonceptimit të Muzeut Arkeologjik.

www.akad.gov.al

Instituti i Antropologjisë zhvilloi mbledhjen për analizën e punës kërkimore-shkencore të vitit 2025 dhe projeksionet kryesore për vitin 2026

Më 21 janar 2026 u zhvillua takimi për analizën vjetore të veprimtarisë së punës së Institutit të Antropologjisë, pjesë e ASHSH-së.

Të pranishëm ishin zëvendëskryetari i ASHSH-së, akad. Vasil Tole; sekretarja shkencore e ASHSH-së, akad. Anila Hoda; drejtori i Institutit të Antropologjisë, prof. asoc. dr. Olsi Lelaj, dhe anëtarë të Institutit.

Prof. asoc. Lelaj paraqiti raportin e punës kërkimore-shkencore dhe arritjet e vitit 2025. Ai u ndal te zhvillimi i tri konferencave shkencore, me temat: “Thirre vendin tënd! Hapësira si kujtesë gjuhësore, historike e antropologjike”; “Histories of Anthropology in Albania, 20th– 21st Centuries” në bashkëpunim me Shkollën Franceze të Athinës, si dhe “Antropologjia dhe trashëgimia kulturore: identitete, traditë dhe transformim”.

Më pas, u paraqitën arritjet në punën kërkimore-shkencore të studiuesve të IA-së, ku gjatë vitit kanë botuar 18 artikuj shkencorë në revista shkencore vendëse dhe të huaja, si dhe kanë ligjëruar kumtesa në 25 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, krahas përfshirjes së tyre në procesin e mësimdhënies në lëndë profili në universitete vendase dhe të huaja.

Në analizë u vu në pah botimi i pesë monografive, me një të një prej tyre të botuar jashtë vendit në gjuhë të huaj, të cilat fokusohen mbi identitetin, kulturën dhe transformimet shoqërore, si dhe botimi i një raporti etnografik.



Revista “Antropologji” 2025 përmbledh artikuj studimorë të studiuesve të Institutit të Antropologjisë dhe bashkëpunëtorëve të tij, me tema: toponomastika si trashëgimi kulturore dhe

identitare, metodat dhe risitë në studimin e toponimeve si dhe raportin e toponimeve me historinë dhe bashkësitë.

Prof. asoc. Lelaj vuri në dukje se gjatë vitit 2025 u zbatuan disa projekte, ku veçoi vazhdimin e “Atlasit etnografik të fshatit shqiptar sot: thellime zonale” me kërkues të departamenteve, ku u sollën 4 artikuj shkencorë dhe 8 prezantime në konferenca në kuadër të projektit; vazhdimin e “Projektit të Toponomastikës: krijimi i skedarit të parë digjital të toponomastikës”, me 4 kërkues dhe rreth 200 bashkëpunëtorë, i cili ka sjellë 13 artikuj shkencorë dhe 15 prezantime në konferenca deri më tani. Projekti “Historitë e antropologjisë në Shqipëri”, i realizuar në bashkëpunim me Shkollën Franceze të Athinës, përfshin aktualisht 10 kërkues të Institutit të Antropologjisë dhe ka mundësuar 4 prezantime në konferenca shkencore. Ky bashkëpunim ka marrë tashmë një formë të re institucionale, ndërsa projekti “Historitë e antropologjisë në Shqipëri” është konceptuar si një nismë kërkimore afatgjatë.

Paralelisht, gjatë vitit u hodhën bazat për funksionimin e Laboratorit të Restaurimit pranë Institutit të Antropologjisë, ku janë angazhuar tre laborantë. Infrastruktura e nevojshme është përfunduar dhe restaurimet e para të fondeve arkivore pritet të zhvillohen në bashkëpunim me institucionet arkivore përkatëse. Mbetet sfidë kryesore sigurimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës së ruajtjes së fondeve arkivore dhe garantimin e standardeve bashkëkohore të konservimit afatgjatë.



Drejtori i Institutit të Antropologjisë, u shpreh se në planin institucional, vlerësohet i domosdoshëm rishikimi i përbërjes dhe funksionimit të Këshillit Shkencor, si dhe zbatimi i plotë i procesit të riorganizimit të Institutit të Antropologjisë, me synim forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe kërkimore, rritjen e pranisë ndërkombëtare të prodhimit shkencor dhe përmirësimin e qeverisjes akademike.

Krijimi i një baze studiuesish të rinj në proces doktore ose me doktoraturë të përfunduar në fushat e humaniteteve përbën një prioritet zhvillimor.

Pas analizës vjetore u bënë pyetje, propozime dhe u dhanë ide për mbarëvajtjen e punës. U mbështet propozimi që Instituti i Antropologjisë të ketë një Këshill Shkencor vetjak.

Zëvendëskryetari i ASHSH-së, akad. Vasil Tole, iu përgjigj shqetësimeve lidhur me ndryshimet e reja në fushën e arkivave, duke theksuar se krijimi i strukturës së re “Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Arkivave dhe Muzeve” nuk synon cenimin e kompetencave të institucioneve përkatëse, por forcimin e rolit mbështetës ndaj tyre. Ai theksoi, gjithashtu, se ka ardhur momenti për hartimin e zërave të “Enciklopedisë shqiptare”, duke vlerësuar si të domosdoshëm faktin që redaksitë e ngritura të jenë të përbashkëta për realizimin e këtij procesi. Brenda muajit shkurt parashikohet që redaksia qendrore të shpërndajë zërat ku anëtarët e Institutit janë të përfshirë.

Për vitin 2026 parashikohen një sërë veprimtarish kërkimore dhe shkencore, përfshirë ligjërata tematike, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, ekspedita kërkimore në kuadër të Atlasit Etnografik, prezantime laboratorike dhe ekspozita, si dhe vijimi i angazhimit të studiuesve të Institutit në procesin e mësimdhënies universitare.

U diskutua për faqen e re të revistave të Akademisë së Shkencave, e cila është një hap i rëndësishëm drejt përfshirjes në platforma ndërkombëtare si SCOPUS, dhe për hapat e ardhshëm për marrjen e ISSN-së dhe DOIs, si dhe u theksua nevoja për përkthime dhe redaktim profesional, me mundësinë që disa artikuj të publikohen drejtpërdrejt në anglisht.

Për mbarëvajtjen e punës në kërkimin shkencor u trajtua edhe çështja e përfshirjes së studiuesve të jashtëm dhe të brendshëm me kontrata specifike, për përmirësimin e bashkëpunimeve dhe shpërblimeve për pjesëmarrje në projekte.

www.akad.gov.al

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë zhvilloi takimin për analizën e punës për vitin 2025 dhe projektet për vitin 2026



Në datën 20 janar 2026 Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (IGJL) zhvilloi analizën e punës vjetore për vitin 2025.

Ishin të pranishëm kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, sekretarja shkencore e Akademisë, akad. Anila Hodaj dhe kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, akad. Gëzim Hoxha.

Akad. Valter Memisha, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, paraqiti arritjet për punën shkencore të kryer gjatë vitit që sapo u mbyll. Në raport vihej theksi, së pari në kontributin e punonjësve shkencorë në realizmin e projekteve madhore të Akademisë së Shkencave, si: puna për hartimin e Fjalorit të Madh të Gjuhës Shqipe (me 125.000 njësi fjalë, frazeologji, emërtime të pathjeshta etj.), duke mbajtur peshë kryesore në hartimin, redaktimin e përfundimin e veprës e duke përballuar mbi 35% të gjithë vëllimit të punës së kryer; në punë e bërë në për Enciklopedinë e popullit shqiptar (në redaksinë e gjuhës dhe të letërsisë); në kontributin për pasurimin e Korpusit elektronik të shqipes.



Viti 2025 njohu arritje dhe në punën me projekte ndërdepartamentore, departamentore dhe vetjake, si dhe në bashkëpunim me institucione brenda e jashtë vendit, ndër të cilat veçohen: Fjalor i termave të gjuhësisë, letërsisë dhe retorikës”; Mbi zhvillimet bashkëkohore në fushën e semantikës gjuhësore – këndvështrime e perspektiva të zhvillimit të dijes në mendimin gjuhësor shqiptar; Krijimi i Radhoit Elektronik të Toponomastikës së Shqipërisë; Prof. Eqrem Çabej në albanologji dhe në gjuhësinë europiane (A. Omari); COST Action CA21167 (UniDive) – Universality, diversity and idiosyncrasy in language technology (A. Çerpja); Gjuha vjen e para – matja e aftësive gjuhësore në moshat e hershme: identifikimi dhe trajtimi i aftësive ligjërimore për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënës (A. Çerpja); Fjalor digjital filologjik-etimologjik i shqipes së vjetër (shek. XV-XVIII) (A. Omari); COST Action CA21131 – Enabling multilingual eye-tracking data collection for human and machine language processing research, 2022 – 2026 (A. Çerpja); COST Action CA22126 (ENEOLI) – European network on lexical innovation (A. Çerpja); Korpusi elektronik i gjuhës shqipe (A. Rusakov etj.).

Gjatë vitit 2025 nga IGJL-ja u botuan 7 vepra (revista, botime aktesh, përmbledhje studimesh etj.) e konkretisht 2 numra të revistës “Studime filologjike” (1,2 /2026): Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve” (vëllimi IV); “Leksikografia shpjeguese shqipe e viteve ‘30-‘40 të shekullit XX; Letërsia e vjetër shqipe në kontekst ballkanik dhe evropian (shek. XVI-XVII) (E.Paci); Shkencat e ligjërimit dhe diskursi letrar - Variacione mbi një temë (T. Plangarica); Studime mbi sistemin foljor dhe disa çështje të tjera të shqipes së vjetër (shekujt XVI-XVII) (Ina Arapi) etj.



Nga punonjësit shkencorë u botuan gjithashtu 71 artikuj shkencorë në revista e organe shkencore të specializuara, nga të cilët: brenda vendit 40, jashtë vendit 31 nga këta 5 me SCOPUS, duke trajtuar çështje të ndryshme nga gjuhësia bashkëkohore, nga gjuhësia historike apo fusha e studimeve letrare.

Një drejtim tjetër i rëndësishëm i punës së IGJL-së gjatë vitit 2025 ka qenë organizimi i konferencave shkencore në bashkëpunim edhe me institucione të tjera në Shqipëri e Kosovë si: Tryeze shkencore mbi filologjinë si dije e saktësimi të tekstit dokumentar dhe letrar; konferencë shkencore ndërkombëtare "Frazologjia e gjuhës shqipe në arealin gjuhësor ballkanik", konferencat shkencore mbarëkombëtare "Prurje shkencore në mendimin gjuhësor shqiptar në fushën e semantikës leksikore, gramatikore, diskursive, si dhe në dijen terminologjike", "Letërsia (auto)biografike shqipe"; "Martin Camaj në 100-vjetorin e lindjes"; Peter Prifti në 100 vjetorin e tij.

Veprimtaria kumtuese në veprimtari shkencore brenda e jashtë vendit është një tjetër tregues domethënës i punës së bërë në institucion. Janë bërë gjithsej 112 kumtime e referime, nga të cilat 61 janë mbajtur brenda vendit dhe 51 jashtë vendit. U zhvilluan mbi 15 tryeza shkencore, ligjërat a takime shkencore, duke e bërë debatin shkencor pjesë organike të punës kërkimore, kumtuese e botuese.

Janë botuar dhjetëra artikuj me karakter popullarizues, janë bërë biseda në televizione, referime e informacione shkencore me auditore universitare e parauniversitare etj.

Një punë e mirë nga IGJL-ja gjatë viti 2025 u bë edhe për përgatitjen dhe miratimin e Strategjisë së zhvillimit të institucionit për periudhën 2026-2030.

Më tej, u paraqitën dhe drejtimet kryesore të punës për vitin 2026, duke u dhënë përparësi projekteve institucionale e ndërinstitutionale, përgatitjeve të monografive, projekteve në terren etj. Parësore u vlerësua puna që duhet bërë përgatitjen dhe miratimin e projektit madhor ndërinstitutional Gramatikë e gjuhës shqipe (me 4 nënprojekte Fonetikë dhe fonologji e gjuhës shqipe, Morfologji e gjuhës shqipe, Sintaksë e gjuhës shqipe: semantika sintaksore e konstrukteve, Gramatikë diskursive e gjuhës shqipe).

Pas raportit, pati diskutime të ndryshme.

Në fund, e mori fjalën kryetari i Akademisë akad. Skender Gjinushi, i cili e quajti vitin e 2025 vit të mbarë dhe vlerësoi rezultatet konkrete të punës sidomos atë me projekte, vlerësoi frymën e bashkëpunimit dhe i mëshoi faktit se Akademia do të jetë ngaherë mbështetëse e punës në institucion, e sidomos në arritjen e synimeve të vendosur për realizimeve e projekteve të reja. Kryetari u ndal dhe te stukturimi i institucionit dhe te përparësia që fiton në këto çaste kualifikimi dhe specializimi i punonësve, për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të larta që ka kërkimi shkencor sot në vend e për ta përafruar e ngritur atë në nivel evropian. Ai theksoi dhe një herë se Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë është lokomotiva e studimeve gjuhësore e letrare në Shqipëri, çka kërkon dhe më tej forcimin dhe fuqizimin e e tij në të gjitha drejtimet e punës kërkimore-shkenvore.

www.akad.gov.al

Instituti i Historisë zhvilloi takimin për analizën vjetore të punës dhe projektet për vitin 2026



Mbledhja për analizën vjetore të Institutit të Historisë u zhvillua më 19 janar 2026.

Në takim ishte i pranishëm Kryetari i ASHSH-së, akad. Skënder Gjinushi, sekretarja shkencore e ASHSH-së akad. Anila Hoda dhe kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, akad. Gëzim Hoxha.

Akad. Hamit Kaba, drejtuesi i Institutit të Historisë paraqiti raportin përmbledhës për veprimtaritë e zhvilluara gjatë vitit 2025. Ai theksoi se studiuesit e Institutit të Historisë vijuan të jenë pjesë e projekteve madhore, si “Historia e shqiptarëve”, “Enciklopedia shqiptare”, projekte të Akademisë së Shkencave, dhe “Historia e Kosovës”, projekt i Institutit të Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë.

Gjatë vitit 2025, janë botuar tri monografi dhe njëra prej tyre në gjuhën angleze. Janë botuar në total rreth 16 përmbledhje studimesh, akte konferencash, vëllime dokumentare dhe përkthime. Janë botuar dy numrat e revistës “Studime historike” të vitit 2025. Gjatë periudhës vjetore janë publikuar 29 artikuj dhe kumtesa në revistën “Studime historike”, “Albanian Studies”, “Studia Albanica”, “Kosova”, ndërsa në revistat shkencore të vendeve të BE-së janë publikuar 11 artikuj dhe 6 artikuj në revistat në Scopus.



Studiuesit e Institutit të Historisë kanë marrë pjesë në shumë konferenca shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare, konkretisht, referime: në 10 konferenca shkencore ndërkombëtare (BE); 40 konferenca shkencore ndërkombëtare brenda vendit; 2 konferenca shkencore kombëtare dhe 25 konferenca dhe aktivitete shkencore në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi.

Drejtori i Institutit të Historisë, akad. Hamit Kaba, spikati edhe disa nga arritjet e rëndësishme në strategjinë e kërkimit shkencor si: përgatitja e strategjisë 5-vjeçare të IH-së; përfshirja në platformën online e revistës “Studime historike”, si pjesë e platformës online të revistave shkencore të ASHSH-së; vijimi i hulumtimeve në arkivat më të rëndësishme europiane; organizimi i tre konferencave shkencore ndërkombëtare, në të cilat morën pjesë studiues shqiptarë dhe të huaj etj.

Më tej, ai e vuri theksin te vijimi i bashkëpunimit me institucionet analoge, ku vendin më të rëndësishëm në këtë bashkëpunim e zë Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, gjatë vitit 2025, të dyja institutet kanë organizuar 3 konferenca të përbashkëta në Tiranë dhe në Prishtinë.

Pas prezantimit të rezultateve të punë vjetore, akad. Kaba u ndal në draft-projektet e vitit 2026. Ai vuri në dukje se gjatë vitit 2026 do të vijojë puna për tri projektet madhore të sipërpërmendura të ASHSH-së dhe Institutit të Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, në të cilat janë angazhuar disa studiues të IH-së.



Puna në Institutin e Historisë do të vijojë me 18 projekte individuale, me qëllim përgatitjen dhe botimin e monografive; përgatitjen për botim të përmbledhjeve të akteve të konferencave; përgatitjen në kohë të dy numrave të revistës “Studime historike” për vitin 2026 dhe avancimin e procesit në Scopus. Me rëndësi për vitin 2026 do të jenë edhe organizimin i 3 konferencave shkencore në Tiranë dhe 2 konferencave shkencore në Prishtinë.

Pas prezantimit të draft-kalendarit u bënë pyetje dhe diskutime me drejtuesit e projekteve të Institutit të Historisë. U diskutua çështja e revistave, garantimi i cilësisë dhe periodicitetit, strategjitë e kërkimit shkencor, indikatorët e performacës, si dhe ndërtimi i arkivave etj.



Kryetari i Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi, pasi vlerësoi punën e drejtuesve dhe punonjësve të institucionit gjatë vitit 2025, dha udhëzime për forcimin e punës kërkimore, përfshirjen në projekte ndërkombëtare e më gjerë, si dhe të reflektohet në kriteret e botimeve. Gjithashtu, ai udhëzoi që të punohet për digjitalizimin e arkivave që duhen lëvruar, me synim që të vijohet më tej edhe me krijimin e një Baze të Dhënash (Databaze). Në fund të fjalës së tij, akad. Gjinushi e vlerësoi si produktive përfshirjen në projekte studimore madhore, duke shkuar drejt studimeve sa më gjithëpërfshirëse e me tema të mëdha.

www.akad.gov.al

Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të vitit 2025 dhe projeksionet e vitit 2026



Mbledhja u zhvillua në datën 12 janar 2026 në praninë e kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi, zv. kryetarit të ASHSH-së akad. Vasil Tole dhe sekretares shkencore të ASHSH-së akad. Anila Hoda.

Raporti i analizës vjetore dhe plani i punës për vitin 2026 u paraqit nga z. Andreas Dushi, drejtor i QBEA-së, i cili foli për punën e bërë me ndjekjen dhe koordinimin e tri projekteve madhore në fushën e albanologjisë.

Ai tha se është hartuar, redaktuar, korrektuar e gjithë lënda e veprës “Fjalori i madh i gjuhës shqipe”, e cila ka kaluar në platformën online. Gjatë vitit 2025 redaktorët, bashkëdrejtuesit dhe koordinatori teknik realizuan mbledhjen, njësimin dhe homologjen e lëndës, duke përgatitur kështu maketin e veprës, e cila në datën 24.12.2025 u dorëzua edhe në QBEA, edhe në Kryesinë e ASHSH-së si në variantin e shtypur, ashtu edhe në variantin digjital. Fjalori u publikua online, i hapur për publikun, në platformën e krijuar nga Sektori i Logjistikës dhe i Programacionit pranë QBEA-së, me domein “fjalori.online”.

Z. Dushi vuri në dukje se autorët e “Fjalorit të madh të gjuhës shqipe” përfshijnë një numër të madh studiuesish nga institucionet kryesore kërkimore-shkencore dhe universitare nga Shqipëria dhe nga Kosova.

Drejtori i QBEA-së e vuri theksin veçanërisht te puna që është bërë me projektin madhor “Enciklopedia shqiptare”, projekti më voluminoz dhe më kompleks që ndjek dhe koordinon Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike. Si një

bashkëpunim mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, ky projekt mbledh rreth vetes qindra bashkëpunëtorë.

Gjatë vitit 2025 janë bërë takimet e njëpasnjëshme të redaksive të të gjitha niveleve, redaksisë qendrore, redaksisë vendore, si dhe takime të përbashkëta mes redaksive gjegjëse të një fushe në Tiranë dhe në Prishtinë. Falë këtyre takimeve u bë i mundur hartimi dhe miratimi i Fjalësit të Enciklopedisë shqiptare.



Këtë vit pritët të kalohet në fazën konkrete të shkrimit dhe mbledhjes së artikujve. Në funksion të unifikimit dhe të lehtësimit të punës hartuese është hedhur në bazën e të dhënave pjesa më e madhe e “Fjalorit enciklopedik” të mëparshëm të ASHSH-së, i cili mund të ndihmojë autorët gjatë punës ose mund të përdoret për dokumentim. Janë hartuar, po ashtu, dy drafttregullore, një për mënyrën se si shkruhet një artikull enciklopedik, e cila po vazhdon të punohet nga akad. Shaban Sinani, si dhe një tjetër për mënyrën se si artikujt do të kontrollohen dhe do të hidhen në platformën online të Enciklopedisë.

Projekti i tretë madhor i ASHSH-së “Historia e shqiptarëve” realizoi një sërë procesesh hartuese dhe editoriale me rëndësi themelore për përgatitjen e veprës. Janë hartuar dy vëllimet e para të veprës, përkatësisht “Lashtësia” dhe “Mesjeta”; janë korrigjuar aspektet që kanë të bëjnë me çështjet teknike, dhe janë përforcuar momentet që duhet të profilizojnë një histori me të vërtetë të shkruar ndryshe për shqiptarët, e cila do të fillojë të botohet nga ky vit.

Drejtori i QBEA-së foli edhe për çështje të tjera të lidhura me mbarrëvajtjen e Qendrës. Gjatë këtij viti është konstituuar Bordi Shkencor i Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike, i cili ka realizuar dy mbledhje, gjatë të cilave janë diskutuar të gjitha problematikat e QBEA-së. U vu në dukje, po ashtu, edhe fakti se nga nëntori i vitit 2025 QBEA-ja u bë pjesë e Rrjetit European të Enciklopedive (EEN).



Më tej, drejtori i QBEA-së z. Dushi paraqiti planin e punës për veprimtaritë e miratuara nga bordi drejtues për vitin 2026. Edhe këtë vit do të vijojë puna për shkrimin dhe hartimin e artikujve të “Enciklopedisë shqiptare” dhe pritet që në fund të vitit të bëhet prezantimi i platformës online.

Ndër gjërat e planifikuara për tremujorin e parë (janar-mars) janë realizimi i statistikimit të të dhënave të Fjalësit të “Enciklopedisë shqiptare”, sipas një formati që do të hartohet nga akad. Sinani, ku do të dalin raportet e zërave. Është parashikuar që në tremujorin e dytë (prill-qershor) të vijojë puna me hartimin dhe nënshkrimin e një pjese të kontratave për shkrimin e artikujve enciklopedikë, ku do të bëhet sistemimi përfundimtar i platformës online të Enciklopedisë shqiptare, duke u kujdesur për disenjimin dhe funksionalitetin e saj. Në tremujorin e tretë (korrik-shtator) do të bëhet hartimi dhe nënshkrimi i pjesës tjetër të kontratave për shkrimin e artikujve enciklopedikë dhe përmbyllja e këtij procesi. Gjatë periudhës tetor-dhjetor do të bëhet

mbledhja e pjesshme e artikujve enciklopedikë, redaktimi i tyre dhe publikimi në platformën online.

Gjatë vitit 2026 për një periudhë 9-mujore nga data e publikimit online të “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” do të mblidhen mendime, sugjerime dhe plotësime për përmirësimin e tij. Redaksia e Fjalorit dhe koordinatori teknik brenda një afati 3-mujor do të pasqyrojë sugjerimet e mbledhura.

Lidhur me “Historinë e shqiptarëve”, synimi është që brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 të realizohet botimi i dy vëllimeve të para, përkatësisht “Lashtësia” dhe “Mesjeta” dhe përfundimi i proceseve editoriale (redaktim, recensim etj.) për dy vëllimet e dyta. Praktikisht, të katër redaktorët përgjegjës të secilit vëllim kanë si objektiv që projekti në tërësi të mbyllet këtë vit.

Z. Dushi foli më tej edhe për projekte të tjera që QBEA-ja parashikon të ndërmarrë, si “Kolana e fjalorëve terminologjikë”.

Po ashtu, vetë QBEA-ja, në bashkëpunim me QSA-në, si dy njësi të përhershme kërkimore-shkencore pranë ASHSH-së, po hartojnë projektpropozimin për “Fjalorin e termave të artit dhe letërsisë”, një vepër e munguar. Edhe ky projekt pritet t’i dorëzohet shumë shpejt Kryesisë së ASHSH-së për shqyrtim, pas diskutimit dhe miratimit në Bordin Shkencor të QBEA-së.

Puna e drejtuesit, bordit shkencor dhe koordinatorëve të projekteve të QBEA-së u vlerësua nga kryetari i ASHSH-së akad. Skënder Gjinushi dhe zv. kryetari akad. Vasil Tole. Pasi dha udhëzimet, akad. Gjinushi shprehu mbështetjen e kryesisë së ASHSH-së për realizimin e objektivave të vitit 2026.

www.akad.gov.al

Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës zhvilloi takimin për analizën vjetore të punës dhe projektet për vitin 2026



- Viti 2026 parashikohet si një vit i zgjerimit strategjik të QKBGJ-së, duke e pozicionuar Qendrën si një strukturë me rol kyç në zhvillimin e kërkimit biomjekësor dhe bioteknologjik në Shqipëri dhe në rajon-

Mbledhja për analizën vjetore të Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës (QKBGJ) u zhvillua më 15 janar 2026, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Në takim ishte e pranishme sekretarja shkencore e ASHSH-së, akad. Anila Hoda dhe anëtarët e komisionit.

Akad. Genc Sulçebe, drejtuesi i QKBGJ-së paraqiti raportin përmbljedhës për veprimtaritë e zhvilluara nga gjatë vitit 2025.

Ai theksoi se Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës gjatë vitit 2025 ka konsoliduar dhe zgjeruar ndjeshëm veprimtarinë e saj kërkimore në të tri sektorët kryesorë: biomjekësi humane, bioteknologji bimore dhe bioteknologji shtazore, duke shënuar një rritje të qartë si në cilësinë shkencore, ashtu edhe në ndikimin institucional dhe ndërkombëtar të rezultateve të arritura. Në sektorin e Biomjekësisë Humane, fokusi kryesor ka qenë implementimi dhe aplikimi për herë të parë në Shqipëri i një sërë ekzaminimesh të reja imunologjike dhe imunogjenetike, veçanërisht në fushën e sëmundjeve autoimmune të sistemit nervor, gjendrës tiroide dhe sëmundjeve sistematike reumatizmale.

Paralelisht, projekti madhor mbi evolucionin e imunitetit ndaj COVID-19 në popullatën shqiptare (2020–2023) është përmbyllur me sintezë shkencore dhe prezantim ndërkombëtar, duke u reflektuar edhe në botime shkencore dhe në dorëzimin për botim të një monografie përmbledhëse. Në fushën e Gjenetikes së popullatave ka avancuar më tej projekti i krijimit të Bazës gjenetike të ADN-së në popullatën shqiptare dhe i studimit të markuesve gjenetikë në këtë popullatë që do të përdoren për krahasimin me popullatat e tjera indoeuropiane.



Në sektorin e Bioteknologjisë Bimore, viti 2025 përfaqëson një kthesë cilësore. Janë organizuar disa aktivitete shkencore ndërkombëtare në Shqipëri, përfshirë tryeza dhe forume të dedikuara kriokonservimit, kulturave in vitro dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të bimëve mjekësore aromatike. Me rëndësi të veçantë është avancimi i projektit CRYOFRUIT, i cili ka mundësuar ngritjen e Kriobankës së parë Bimore në Shqipëri, si dhe zgjerimi i projektit VITROBMA, që synon prodhimin e metabolitëve dytësorë për përdorim farmaceutik, ushqimor dhe kozmetik.

Akad. Sulçebe tha se prodhimi shkencor gjatë vitit 2025 është reflektuar në një numër të konsiderueshëm artikujsh të botuar në revista ndërkombëtare, si dhe në angazhime editoriale në botime prestigjioze ndërkombëtare.

Në sektorin e Bioteknologjisë Shtazore, aktiviteti kërkimor është fokusuar në studimin e popullatave autoktone të deleve, me theks në analizat gjenetike funksionale dhe bioinformatike.

Ai vuri në dukje se gjatë vitit 2025 janë përftuar rezultate të rëndësishme që kanë çuar në botime shkencore ndërkombëtare dhe në përgatitjen e një monografie, si dhe në formulimin e bazës shkencore për projekte të reja në bashkëpunim me sektorin privat dhe institucionet financuese kombëtare.



Pjesëmarrësit diskutuan për mënyrën e organizmit të veprimtarive për vitin 2026, duke u mbështetur në arritjet e vitit 2025.

Akad. Sulçebe tha se aktiviteti i QKBGJ-së në vitin 2026 parashikohet të fokusohet në zgjerimin teknik, forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe rritjen e impaktit shoqëror dhe ekonomik të kërkimit shkencor.

Në Biomjekësinë Humane, parashikohet implementimi i metodologjive të reja të sekuencimit të ADN-së (NGS) për diagnostikimin e sëmundjeve monogjenike dhe për tipizimin me rezolucion të lartë të sistemit HLA, zgjerimi i studimeve në fushën e mjekësisë së personalizuar, veçanërisht për sëmundjet autoimmune dhe për transplantologjinë,, konsolidimi i databazave kombëtare biologjike për përdorim kërkimor dhe klinik.

Në Bioteknologjinë Bimore, viti 2026 pritët të karakterizohet nga: zgjerimi i aktiviteteve të Kriobankës Bimore me specie dhe kultivarë të rinj autoktonë, avancimi drejt aplikimeve pilot industriale të rezultateve të projekteve VITROBMA dhe CRYOFRUIT, forcimi i rolit të QKBGJ si qendër reference për rajonin ballkanik në fushën e kulturave in vitro dhe ruajtjes së gjermoplazmës.

Në Bioteknologjinë Shtazore, synohet aplikimi për projekte të reja pranë AKKSHI-t dhe burimeve të tjera financuese, zgjerimi i bashkëpunimit me sektorin privat për transfer

teknologjie, përdorimi i të dhënave gjenetike për përmirësimin e prodhimtarisë dhe shëndetit të kafshëve autoktone.



Në tërësi, viti 2026 parashikohet si një vit i zgjerimit strategjik të QKBGJ-së, duke e pozicionuar Qendrën si një strukturë me rol kyç në zhvillimin e kërkimit biomjekësor dhe bioteknologjik në Shqipëri dhe në rajon.

www.akad.gov.al

Qendra e Studimit të Arteve zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të vitit 2025 dhe projeksionet e vitit 2026



Mbledhja u zhvillua në datën 14 janar 2026, në praninë e kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi dhe të zv. kryetarit akad. Vasil S. Tole. Raporti i analizës vjetore i veprimtarive për vitin 2025 u paraqit nga akad. Stefan Çapaliku, drejtor i Qendrës së Studimit të Arteve. Ai vuri në dukje se viti 2025 përbën një etapë të rëndësishme konsolidimi për QSA-në, duke reflektuar veprimtari të dendur kërkimore, botuese, arkivore dhe institucionale. Projekte si Vjetari Artistik Shqiptar (VASH), ideimi i kolanës së botimeve “Ars Albanica”, si dhe ndërkombëtarizimi i studimeve mbi artin shqiptar, kanë shërbyer si bosht i veprimtarisë së përbashkët kërkimore të qendrës. Organizimi i konferencave ndërkombëtare, i cikleve Lectio magistralis dhe i veprimtarive publike të kërkuesve ka konsoliduar QSA-në si hapësirë reference për debatin shkencor mbi artin dhe kulturën.

Në nivel individual, studiuesit e QSA-së kanë vijuar punën me zhvillimin e monografive, artikujve shkencorë, kapitujve të librave dhe kumtesave, që kanë thelluar analizën mbi trashëgiminë artistike shqiptare, veçanërisht në raport me periudhën socialiste, tranzicionin postkomunist dhe zhvillimet bashkëkohore.



Një vëmendje e veçantë i është kushtuar punës arkivore dhe digjitalizimit, duke pasuruar ndjeshëm fondet e Qendrës së Dokumentacionit Artistik, sivjet janë shtuar 211 915 njësi, duke e çuar në total 224 727 njësi (skanime, fotografi, audio, video, dokumente) të ndarë në dosje, duke themeluar Bibliotekën e QSA-së me 2269 botime dhe Dosjet e Artistëve (DA). Paralelisht, puna redaksionale dhe botuese ka rritur dukshmërinë dhe standardet shkencore të revistës “Studime për artin” dhe të botimeve të QSA-së. Veçojmë sivjet futjen e revistës “Studime për artin” në databazën CEEOL. Gjatë vitit 2026, QSA synon të kthehet në një pikë referimi dhe bashkëpunimi për të gjithë ata që merren me studimin e arteve shqiptare, si brenda, edhe jashtë vendit, duke krijuar një rrjet të qëndrueshëm mbarëkombëtar e ndërkombëtar; do të rrisë ndërveprimin me publikun, do të kthehet në faktor për dokumentimin dhe arkivimin e materialeve artistike dhe për bashkëpunimin mes institucioneve artistike.

www.akad.gov.al

Qendra e Projekteve dhe e Koordinimit të Kërkimit Shkencor zhvilloi takimin për analizën e punës për vitin 2025 dhe planin e punës për vitin 2026



Në datën 21 janar 2026 u zhvillua mbledhja për analizën e punës për vitin 2025 dhe planin e veprimtarive për vitin 2026 me Qendrën Projekteve dhe të Koordinimit të Kërkimit Shkencor (QPKKSH).

Takimi u zhvillua në praninë e zv.kryetarit të ASHSH-së akad. Vasil Tole dhe sekretares shkencore të Akademisë së Shkencave, akad. Anila Hoda.

Drejtoresha e QPKKSH-së, prof. dr. Enika Abazi paraqiti raportin e punës për vitin 2025. Gjatë vitit 2025, QPKKSH-ja e fokusoi veprimtarinë e saj në koordinimin dhe menaxhimin administrativ të projekteve të financuara nga ASHSH-ja dhe AKKSHI dhe ndërkombëtare.

Qendra asistoi gjithsej 42 projekte: 24 të financuara nga Akademia dhe 18 nga AKKSHI. Gjithashtu, është ofruar mbështetje për aplikime ndërkombëtare, ku projekti "Infra Soil Array" i financuar në kuadër të Horizont Europe rezultoi i suksesshëm. Viti 2025 vlerësohet si shumë produktiv, me fokus në mbështetjen në fazat fillestare, administrimin e fondeve dhe forcimin e bashkëpunimeve në kuadrin e projekteve të ndryshme.

Më tej, prof. dr. Abazi e vuri theksin te përmirësimi i menaxhimit të projekteve kërkimore. Ajo u shpreh se QPKKSH-ja, në konsultim me drejtuesit e Akademisë së Shkencave, ka propozuar zhvillimin e një platforme digjitale të integruar. Platforma synon të automatizojë dhe standardizojë proceset e aplikimit dhe ndjekjes, të lehtësojë

komunikimin ndër-njësi dhe të sigurojë transparencë në kohë reale për statusin dhe financimin e projekteve.

Qendra (QPKKSH) ka krijuar një infrastrukturë standarde dokumentesh për të thjeshtuar dhe garantuar cilësinë e menaxhimit të projekteve kërkimore në ASH. Kjo "shportë e plotë" synon të eliminojë konfuzionin, të rrisë transparencën dhe të lehtësojë punën për të gjithë pjesëmarrësit.

Drejtoresha e QPKKSH-së paraqiti edhe strategjitë organizative dhe bashkëpunuese në mbështetje të komunitetit kërkimor-shkencor të ASHSH-së.

Qendra (QPKKSH) ka kryer tri lloje kryesore aktivitete: Informim dhe rritje e kapacitetit aplikues: Organizoi "Ditë Informuese" me AKKSHI për të sqaruar mundësitë, procedurat dhe kërkesat e financimit kombëtar, duke ofruar udhëzime praktike për aplikim.; Zgjerim i mundësive të financimit: Përpiloi dhe shpërndau informacione sistematike mbi skema të ndryshme financimi, përfshirë fondet evropiane dhe ndërkombëtare, duke e ruajtur komunitetin të informuar për trendet dhe mundësitë e reja.; Monitorim dhe zgjidhje pengesash: Kreu vlerësime në terren, si një vizitë në Qendrën e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës (QBGJ), për të identifikuar dhe ndihmuar në kapërcimin e pengesave konkrete operative, të tilla si prokurimi i pajisjeve dhe përshtatshmëria e hapësirave.



Nëpërmjet këtyre veprimeve, Qendra vepron si një lidhje thelbësore mbështetëse

për komunitetin kërkimor.

Pasi u diskutuan prioritetet në koordinimin dhe menaxhimin administrativ të projekteve, prof. dr. Enika Abazi paraqiti planin e punës për QPKKSH-në në vitin 2026.

Ajo theksoi se pjesë e projekteve të këtij viti do të jenë katër sfera kryesore veprimtarie.

QPKKSH do të forcojë rolin e saj si pikë qendrore për menaxhimin holistik të të gjithë ciklit të projektit dhe për koordinimin e integruar ndërmjet njësive shkencore dhe administrative; do të vazhdojë organizimi i ditëve informuese për të kapërcyer pengesat në aplikim dhe për të zgjeruar horizontin e kërkuesve për skema prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë programe të BE-së; do vazhdojë të kryejë analizën e rezultateve shkencore (botime, konferenca) për të matur ndikimin dhe për të informuar përmirësimin e punës, duke mbështetur edhe parimet e Shkencës së Hapur; do të fokusohet në vënien në eficiensë të marrëveshjeve ekzistuese me qëllim krijimin e konsorciumeve si baze e aplikimit në projektet Europiane, dhe zhvillimin e projekteve dypalëshe.

Në fund, prof. dr. Abazi, e vlerësoi si shumë të rëndësishëm nënshkrimin e marrëveshjeve strategjike me entitete të biznesit me qëllim ngushtimin e hendekut akademi-biznes.

www.akad.gov.al

Qendra kërkimore e nanoteknologjisë NanoAlb zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të vitit 2025 dhe projeksionet e vitit 2026



Mbledhja u zhvillua online në datën 7 janar 2026. Pjesë e takimit online ishin akad. Anila Hoda, sekretarja shkencore e ASHSH-së; akad. Neki Frashëri, kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike; akad. Arben Merkoçi drejtuesi i qendrës, si dhe drejtuesit e grupeve nanoalb nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut etj. Moderimi i takimit u bë nga akad. Arben Merkoçi.

Raporti i analizës vjetore i veprimtarive për vitin 2025 u paraqit nga prof. dr. Kledi Xhaxhiu, bashkë-koordinator i Qendrës NanoAlb. Ai vuri në dukje se gjatë vitit 2025, Qendra Kërkimore NanoAlb ka shënuar një progres të qëndrueshëm dhe të gjithanshëm në veprimtarinë e saj kërkimore, duke forcuar pozicionin si një platformë rajonale e rëndësishme për nanoshkencën dhe nanoteknologjinë në Ballkan dhe më gjerë.

Ndër arritjet kryesore të punës njëvjeçare ishin realizimi si organizator apo bashkëorganizator i 12 veprimtarive shkencore, ku përfshihen konferenca, simpoziume dhe workshope shkencore, mes të cilave më të rëndësishmet ishin: Konferenca ndërkombëtare nanoBalkan2025, mbajtur në Tiranë, me 193 pjesëmarrës nga mbi 20 vende; simpoziumi shkencor Women in NanoScience i dedikuar promovimit të grave në STEM dhe shkencat nano; workshope tematike mbi nanomjekësinë, biosensorët, energjinë e gjelbër dhe lidhjen shkencë-industri. Në kuadër të punës së realizuar të zbatimit të projekteve kërkimore NanoAlb zbatoi 6 projekte kërkimore të financuara nga ASHSH, me fokus në: Nanobiosensorë për detektimin e pesticideve; Diagnostikimin e hershëm të sëmundjeve të bimëve; Zhvillimin e materialeve antivirale dhe antibakteriale; Terapi të drejtuara për kancerin e gjirit; Aplikimin e inteligjencës artificiale në nanotoksikologji.

Një tjetër arritje e qendrës janë dhe botimet shkencore, ku gjatë vitit 2025 janë realizuar 50 botime shkencore, nga të cilat 31 të indeksuara në Scopus dhe web of Science, duke

reflektuar cilësinë dhe ndikimin ndërkombëtar të kërkimeve të qendrës në fusha si: nanomjekësia, biosensorët, materialet e avancuara, mbrojtja e mjedisit. Pjesë e punës ka qenë dhe pjesëmarrja në konferenca, simpoziume, workshope dhe organizim i shkollave verore dhe trajnimi i studiuesve të rinj në fushën e nanoteknologjisë

Për sa i përket projeksonit të veprimtarive për vitin 2026, prof. dr. Majlinda Vasjari u ndal në punën që duhet planifikuar në organizimin e konferencës ndërkombëtare nanoBalkan2026. Gjithashtu bazuar në eksperiencën dhe traditën e ngritur për organizimin e workshopeve, shkollave verore dhe trajnimet e studiuesve të rinj duhen planifikuar zgjerimi i rrjetit të bashkëpunorëve dhe një shtrirje edhe më e madhe e ndikimit të këtyre nismave shkencore. Pjesë e punës për këtë vit të ri do të jetë dhe finalizimi i strategjisë kombëtare për Qendrën e Nanoteknologjisë, si dhe zgjerimi i projekteve kërkimore dhe i bashkëpunimeve ndërkombëtare.

www.akad.gov.al

Njësia Kërkimore e Inteligjencës Artificiale zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të vitit 2025 dhe projeksionet e vitit 2026



Në datën 9 janar 2026 u zhvillua online takimi për analizën e veprimtarive të Njesisë Kërkimore të Inteligjencës Artificiale, ku i pranishëm ishte dhe Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi.

Mbledhja u moderua nga akad. Neki Frashëri, kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike.

Raporti i punës u paraqit nga akad. Arjan Durrësi, drejtues i Njesisë, së bashku me prof. dr. Ana Ktona, i cili vuri në dukje se gjatë periudhës korrik-dhjetor 2025 përfundoi me sukses aktiviteti i parë i projektit “IA Shkakësore – Një Framework i Ri për Marrjen e Vendimeve në Mjekësinë e Personalizuar”. Ai tha se në këtë fazë u ndërtua baza bashkëpunuese ndërdisiplinore, duke përfshirë ekspertë nga intelijenca artificiale, mjekësia dhe shkencat e të dhënave; u identifikuan pyetjet kryesore kërkimore dhe datasete të përshtatshëm, kryesisht të bazuara në Regjistrat Elektronikë Mjekësorë (EMR), për aplikimin e metodave të AI shkakësore në mjekësinë e personalizuar.

Gjithashtu, u realizuan workshop-i hibrid (online/fizik) me pjesëmarrje nga AI (inteligjenca artificiale), ML (machine learning) dhe mjekësia për shkëmbim njohurish dhe diskutim metodologjik; formulimi i pyetjeve kërkimore të fokusuara në AI shkakësore dhe aneurizmat cerebralë; identifikimi dhe diskutimi i dataseteve me fusha tipike EMR, të anonimizuara dhe të strukturuar; studimi pilot në aneurizmat cerebralë

dhe trajtimi endovaskular (coiling); analiza sistematike e literaturës në fushën e AI-së dhe aneurizmave intrakranialë; përgatitja e artikullit përmbledhës mbi IA-në dhe rrezikun e çarjes së aneurizmave.

Më tej ai tha se një sukses i Njesisë ishte dhe realizimi i forumit të parë të projektit në dhjetor me specialistët e interesuar, i cili shërbeu për diskutimin e metodologjisë, shkëmbimin e njohurive dhe konsolidimin e rrjetit të partnerëve kërkimorë për fazat pasuese.

Gjatë periudhës janar-qershor 2026 do të vijojë zbatimi i projektit “IA Shkakësore – Një Framework i Ri për Marrjen e Vendimeve në Mjekësinë e Personalizuar”, ku në qendër të punës do të jetë konsolidimi i rezultateve të fazës së parë dhe ndërtimi i bazës shkencore për fazat pasuese kërkimore. Në këtë periudhë parashikohet dorëzimi për publikim i artikullit të parë shkencor, i cili përmbledh analizën për përdorimin e inteligjencës artificiale në vlerësimin e rrezikut të çarjes së aneurizmave intrakranialë.

Pas diskutimeve me anëtarët e njesisë, përparësitë për vitin 2026 do të jenë zgjerimi i rrjetit brenda dhe jashtë vendit dhe nxitja e bashkëpunimit midis grupeve, ndërkohë do të vijojë puna për gjetje të zbatimeve të inteligjencës artificiale në fushën e mjekësisë së personalizuar bazuar në të dhënat që ka vendi ynë dhe do të vijohet me realizimin e aktiviteteve të planifikuara sipas kronologjisë së miratuar.

www.akad.gov.al

Njësia Kërkimore e Gjeoshkencave dhe Gjeoinxhinierive zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të vitit 2025



Takimi i Njesisë Kërkimore të Gjeoshkencave dhe Gjeoinxhinierive për analizën e veprimtarive të vitit 2025 dhe projeksionet e vitit 2026 u zhvillua në datën 12 janar 2026, me pjesëmarrje fizike dhe online.

Raporti i analizës vjetore u paraqit nga akad. asoc. Rrapo Ormëni, drejtues i Njesisë Kërkimore të Gjeoshkencave dhe Gjeoinxhinierive, ku ishin të pranishëm sekretarja shkencore, akad. Anila Hoda dhe Kryetari i Komisionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike akad. Neki Frashëri.

Akad. asoc. Ormëni, fillimisht dha një informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë organizative të Njesisë. Njësia ka zhvilluar disa mbledhje me diskutime mbi detyrat në vijimësi bazuar në objektivat dhe aktivitetet e planifikuara, të cilat kanë rezultuar me zgjedhjen e Këshillit Shkencor të Njesisë; përcaktimin e detyrave në vijimësi etj. Është realizuar përmirësimi dhe administrimi i një database me strukturën e Njesisë dhe të dhënat mbi bashkëpunëtorët e Njesisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Komunikimi i ka qenë i vazhdueshëm me pjesëmarrjen e përbashkët në aktivitetet shkencore.

Më tej, akad. asoc. Ormëni theksoi disa nga veprimtaritë kryesore për vitin 2025, të realizuara nga Njësia Kërkimore e Gjeoshkencave dhe Gjeoinxhinierive, të cilat janë

kurorëzuar me rezultate dhe rekomandime të rëndësishme në fushën e risqeve gjeologjike e sizmike, ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e integruar të burimeve ujore.



Punimet kërkimore, projektet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe botimet kryesore të realizuara gjatë periudhës vjetore kanë shërbyer si një instrument strategjik për vlerësimin e rrezikut sizmik, reduktimin e riskut nga fatkeqësitë dhe zhvillimin e qëndrueshëm territorial dhe duke dhënë rezultate të avancuara shkencërisht, veçanërisht në fushat e mëposhtme: modelimit sizmotektonik dhe analizës së burimeve sizmike aktive; vlerësimin të stokut ekzistues të ndërtesave dhe cënueshmërisë strukturore ndaj tërmeteve; identifikimit dhe hartëzimit të zonave të ndjeshme ndaj lëngëzimit sizmik dhe proceseve të rrëshqitjeve masive; vlerësimin të ndryshimeve mjedisore dhe ndikimit të tyre në stabilitetin gjeologjik dhe gjeoteknik; analizës së tendencave dhe impakteve të ndryshimeve klimatike në dinamikën e proceseve gjeologjike dhe hidrogeologjike.

Pas diskutimeve me anëtarët e njesisë, për vitin 2026 u përcaktuan disa përparësi strategjike kërkimore dhe aplikative, të cilat synojnë thellimin e mëtejshëm të studimeve dhe zgjerimin e bashkëpunimeve shkencore, ndër to si: zhvillimi i studimeve të avancuara mbi mikrozonimin sizmik dhe gjeoteknik, duke integruar të dhëna nga teknologjitë e reja; hartimi i metodologjive të përmirësuara për mbrojtjen nga rreziqet gjeologjike dhe reduktimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore; studimi i gjeodinamikës së formacioneve evaporitike dhe ndikimit të tyre në stabilitetin e terrenit dhe të veprave inxhinierike; vlerësimi i riskut sizmik në objektet arsimore, me qëllim rritjen e sigurisë

së nxënësve dhe personelit arsimor; identifikimi dhe zhvillimi i fushave të interesit të përbashkët kërkimor midis Shqipërisë dhe Kosovës në fushën e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierisë; zgjerimi i studimeve në gjeoinxhinierinë e ujërave nëntokësore, për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore dhe parandalimin e ndotjes apo mbishfrytëzimit të tyre.

Në tërësi, këto drejtime prioritare synojnë forcimin e kapaciteteve kërkimore, rritjen e impaktit praktik të rezultateve shkencore dhe konsolidimin e rolit të institucionit si një qendër reference në fushën e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierisë në nivel kombëtar dhe rajonal.

www.akad.gov.al

Nxitja e interesit të brezave të rinj për matematikën mbetet një nga synimet e punës së Institutit Kombëtar të Matematikës



-Veprimtaria e punës së Institutit Kombëtar të Matematikës gjatë vitit 2025 dhe drejtimet për vitin 2026-

Takimi për analizën e veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Matematikës gjatë vitit 2025 dhe projeksionet e vitit 2026 u zhvillua online, në datën 8 janar 2026, me drejtimin e prof. dr. Fioralba Cakoni, drejtuese ekzekutive e Institutit Kombëtar të Matematikës-IKM, njësi virtuale pranë ASHSH-së.

IMK vijon të jetë një pikë referimi për zhvillimin e kërkimit shkencor në matematikë dhe për ndërtimin e një rrjeti bashkëpunimi mes matematikanëve shqiptarë brenda dhe jashtë vendit. Fokus kryesor mbetet shkëmbimi i përvojave, përditësimi shkencor dhe krijimi i hapësirave bashkëkohore të debatit akademik.

Gjatë vitit 2025, IKM realizoi me sukses një sërë veprimtarish shkencore, ndër to Konferenca e 3-të Kombëtare e Matematikës, workshopi EDUMAT-2025 mbi didaktikën e matematikës, si dhe seminare dhe webinare tematike. Një projekt me rëndësi të veçantë është DBMAT-2025 – Baza e të dhënave e kërkimit shkencor në matematikë, e realizuar mbi 80%, e cila synon të sistemojë informacionin shkencor dhe të krijojë grupe kërkimi sipas fushave dhe nënfushave të matematikës.

Një moment i rëndësishëm institucional ishte dekorimi nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë i prof. dr. Fioralba Cakoni, Drejtore Ekzekutive e IKM, me titullin “Kumandar i Lisit Akademik”, si vlerësim për kontributin e saj të shquar në shkencën e matematikës dhe kërkimit shkencor.

Viti 2026 do të fokusohet në forcimin e bashkëpunimit me matematikanët shqiptarë brenda dhe jashtë vendit, përfundimin e projektit DBMAT, projekte të përbashkëta në kuadër të Erasmus+, mobilitet studentor, bashkë-udhëheqje doktoratash dhe vijimin e

projektit READ me universitetet publike. Gjithashtu, 2026-a shënon 20-vjetorin e Revistës AJNTS, me një numër special kushtuar matematikës, si dhe organizimin e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

Matematika mbetet një shkencë bazë, që ndërthur dhe mbështet zhvillimin e shkencave të tjera nga teknologjia dhe inxhinieria, te ekonomia, inteligjenca artificiale etj. Investimi në formimin matematikor është një investim në të ardhmen, pasi te të rinjtë zhvillon mendimin kritik, aftësinë analitike dhe krijon mundësi reale në tregun global të dijes dhe inovacionit.

Aktualisht në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Natyrës, FSHN, po forcohet bashkëpunimi për zhvillimin e leksioneve dhe mentorimeve të përbashkëta midis profesorëve nga diaspora dhe profesorëve shqiptarë në hartimin e korrikulave të përbashkëta në disiplinën Data Science, i cili është një drejtim që ka nxitur interesin e maturantëve (në pranimet e vitit 2025-2026 u regjistruan 120 studentë me rezultate shumë të larta). Një rezultat i matshëm janë edhe publikimet dhe referimet në konferenca shkencore në buletine të indeksuar në databazën Scopus, të doktorantëve në matematikë dhe matematikë të aplikuar në bashkëpunim me matematikanë nga diaspora (F. Xhafa dhe S. Janaqi). Gjatë këtij viti do të planifikohet organizimi i një shkolle verore për studentët doktorantë në bashkëpunim me FSHN dhe Universitetin e Graz-it për vitin e ardhshëm.

www.akad.gov.al

Veprimtaria e Bibliotekës Shkencore dhe Qendrës për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor të ASHSH për vitin 2025



Në datën 9 janar 2026, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua mbledhja për prezantimin e veprimtarisë vjetore për vitin 2025, një moment i rëndësishëm reflektimi mbi arritjet dhe drejtimet strategjike në shërbim të komunitetit shkencor.

Në këtë aktivitet morën pjesë zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave, akad. Vasil S. Tole, drejtuesja e Bibliotekës Shkencore dr. Albana Velianj, drejtuesja e Qendrës së Koordinimit dhe Përhapjes së Informacionit Shkencor (QKPISH) msc. Mirlona Buzo, si dhe specialistë të bibliotekës dhe qendrës.

Drejtuesja e QKPISH-së msc. Mirlona Buzo në raportin e saj vuri në dukje kontributin e qendrës në menaxhimin, digjitalizimin dhe shpërndarjen e informacionit shkencor në Shqipëri, në bashkëpunim të ngushtë me bibliotekat universitare, publike dhe institucionet kërkimore.

Gjatë vitit 2025, QKPISH ka shënuar arritje të rëndësishme lidhur me: zgjerimin e rrjetit të kërkuesve shkencorë në sistemin [ECRIS.AL](https://ecris.al); rritjen e numrit të bibliotekave anëtare në rrjetin kombëtar të informacionit shkencor [COBISS.AL](https://cobiss.al), përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit; kualifikimin profesional të specialistëve të informacionit për marrjen e licencave në sistemin [COBISS.AL](https://cobiss.al); organizimin e konferencës ndërkombëtare “Shkenca e hapur dhe infrastruktura e informacionit shkencor në Shqipëri” (19 nëntor 2025); rritjen cilësore të regjistrimeve në sistemin [COBISS.AL](https://cobiss.al); sigurimin dhe shpërndarjen e burimeve elektronike me tekst të plotë për bibliotekat anëtare të konsorciumit në Shqipëri.

Në funksion të arritjes së objektivave strategjike, prioritetet kryesore të Qendrës për vitin 2026 do të përqendrohen në: garantimin e aksesit të hapur, të qëndrueshëm dhe transparent në rezultatet dhe të dhënat e kërkimit shkencor shqiptar; forcimin e mekanizmave për promovimin, monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve të kërkimit shkencor; zhvillimin dhe modernizimin e shërbimeve digjitale në mbështetje të kërkuesve shkencorë;

zgjerimin e integritit të burimeve online me tekst të plotë për të rritur cilësinë dhe efikasitetin e kërkimit; zbatimin sistematik të standardeve ndërkombëtare në proceset e digjitalizimit dhe përpunimit të informacionit; rritjen e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së institucioneve kërkimore në rrjetet e përbashkëta të informacionit shkencor.

Drejtuesja e Bibliotekës Shkencore, dr. Albana Velianj, vuri në dukje rolin thelbësor të bibliotekës në mbështetje të kërkimit shkencor dhe paraqiti veprimtarinë dhe rezultatet kryesore për vitin 2025.

Gjatë vitit 2025, veprimtaria e Bibliotekës Shkencore u karakterizua nga arritje të rëndësishme në: digjitalizimin e fondit bibliotekar, me fokus të veçantë te fondet e instituteve shkencore albanologjike; regjistrimin e artikujve shkencorë dhe botimeve të kërkuesve në sistemet ndërkombëtare të informacionit shkencor; pasurimin e Bibliotekës Digjitale me dhjetëra botime shkencore me tekst të plotë; hartimin e Rregullores së Brendshme të Bibliotekës për sigurimin e standardeve në administrimin e fondeve, zhvillimin e koleksioneve dhe ofrimin e shërbimeve.

Në bashkëpunim me QKPISH-në u realizuan gjithashtu: krijimi i bibliografive shkencore online, si mjete orientuese dhe referuese për studiuesit; digjitalizimi i revistave shkencore dhe rritja e dukshmërisë së kërkimit shkencor shqiptar në platformat ndërkombëtare; sigurimi i aksesit në burime shkencore ndërkombëtare, në mbështetje të kërkimit dhe studimeve akademike.

U paraqitën edhe prioritetet e Bibliotekës Shkencore për vitin 2026: digjitalizimi i informacionit shkencor të fondit të Bibliotekës Shkencore; pasurimi i Bibliotekës Digjitale me botime shkencore të ASHSH-së; përmirësimi dhe ofrimi i qasjes në burime ndërkombëtare; bashkëpunimi me biblioteka brenda dhe jashtë vendit; si dhe zhvillimi profesional i stafit.

Ne përmbyllje, akad. Vasil S. Tole vlerësoi rëndësinë strategjike të promovimit dhe përhapjes së informacionit shkencor, duke theksuar nevojën për aktivitete nxitëse dhe motivuese për kërkuesit shkencorë dhe bibliotekat universitare. Ai nënvizoi si prioritet themelor digjitalizimin e plotë të fondit të Bibliotekës Shkencore të Akademisë së Shkencave, si kusht i domosdoshëm për rritjen e aksesit, transparencës së informacionit shkencor.

www.akad.gov.al

Të tjera

Akademia e Shkencave uron në ditën e tij të lindjes shkrimtarin dhe akademikun e saj Fatos Kongoli



Matematikian dhe shkrimtar, akademikun Fatos Kongoli ka sot ditën e tij të lindjes. Akademia e Shkencave i uron:

Jetë të gjatë, shëndet e suksese në krijimtari!

Fatos Kongoli lindi në Elbasan më 1944-n. Studimet e larta për matematikë i nisi në Universitetin e Pekinit dhe i përfundoi në Universitetin e Tiranës (1967). Ka punuar për një kohë si gazetar dhe më pas si redaktor në shtëpinë botuese "Naim Frashëri". Filloi të botonte tregime e novela në shtypin letrar nga fundi i viteve '60. Deri në vitet 1990 ka botuar vëllimet me tregime "Shqetësime të ngjashme" (1972), "Tregime" (1978), "Të fejuarit" (1982), si dhe romanet "Ne të tre" (1985), "Karuseli" (1990). Në tregimet dhe novelat e tij të para F.K. për zgjedh "jetët e vogla" njerëzore, duke paraqitur bashkë virtyte dhe cene të individualiteteve të botës shqiptare. Prej vitit 1990 priret nga romani: "I humburi" (1992), "Kufoma" (1994), "Dragoi i fildishtë" (1999), "Ëndrra e Damokleut" (2001), "Lëkura e qenit" (2003, fitues i çmimit "Pena e artë"), "Te porta e Shën Pjetrit" (2005), "Jetë në një kuti shkrepësesh" (2007), "Bolero në vilën e pleqve" (2009), "Iluzione në sirtar" (2010), "Si-do-re-la" (2011), "Njeriu me fat" (2013), "Gjemia e mbytur" (2015) etj. Me romanet ai thelloi tiparet e individualitetit të vet krijues. Merita e veçantë e tyre

është trajtimi i temave të kohës së sotme, paraqitja e njeriut të shoqërisë së hapur me rreziqet që i kanosen, si rreziku riideoogjizues, shpërbërja, shthurja e idealeve, kurdisja e mekanizmave të tjerë të orientimit të njeriut në jetë. Vepra të tij janë botuar në njëmbëdhjetë gjuhë të huaja, me jehonë në disa nga gazetatat dhe revistat më të mëdha europiane. Ka fituar tri herë çmimin “Pena e argjendtë” për librin më të mirë në prozë (1995, 2000, 2002), si dhe çmime të tjera brenda dhe jashtë vendit. Është nderuar me titullin “Kalorës i Legjonit të Nderit” (2010) nga Presidenti i Francës, dhe “Mjeshtër i madh” (2012) nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Në vitin 2017 është nderuar me titullin Doktor “Honoris Causa” nga Universiteti “Ismael Qemali”, Vlorë.

www.akad.gov.al

Akademia e Shkencave uron në datën e tij të lindjes albanologun Bernd Jürgen Fischer



Albanologu Bernd Jürgen Fischer, historian, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ka sot ditëlindjen. Akademia e Shkencave i uron:

Jetë të gjatë, shëndet e suksese në krijimtari!

Bernd J. Fischer lindi më 27 janar 1952 në Bynde, në Gjermani. U diplomua për histori në Universitetin e Kalifornisë në Santa Barbara (1973) dhe mori gradën doktor në vitin 1982. Ai punoi në universitete të ndryshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Londër e në Kanada. Që nga viti 2001 punon në Universitetin e Indianës, në Fort Wayne (SHBA), si përgjegjës i departamentit të historisë.

Bernd J. Fischer është anëtar i Bordit të Programit të Studimeve Shqiptare, Shkolla e Studimeve të Europës Lindore dhe Sllave, University College, London dhe profesor i asociuar i Institutit Shqiptar të Studimeve Ndërkombëtare në Tiranë. Fushat kryesore të veprimtarisë së tij janë: historia moderne e Ballkanit, historia moderne e Europës Perëndimore, historia e Rilindjes Europiane, historia e Europës Lindore dhe historia krahasuese e qeverive moderne europiane. Ka botuar disa monografi dhe një varg artikujsh për historinë politike, shoqërore, ushtarake, kulturore të shqiptarëve në shtetin shqiptar dhe në Kosovë.

Është autor i një sërë librash rreth Shqipërisë, duke përfshirë “King Zog and the Struggle for Stability in Albania” (Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri); “Albania at War, 1939 - 1945” (Shqipëria gjatë luftës, 1939 - 1945), "Identitete shqiptare,

miti dhe historia". Në këto monografi, që mbështetet mbi një dokumentacionin të pasur arkivor, Fischer bën përpjekje për të trajtuar me objektivitet një periudhë me ngjarje e figura që kanë ngjallur shumë diskutime shkencore. Gjithashtu, Fischer është bashkautor me Oliver Jens Schmitt i librit "Një histori e përmbledhur e Shqipërisë" dhe autor i librave "Diktatorët e Ballkanit", "Enver Hoxha dhe diktatura staliniste në Shqipëri".

www.akad.gov.al

Akademia e Shkencave uron në datën e tij të lindjes albanologun Titos Jochalas



Albanologu grek Titos Jochalas (Titos Johalas), anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ka sot ditëlindjen. Akademia e Shkencave i uron:

Jetë të gjatë, shëndet e suksese në krijimtarinë shkencore!

Titos Jochalas lindi në Janinë më 28 janar 1942. Ai kreu gjimnazin “Zosimea” të Janinës. Më pas studioi filologji klasike në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Athinës. Në vitin 1965, pasi mbrojti diplomën në Universitetin Capodistria të Athinës, ai shkoi për të kryer studimet në albanologji në Palermo të Italisë. Ndërkohë, jepte mësim në kurset e gjuhës greke në Universitetin e Palermos dhe kryente specializimin në filologji moderne pranë katedrës helenistike dhe në albanologji pranë katedrës së themeluar nga Gaetano Petrotta, që asokohe drejtohej prej Zef Valentinit. Në Palermo, Jochalas-i në moshën 26-vjeçare botoi librin “Studimet albanologjike në Greqi”. Aty ai njohu nga afër komunitetin arbëresh të Horës dhe studioi me vëmendje të veçantë arbëreshët e Sicilisë. Lidhi një miqësi të fortë e bashkëpunim të frytshëm me arbëreshin e madh Antonio Guzzetta, i biri i Giorgio Guzzetta-s, themelues i seminarit greko-shqiptar të Palermos.

Gjatë vitit akademik 1967-1968, Jochalasi diplomohet me një tezë me titullin “Tekste greko-shqiptare të Çamërisë (Thesprotisë)” me një pasuri të rrallë gjuhësore të arbërishtes dhe të trashëgimisë së saj letrare. Historisë së mërgimit të shqiptarëve drejt

Italisë, Jochalasi i ka kushtuar një pjesë të mirë të energjive të tij intelektuale. Në Palermo gjeti dhe shoqen e tij të jetës Lidian.

Fillimisht ai punoi si punonjës shkencor i Akademisë së Athinës. Ka drejtuar Qendrën Greke për Studime të Europës Juglindore në Athinë dhe ka botuar vazhdimisht studime e monografi mbi pakicën shqiptare në Greqi, gjuhën dhe folklorin e tyre. Ndër librat e tij të fundit janë: "Arbanitika paramythia kai doxasies" (Tregime dhe besime popullore arvanitase), Athinë 1997; "Euboia: ta Arbanitika" (Eubea: Arvanitishtja) Athinë 2002; "Hydra: lêsmonêmenê glôssa" (Hydra: Një gjuhë e harruar) Athinë 2006.

Në vitin 2010 u botua monografia "Andros: Arbanitês kai Arbanitika" (Andros: Shqiptarët dhe arvanitishtja). Ai dëshmon se në pjesën veriore të Androsit gjenden 29 fshatra arvanite. Monografia bën fjalë për historinë e këtij ngulimi arvanit dhe jetën e banorëve të tij.

Në vitin 2011 ai botoi monografinë "Hê arbanitia sto Moria: chronika poreias" (Shqiptarët në More: Analet e kronikave të kohës).

Me interes të veçantë është "Fjalori i arvanitishtes së Hidrës", mbledhur nga Jochalas-i në vitet 1987 dhe 2002-2004.

Më 2019 prof. T. Jochalas boton "Fshatrat shqipfolese te Thrakës, histori dhe gjuhë" me shumë tekste dhe vjersha popullore dhe një fjalor mjaft të pasur.

Titos Jochalas është anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë që nga viti 2012, dhe punonjës shkencor për shumë vite i Akademisë së Shkencave të Greqisë.

Ai i ka dhuruar albanologjisë vepra themelore për arvanitët e Atikës, të Peloponezit, të Hidrës; vepra për historinë shqiptare që nga Gjergj Kastrioti, Ali pasha i Tepelenës, kapedanët shqiptarë të revolucionit grek të 1821-së, Fan Nolin dhe figura të tjera.

Me veprat e tij, Titos Jochalas ka dëshmuar trashëgiminë e paçmuar që ruhet nga komunitetet arvanite të Greqisë.

www.akad.gov.al

In memoriam

Kujtojmë Gjergj Kastriot Skënderbeun, një nga figurat më mëdha të historisë shqiptare dhe të Europës së shekullit XV



Më 17 janar 1468 u nda nga jeta Gjergj Kastrioti Skënderbeu, figura më përfaqësuese e historisë shqiptare dhe një nga udhëheqësit politikë e ushtarakë më të spikatur të Europës së shekullit XV.

Veprimtaria e tij nuk ishte thjesht rezistencë ushtarake, por një "projekt" shumëdimensional pushteti, organizimi dhe diplomacie, që i vendosi trojet arbërore në hartën politike të kohës.

Konsolidimi i autoritetit të tij nisi me rimarrjen e Krujës në nëntor 1443 dhe u institucionalizua me Kuvendin e Lezhës më 2 mars 1444, ku ai themeloi Besëlidhjen e Lezhës si strukturën e parë të përbashkët politike dhe ushtarake arbërore. Nën udhëheqjen e Skënderbeut, forcat shqiptare shënuan fitore vendimtare në Torvioll, Domosdovë, Pollog dhe Vajkal, duke demonstruar një art të avancuar të komandimit dhe shfrytëzimit strategjik të terrenit.

Paralelisht, Skënderbeu zhvilloi një veprimtari të qëndrueshme diplomatike me Selinë e Shenjtë (Vatikanin), Mbretërinë e Napolit dhe qytet-shtetet italiane, duke e pozicionuar

qëndresën arbërore si pjesë të ekuilibrave europianë. Në historiografinë bashkëkohore, ai vlerësohet si faktor themelor në formësimin e vetëdijes politike dhe shtetërore të shqiptarëve, ndërsa trashëgimia e tij mbetet boshti qendror i vazhdimësisë historike dhe identitare shqiptare në kontekstin europian.

<https://youtu.be/2ICS10vPbjw?si=07ffLHB7TKuh3xAs>

www.akad.gov.al

Sot, kujtojmë ditëlindjen e Ismail Qemalit, udhëheqës i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare



Akademia e Shkencave kujton në ditën e lindjes Ismail Qemalin, udhëheqës i Lëvizjes kombëtare shqiptare, themelues i shtetit të pavarur shqiptar dhe Kryeministër i parë i Shqipërisë, Hero i Popullit.

Ismail Qemali u lind në Vlorë më 16 janar 1844, në një nga familjet më të mëdha të Shqipërisë së Jugut. Ishte djali i Mahmut bej Vlorës dhe Hedië hanëm Libohovës.

Pasi kreu shkollën fillore në vendlindje, vijoi studimet në shkollën plotore turke në Selanik, ku ishte internuar familja e tij dhe më pas kreu gjimnazin “Zosimea” në Janinë. Në vitin 1860 punoi si përkthyes pranë zyrës së përkthimit të Portës së Lartë. Nga vitet 1862-1864 shërbeu në administratën vendore në Janinë e më pas u transferua në Tërhallë (Thesali) e përsëri në Stamboll.

Ai mori pjesë, së bashku me Jani Vreton, Hoxhë Tahsinin, Kostandin Kristoforidhin, Pashko Vasën e Sami Frashërin, në mbledhjen e parë për caktimin e alfabetit të shqipes dhe për formimin e një shoqërie kulturore shqiptare.

U aktivizua në lëvizjen patriotike shqiptare, mori pjesë në përpjekjet për caktimin e një alfabeti të përbashkët të gjuhës shqipe dhe për formimin e një shoqërie kulturore shqiptare.

Ismail Qemali u dallua si frymëzues dhe organizator i kryengritjes kundërosmane të viteve 1910-1912 dhe për veprimtarinë e ngjeshur politike në Europë për njohjen e kombit dhe të të drejtave të tij.

Së bashku me Luigj Gurakuqin e patriotë të tjerë hartoi Memorandumin e Greçës të qershorit 1911 dhe në fund të atij viti mori nismën për organizimin e Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912.

Më 19 nëntor 1912 njoftoi bashkatdhetarët se do të mbledhej në Shqipëri një Kuvend Kombëtar.

Në këtë kuvend, që u mbledh në kryesinë e tij më 28 nëntor 1912 lexoi deklaratën e shpalljes së Pavarësisë të Shqipërisë dhe ngriti flamurin kombëtar.

Nga nëntori 1912 deri në janar 1914 ishte kryetar i Qeverisë së Përkohshme dhe ministër i Punëve të Jashtme.

Pavarësisht kushteve të vështira të brendshme e të jashtme, qeveria e kryesuar nga Ismail Qemali mori një varg masash për organizimin dhe ndërtimin e shtetit të pavarur. Në të gjitha këto veprimtari Ismail Qemali u tregua burrë shteti dhe diplomat largpamës, mbrojti me vendosmëri shtetin e pavarur shqiptar.

Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë është nderi dhe kontributi më i madh i tij ndaj kombit shqiptar. Nuk ka qenë një mision i lehtë. Udhëtimet, peripecitë që ka hasur për ta përmbushur, nuk e kanë penguar që t'i shkojë deri në fund këtij misioni. Por, edhe pas shpalljes së pavarësisë, gjatë viteve 1913-1914 është munduar të mbrojë e të zgjidhë çështjet e brendshme të Shqipërisë, ashtu si edhe territoret e saj të lëna jashtë kufijve zyrtarë.

U nda nga jeta më 24 janar të 1919, në Peruxha të Italisë. Më 12 shkurt 1919, nën një ceremoni madhështore, trupi i tij, i vendosur mbi shtratin e topit dhe i mbështjellë me Flamurin Kombëtar, u shoqërua në Kaninë, ku u varros në oborrin e Teqesë, në varrezat e familjes Vlora.

www.akad.gov.al

Akademia e Shkencave përkujton me nderim në 10-vjetorin e ndarjes nga jeta akademik Kristo Frashërin

Akademik Kristo Frashëri, personalitet i shquar i historisë, kulturës dhe arsimit shqiptar lindi në Stamboll më 4 dhjetor 1920 në një familje atdhetare nga Frashëri i Dangëllisë.

U riatdhesua familjarisht dhe u vendos në Tiranë në vitin 1927. Në vitin 1940 kreu shkollën e mesme dhe u regjistrua në Fakultetin e Shkencave Ekonomike në Universitetin e Firences. Më 1942 u burgos dhe u internua nga administrata fashiste e pushtimit dhe në vitin 1943 kaloi në rreshtat partizane.

Në vitin 1945 -1952 punoi në Bankën e Shtetit Shqiptar (sektori i kreditit). Ndërkohë ndoqi studimet e larta në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë në Institutin e Lartë Pedagogjik (1951-1955).



Prej vitit 1953 ai ishte punonjës shkencor në Institutin e Shkencave. Në vitin 1955 punoi në Institutin e Historisë e të Gjuhësisë dhe më 1957-n në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Në vitin 1966 u dënua nga politika e kohës dhe u dërgua për pesë vjet për “riedukim” si mësues në shkollën e mesme të Përmetit. Në vitin më 1971 u emërua përsëri punonjës shkencor në Institutin e Historisë, ku doli në pension (1990).

Në vitin 1997 u emërua zv.kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Kristo Frashëri ka një prodhimtari të pasur shkencore, që shtrihet në të gjitha periudhat e historisë së Shqipërisë: Antikiteti, Mesjeta, Rilindja Kombëtare dhe Koha e Sotme. Ka trajtuar tema jo vetëm nga historia politike, por edhe ekonomike, shoqërore e kulturore. Ka marrë pjesë me referate në veprimtari shkencore kombëtare e ndërkombëtare dhe ka botuar artikuj në një varg revistash shkencore, brenda dhe jashtë vendit. Akad.Kristo Frashëri është autor i kapitujve që trajtojnë historinë mesjetare të Shqipërisë dhe periudhën e Rilindjes Kombëtare në “Historinë e Shqipërisë” në dy vëllime (botim i USHT, 1959, 1965).

Në vitin 1954 ka botuar një vështrim mbi jetën dhe veprën e Sami Frashërit dhe më 1958-n një vështrim mbi Gjergj Kastriotin – Skënderbeun; më 1964-ën botoi veprën “Historia e Shqipërisë”, vështrim i përgjithshëm e i përmbledhur që nga parahistoria deri në vitin 1960” (botuar në disa gjuhë të huaja). Është autor i teksteve të historisë së Shqipërisë për shkollat e mesme gjatë viteve ’70 -’80, bashkautor i “Histoire de l’Albanie” (Lion, 1974). Më 1984-n ka botuar monografinë “Abdyl Frashëri”. Është bashkautor dhe bashkëredaktor i “Historisë së Shqipërisë” vëll. II, 1984 dhe bashkautor i “Historisë së popullit shqiptar” vëll. II, (2002). Vepra të tjera të tij janë: “Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878 -1881” (1997); “Skënderbeu – jeta dhe vepra” (2002); “Historia e Tiranës” (2004); “Burimet historike shqiptare të shek. XV për Skënderbeun” (në original dhe në përkthim shqip) (2005); “Himara dhe përkatësia etnike e banorëve të saj” (2005); “Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri dhe e themelimit të PKSH 1878–1941” (2006); “Identiteti kombëtar shqiptar” (2006); “Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë (28 Nëntor 1912)” (2008); “Historia e qytetërimit shqiptar (Nga kohët e lashta deri në fund të Luftës së Dytë Botërore)” (2008); “Historia e Kosovës. Dardania (Kosova Antike)” (2009); “Skënderbeu i shpërfytyruar “ (2009); “Bajroni në Shqipëri dhe takimet me Ali Pashë Tepelenën (Vjeshtë 1809- 2009); “E vërteta mbi shqiptarët e Maqedonisë dhe shtrembërimet e enciklopedisë së Shkupit” (2010); “Historia e Dibrës” (2012); “Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881” (2012); “Ismail Qemali - Album” (2012); “Etnogjeneza e shqiptarëve Vështrim historik” (2013); “Principata e Arbërisë : 1190-1215” (2014); “Jeta e një historiani” (2014); “Ahmet Zogu : vështrim historik” (2014); “Shqipëria në Konferencën e Paqes, Paris 1946” Vështrim Historik (2015); “Kongresi i Përmetit (24-28 Maj 1944)” Vështrim Historik dhe Burime Dokumentare (2015);

“Historia e Çamërisë” (2015).

Si pedagog i historisë së Shqipërisë në Universitetin e Tiranës dhe si punonjës shkencor ka dhënë ndihmesë në përgatitjen e historianëve të rinj.

Ka marrë dy herë Çmimin e Republikës të klasit I (1961, 1984). Është dekoruar me urdhrat “Mjeshtër i Madh” dhe “Nderi i Kombit”.

Akademik Kristo Frashëri u nda nga jeta më 31 janar 2016.

www.akad.gov.al

Përkujtojmë akademik Besim Dajën në ditën e lindjes



Akademik Besim Daja, ka qenë arkitekt, profesor i Universitetit të Tiranës dhe anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Ai lindi më 26 janar 1923 në Tiranë, ku kreu dhe gjimnazin. Nga viti 1945 deri në vitin 1951 kreu studimet e larta për arkitekturë, të cilat i filloi në Lubjanë dhe i përfundoi në Leningrad.

Është një nga arkitektët e parë të diplomuar pas Luftës së Dytë Botërore. Pas kthimit në atdhe ka qenë përgjegjës i sektorit të Arkitekturës në Ndërmarrjen e Projektmeve (1951-1953) dhe më pas u emërua zëvendës drejtor i Institutit të Lartë Politeknik (1953-1957).

Akad. Besim Daja është një nga themeluesit e Universitetit të Tiranës dhe themelues e përgjegjës i katedrës së arkitekturës (1951-1983) në Universitetin e Tiranës. Në vitet 1957-1965 ka qenë zëvendësdekan i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe dekan (1965-1970) dhe më pas ka qenë zëvendësrektor (1970-1983).

Së bashku me arkitektët më të mirë të viteve 1950, Skënder Luarasin, Anton Lufin, Sokrat Moskon, Valentina Pistolin, Koço Mihon, Klement Kolanecin etj., ai projektoi vepra të rëndësishme të arkitekturës shqiptare si: Muzeu Historik Kombëtar, Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, Pallati i Madh i Kulturës, plani urbanistik i Qytetit "Studenti", projekte të konvikteve universitare, klubi "Studenti", shtëpi banimi, shkolla etj.


Akad. Besim Daja është autor dhe bashkautor i teksteve universitare "Bazat e projektimit të shtëpive të banimit" (1986), "Projektimi arkitektonik i godinave social-kulturore" (Vëll. I, 1991) dhe "Gjeometria deskriptive" (1970), "Fjalor terminologjik i arkitekturës" (1968).

Ai është dekoruar me Urdhrin “Mjeshtër i Madh i Punës”; ka marrë titullin “Punonjës i Shquar i Shkencës dhe i Teknikës” dhe “Çmimin e Republikës” të shkallës së parë e të dytë.

Akad. Besim Daja u nda nga jeta në vitin 2006.

www.akad.gov.al

**Përkujtojmë në ditën e lindjes poetin, shkrimtarin dhe dramaturgun e shquar
Viktor Eftimi**



Viktor Eftimi është poet dhe dramaturg rumun me prejardhje shqiptare.

Lindi në Boboshticë të Korçës më 24 janar 1889. Në moshën 9-vjeçare ishte i detyruar ta linte vendlindjen e të merrte rrugën e mërgimit bashkë me familjen. U vendosën në Rumani, ku asokohe kishin vajtur shumë bashkatdhetarë. Kolonia shqiptare e Bukureshtit, u shqua si pishtar i vërtetë i përhapjes kulturore jashtë dhe brenda Shqipërisë.

Shkollën fillore e kishte filluar në vendlindje në gjuhën greke, sepse shkolla shqipe ishte e ndaluar gjatë pushtimit të egër osman. Viktori e vazhdoi shkollimin në Bukuresht, në gjuhën rumune. Atje u ballafaqua me vështirësitë e jetës, kështu që u detyrua të punonte dhe, njëherësh, të shkollohej.

Në moshën 16-vjeçare botoi vjershën e parë në revistën “Shpresa” dhe emri i tij kishte filluar të shfaqej gjithnjë e më shpesh nëpër faqet e gazetave e të revistave rumune të kohës.

Vepra e Viktor Eftimiut është e përmasave të mëdha. Në sajë të talentit të tij të rrallë, ai

shkroi në të gjitha gjinitë, poezi, poema, drama e komedi, aforizma, ese, portrete e kujtime, artikuj kritikë, romane të panumërta, madje dhe libra për fëmijë. Është dramaturg me shumë pjesë të vëna në skenë. Eftimiu shkroi në gjuhën rumune, botoi dhe i vuri në skenë veprat e tij në teatrin e Bukureshtit dhe më pas disa u përkthyen në gjuhën shqipe, u botuan dhe u vunë në skenë edhe në Tiranë. Dramat dhe komeditë e tij janë përkthyer dhe ngjitur në skenë edhe në gjuhë të tjera, në kryeqytete të Europës e më gjerë. Nuk ishte më shumë se 30 vjeç, kur u emërua si drejtor i përgjithshëm i teatrove të Rumanisë. Atij i caktuan një lozhë të veçantë e të përhershme në Teatrin Nacional të Bukureshtit.

Veprat e periudhës para Luftës së Dytë Botërore, sikundër edhe ato të mëvonshmet, përshkohen nga fryma atdhetare e humanizmi i thellë shoqëror, si romani “Dy kryqe”, novelat: “Risto Dardha”, “Katelina”, “Smail Dënusha” etj., si dhe vjersha të shumta, të cilat i përshkon malli për vendlindjen dhe për bashkatdhetarët, me të cilët kishte pasur rastin të çmallej gjatë vizitës së tij të fundit që kishte bërë në Shqipëri, në maj të vitit 1972.


Për ndihmesën shumë të madhe e të çmueshme që i ka dhënë letërsisë rumune, Viktor Eftimiu është nderuar me tituj të lartë, si akademik, kryetar nderi i Lidhjes së Shkrimtarëve të Rumanisë. Ka qenë anëtar nderi i disa akademive europiane dhe ka qenë shkrimtari i vetëm në Rumani, të cilit i është ngritur busti në të gjallë të tij.

Viktor Eftimiu ishte martuar me aktoren e famshme rumune, Anxhepsina Makri.

U nda nga jeta në Bukuresht, më 27 nëntor të vitit 1972.

www.akad.gov.al

Përkujtojmë në ditën e lindjes regjisorin dhe skenaristin e shquar Dhimitër Anagnostin



Dhimitër Anagnosti, operator, regjisor, skenarist, i vlerësuar me titullin e lartë “Artist i Popullit”, lindi në Vuno të Himarës, në rrethin e Vlorës, më 23 janar 1936.

U diplomua në Institutin Kinematografik “VGIK” të Moskës për kinooperator.

Filloi punën në kinostudion “Shqipëria e re” (1961) si kinooperator në filmat "Debatik" dhe "Toka e jonë" (1964), si dhe në xhirimin e filmave dokumentarë "Gjirokastra" dhe "Gurët dekorativë". Në filmin e parë artistik "Komisari i dritës" (1966), ish bashkautor në regji dhe kamera me Viktor Gjiken, një film ky që pati jehonë në publik, u nderua me Urdhrin “Naim Frashëri”.

Filmi i tij i parë si regjisor i pavarur ishte "Duel i heshtur" (1967), ku dolën në pah përpjekjet e suksesshme të regjisorit për të depërtuar në psikologjinë e njeriut. Më vonë Anagnosti xhirooi disa filma që tërhoqën vëmendjen e qarqeve të ndryshme për një stil të veçantë dhe gjuhë të pastër filmike si: "Plagë të vjetra" (1969), "Malet me blerim mbuluar" (1971), por filmi që shënoi një pikë kulmore në krijimtarinë e tij ishte "Lulëkuqet mbi mure" (1976).

Ky film u nderua me disa çmime kombëtare dhe ndërkombëtare. Një sukses të bujshëm patën edhe filmat "Përrallë nga e kaluara" (1987) dhe "Kthimi i ushtrisë së vdekur" (1989) në të cilët, është edhe autor i skenarit. Për disa vjet ai ka punuar edhe si skenarist dhe redaktor në redaksinë e filmit artistik. Është autor i 11 skenarëve.

Veprat e Anagnostit janë nderuar me tre Çmime të Republikës (1969, 1979, 1983), tre Çmime Ndërkombëtare (1980, 1983, 1985), nga të cilët një çmim të madh "GRAND PRIX" dhe një "Medalje ari". Eshtë fitues i tri kupave të Festivaleve të Filmit Shqiptar, si dhe i Çmimit "Aleksandër Moisiu" (1989). Ka fituar gjithashtu disa çmime për skenarët. Më 1987-n iu dha titulli "Artist i Popullit".

Në mars 1991 ai u zgjodh deputet si kandidat i Partisë Demokratike në Parlamentin e parë pluralist shqiptar. Në maj 1992 u emërua Ministër i Kulturës Rinisë dhe Sporteve. Ka drejtuar për disa vite Fondacionin "Fan S. Noli" për Kulturën dhe Artin.

Në Festivalin e 10-të të Filmit Shqiptar (10-13 maj, 1995) u nderua me "Çmimin e Karrierës".

Në vitin 2001 shkroi, dhe vuri në skenë në Teatrin Kombëtar dramën e vetme "Nata e trokitjeve në xham". Ndërsa në vitin 2005 korri sukses me filmin e tij më të fundit "Gjoleka, djali i Abazit", i nderuar me dy çmime ndërkombëtare në Itali.

Dhimitër Anagnosti u nda nga jeta më 1 shtator 2025.

www.akad.gov.al

Përkujtojmë në ditën e lindjes Elena Gjickën, personalitet i ndritur i periudhës së Rilindjes Kombëtare



Dora d'Istria (1828-1888), pseudonim i Elena Gjickës, ka qenë një figurë e rëndësishme e kulturës shqiptare dhe europiane të mesit të shekullit XIX. Është publiciste, etnologue dhe shkrimtare rumune me prejardhje shqiptare.

Prejardhja e saj është nga ngulimi labovit i Pargës. Prindërit e Elena Gjickës kishin emigruar në Rumani. I ungji, Grigore IV, ishte në Vojvodë në Vllahi. I ati Mihal Gjika, në fillim të viteve 1800, ishte ministër në Moldavi – Vllahi. Prindërit e saj, vitet e fundit të jetës i mbyllën në Pargë.

Për historinë e familjes së vet, Dora d'Istria botoi një vepër me 455 faqe me titull "Gli Albanesi in Rumania. Storia dei principi Ghica nei secoli XVII, XVIII e XIX", Firenze, 1873 (Shqiptarët e Rumanisë. Historia e princërve Gjika në shekujt XVII, XVIII dhe XIX). Ky studim pasi u botua në revistën Europea (1871-1873), në vitin 1873 doli edhe si vëllim më vete, i përkthyer në italisht nën kujdesin e Bartolomeo Çeçetit (Bartolomeo Ceccheti, 1838-1889). Në këtë përmbledhje studimesh trajtohet edhe çështja e prejardhjes shqiptare të familjes Gjika.

Që në moshë të re, Elena Gjika udhëtoi me prindërit dhe vizitoi oborret e Vjenës, të Drezdenit dhe të Berlinit. Kudo u adhuroi për talentin dhe bukurinë. Studioi në Rumani, në Itali, në Francë, në Gjermani. U mbrujt me kulturë të gjerë perëndimore në shkollat më të mira të Europës.

Në vitin 1849 u martua me princin Aleksandër Koltov Massalskij në Rusi, ku kaloi gati gjashtë vjet. Në oborrin perandorak të Nikollës I (Nikolaj Pavlovič Romanov, 1796-1855) kaloi një jetë të trazuar. U divorcua në vitin 1855 dhe u shpërngul në Zvicër. Ajo ëshë e para grua që ngjiti Malin Jungfrau. Më 1860-n bëri një udhëtim në Greqi. Pjesën tjetër të jetës e kaloi kryesisht në Itali.

Elena Gjika ishte kundërshtarë e regjimeve monarkike dhe diktatoriale. Përkushtimi i pareshtur i saj ndaj aspiratave të pakicave kombëtare në Perandorinë Austro-Hungareze, ndaj barazisë së gruas dhe ndaj arsimimit të popujve e bëri të mirënjohur në mbarë Europën e më gjerë.

Ajo bëri udhëtime dhe shtegtime të shpeshta në vende të ndryshme dhe të largëta, ku shkroi një sërë artikujsh publicistikë me mbresa nga udhëtimet, të cilët u botuan nëpër gazeta dhe revista të ndryshme si "Illustration" i Parisit, "Le Jour" i Triestes etj. Në Larousses, vëllimi VI, f. 1107, Paris 1870, thuhet se Dora d'Istria ishte "kampione e palodhur e çështjes së kombësive, e së ardhmes politike dhe shoqërore të popujve, për një jetë moderne".

Në saj të njohjes së nëntë gjuhëve të huaja, Dora d'Istria përktheu krijime nga letërsia botërore. Bashkëkohësit e saj e renditën në radhën e personaliteteve më të shquara të Europës së asaj kohe, siç ishin shkrimtarja franceze Zhorzh Sand* (Amandine-Lucie-Aurore Dupin, 1804-1876) dhe kontesha d'Agu (Marie d'Agoult Flavigny, 1805-1876). Arriti kulmin e lavdisë, ndaj princi i Rumanisë Karoli I i dërgoi "Urdhrin e shkallës I" (Bene Merenti), vlerësim ky që në Perëndim u jepej dijetarëve meshkuj.

Elena Gjika u nda nga jeta në Firence në vitin 1888.

www.akad.gov.al

Përkujtojmë në ditën e lindjes Xhorxh Gordon Bajronin, shkrimtarin romantik anglez, mik i shqiptarëve



George Gordon Byron (Xhorxh Gordon Bajron) është shkrimtar anglez, përfaqësues tipik i romantizmit europian. Ai është vlerësuar si dashamirës i shqiptarëve falë udhëtimeve të shumta në vendin tonë dhe miqësisë që kishte me Ali Pashë Tepelenën.

Xhorxh Gordon Bajron lindi në Londër, më 22 janar 1788, në një familje aristokrate të varfëruar. Kur ishte dhjetë vjeç, me vdekjen e xhaxhait të tetë, Bajroni trashëgoi titullin Lord dhe pallatin e çifligun Newstead Abbey.

Në moshën madhore zuri vendin që i takonte në Shtëpinë e Lordëve. Në vitin 1801 Bajronin e dërguan në Harrow, në shkollë, ku studioi gjuhët greke e latine, historinë dhe letërsinë angleze.

Në vitin 1805 Bajroni hyri në Universitetin Kembrixh (Cambridge). Kur ish akoma student botoi vjershat e para lirike "Orët e Ngeses". Revista zyrtare e shkrimtarëve "Edinburg Reviu", i bëri një kritikë të ashpër. Poeti i ri iu përgjigj me artikullin "Këngëtarë anglezë e skocezë" ku satirizonte letërsinë angleze të asaj kohe dhe gati gjithë poetët e njohur, sidomos ata të "shkollës së liqenit".

Udhëtimi i tij dhe qëndrimi gjatë në Greqi e Shqipëri e ka bërë Bajronin pjesë të historisë së shqiptarëve. Në korrik të vitit 1809, Bajroni njëzetenvjeçar u nis për

udhëtimin e tij të parë nga skela e Falmouthit. Angli. Mori pas një shpurë shërbëtorësh, i shoqëruar prej shokut të tij të shkollës Cam Hobhouse. Së pari zbriti në Lisbonë. Portugalia qe aleate e Anglisë në Luftën Gadishullore. Napoleoni e kishte zaptuar Europën, por Anglia zotëronte detin.

Udhëtimet ishin të rrezikshme, prandaj Bajroni vizitoi vetëm ato vise që nuk rrezikonin nga armiku. Prej Lisbonës udhëtoi me kalë 640 kilometra dhe arriti në Kadiz. Nga ky port spanjoll një luftanije angleze e solli nëpër Mesdhe prej Gjibraltarit në Maltë dhe që aty në Prevezë, në Shqipëri. Nga Preveza, Bajroni dhe Cam Hobhouse erdhën në Janinë. Vizitorët e shquar nga Anglia nuk e gjetën Ali Pashën në kryeqytet, prandaj më 11 tetor 1809 e vazhduan udhëtimin 160 kilometra të tjera në veri. Më 17 tetor u nisën në Libohovë dhe arritën në Qestorat e në Erind. Prej Erindit u nisën më 19 tetor në orën 3.30 pas dreke dhe në orën 5.00 mbërritën në Tepelenë. Pas tri ditëve si mysafirë të Ali Pashës, u kthyen po asaj udhe. Nga Janina u nisën për në Prevezë dhe së andejmi kaluan për në Greqi nën mbrojtjen e 35 shqiptarëve.

Duke u larguar nga Shqipëria, Bajroni përshkoi Akarnaninë, kapërceu pyjet aeoliane të lumit Ahelos dhe më 21 nëntor 1808 arriti në Mesolongji, ku 16 vjet më vonë do të jepte jetën për Greqinë. Bajroni u kthye në Londër në korrik të vitit 1811. Gjatë udhëimit shkroi një ditar në vargje të cilin e pagëzoi me titullin: "Shtegtimi Çajld Haroldit". Nuk kishte ndërmend ta botonte, po shokët e tij të entuziazmuar ia rrëmbyen nga duart dhe e dërguan në shtyp. Kënga e parë dhe e dyta u pritën me lavdërime të mëdha. Bajroni u zgjua atë mëngjes dhe pa se qe bërë i famshëm. Çajld Haroldi e bëri edhe Shqipërinë të njohur në gjithë botën e qytetëruar. Në këngën e parë Bajroni përshkruan udhëtimin përmes Portugalisë e Spanjës. Në këngën e dytë merret kryekëput me Greqinë dhe Shqipërinë. "Shtegtimi i Çajld Haroldit" është puna letrare më e madhja e Bajronit. Vetë autori thotë në dedikimin e këngës së katërt se është "më e gjata, më e menduara dhe më e kuptuara nga hartimet e mia". Dorëshkrimi ka këtë shënim të autorit: Bajron, Janinë, Shqipëri. Filluar në 31 tetor 1809. Mbaruar në Izmir, më 28 mars 1810.

Në shënimet e mbajtura, kur ishte në Shqipëri, për poemën "Shtegtimi i Çajld Haroldit", ai shkruante për shqiptarët: Më tërheqin shumë me atë ngjashmërinë e tyre me malësorët e Skocisë, në veshje, në pamje dhe në mënyrën e jetesës. Si kujtim ai mori një kostum tradicional shqiptar, me të cilin piktori Tomas Filips i ka bërë një portret. Ky kostum ka një histori më të gjatë. Ai aktualisht është i ekspozuar në Bowood Estates, Angli.

Bajroni u nda nga jeta më 19 prill 1824 në Greqi, ku kishte shkuar për të mbështetur luftën greke për pavarësi nga perandoria osmane. Edhe sot, ai konsiderohet si hero kombëtar grek.

www.akad.gov.al

Kujtojmë në ditën e lindjes, fizikanen, akademiken e asociuar Afërdita Veveçka



Akademikja e asociuar Afërdita Veveçka Priftaj, fizikane dhe profesore lindi më 21 janar 1948 në Berat në një familje intelektuale. U diplomua në vitin 1970 në degën e fizikës 5-vjeçare në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës dhe pas studimeve u emërua pedagoge pranë katedrës së fizikës së përgjithshme pranë këtij fakulteti, kurse pas vitit 1990 si pedagoge në departamentin e fizikës të Universitetit Politeknik të Tiranës. Në vitin 1982 fitoi gradën “Doktor i shkencave”, kurse më 1994 mori titullin “Profesor i asociuar” dhe më 1999 titullin “Profesor”. Më 2008 u zgjodh “Akademike e asociuar” pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Akad. asoc. Afërdita Veveçka ka pasur një traditë të pasur, jo vetëm në mësimdhënie, por edhe në kërkimin shkencor në fushën e materialeve, veçanërisht për nanomaterialet dhe nanoteknologjinë, falë kualifikimit pasuniversitar dhe specializimeve të shumta në universitete prestigjioze jashtë vendit, si në Universitetin e Kalifornisë së Jugut në Los Anxhelos, në Universitetin e Kembrixhit dhe të Oksfordit, të Klausthalit dhe të Erlangenit në Gjermani, në Universitetin e Limerikut në Irlandë, në Qendrën Ndërkombëtare të Fizikës në Trieste, në Institutin Mbretëror të Teknologjisë në Stokholm.

Ajo mori pjesë aktive në realizimin e disa projekteve të përbashkëta me bashkëpunëtorë në stafe të kualifikuara të institucioneve shkencore evropiane në fushën e materialeve me Universitetin e Stavangerit të Norvegjisë, me Universitetin Jagellonian në Krakov të Polonisë dhe me Universitetin e Ankonës në Itali. Gjithashtu qe koordinatorë e shumë projekteve shkencore në kuadër të Programit Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim si dhe për disa projekte të bashkëpunimit dypalësh të Shqipërisë me Italinë, Austrinë, Greqinë, Slloveninë. Falë përvojës së pasur në fushën e kërkimit shkencor, Komisioni European e ftoi si eksperte për vlerësimin e projekteve TEMPUS për thirrjen e 6-të. Ajo u zgjodh në bordin botues të revistës ndërkombëtare "Materials Science and Engineering A". Gjithashtu akad. asoc. Veveçka ka qenë anëtare e redaksisë së revistës JNTS (Journal of Natural and Technical Sciences) të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Akad. asoc. Afërdita Veveçka ka kontribuar në mësimdhënie me botimin e teksteve universitare dhe pasuniversitare, si dhe në kërkimin shkencor me botime të shumta në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Ka qenë pjesëmarrëse aktive në shumë konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

U nda nga jeta, pas një sëmundjeje të rëndë më 4 korrik 2017 në Vjenë të Austrisë.

www.akad.gov.al

Përkujtojmë në ditën e lindjes akademik Kristaq Priftin



Akademik Kristaq Prifti, profesor, historian dhe turkolog lindi në Berat më 21 janar të vitit 1932. Aty kreu edhe shkollën e mesme.

Ndoqi studimet e larta në Fakultetin e Historisë në Institutin Pedagogjik në Moskë (1951–1955). Në vitet 1955–1975 ka punuar si pedagog i Historisë së përgjithshme dhe të Shqipërisë në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Tiranës, ku ka qenë edhe përgjegjës i katedrës së Historisë (1960–1975). Në vitin 1962 ka qenë zëvendësdekan dhe në vitet 1969–1975 dekan. Ka mbajtur ligjërata në kursin e magistraturës në Universitetin e Prishtinës (1972–1980). Nga viti 1982 është punonjës shkencor në Institutin e Historisë të Akademisë së Shkencave dhe në vitin 1991–1993 drejtor i këtij Instituti. Veprimtarinë shkencore e ka zhvilluar në fushën e historisë së Shqipërisë nga periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare deri në themelimin e shtetit shqiptar, si Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Lidhja Shqiptare e Pejës, shqiptarët në periudhën e revolucionit xhonturk, lëvizja politike-kulturore në Shqipëri në prag të

Pavarësisë, Kongresi i Manastirit dhe njësimi i alfabetit të shqipes, shpallja e Pavarësisë dhe Qeveria e Përkohshme e Vlorës.

Veprimtaria kërkimore-shkencore e Kristaq Priftit u shtri edhe në historinë e Kosovës në shek. XX, sidomos në zhvillimin demografik të saj.

Akad. Kristaq Prifti është autor i disa monografive e botimeve me dokumente, si: “Lidhja Shqiptare e Pejës. Lëvizja Kombëtare 1896–1900” (1984, 2002, botim frëngjisht 1889), “Dervish Hima. Jeta dhe vepra” (1987, 1993), “Dr. Ibrahim Temo. Jeta dhe vepra” (Prishtinë, 1996), “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane 1878–1881 (Dokumente)” (1978), “Popullsia e Kosovës” (2014), “Shkrime historike për Rilindjen Kombëtare” (2016), “Genocidi antishqiptar i serbomëdhenjve” (2017); bashkautor në monografinë “Kongresi i Manastirit ngjarje me rëndësi në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare” (1968, 1978, 2004), dhe bashkëpërgatitës i vëllimit “La Ligue Albanaise de Prizren” I (1988). Është bashkautor dhe bashkëredaktor i veprës “Historia e Shqipërisë” (vëll. II, 1984), autor i një vargu artikujsh studimorë, të botuar në revistat shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Ka drejtuar gjatë viteve 1998–2007 projektin “Historia e popullit shqiptar” në katër vëllime dhe është bashkautor e redaktor shkencor i vëll. II (2002) dhe redaktor shkencor i vëll. III (2007). Është bashkëpërgatitës dhe bashkëredaktor i disa vëllimeve me dokumente e studime të Akademisë së Shkencave, si : “Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit” (1972), Sami Frashëri, “Vepra” (vëll. I e II, 1988), “E vërteta mbi Kosovën dhe Shqiptarët në Jugosllavi” (edhe anglisht: “The Throuth on Kosova”, 1993), “Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual” (dhe anglisht: “The Kossova issue – a historical and current problem”), Tiranë, 1996; bashkautor dhe bashkëredaktor i veprës “Himara në shekuj” (2004) etj.

Është dekoruar me Urdhrin “Flamuri i Kuq i Punës” i kl. I; ka marrë Çmimin e Republikës të shkallës së dytë.

Akad. Kristaq Kristaq Prifti u nda nga jeta më 10 dhjetor 2017.

www.akad.gov.al

Akademia e Shkencave përkujton presidentin historik të Kosovës Ibrahim Rugova në 20-vjetorin e ndarjes nga jeta



Ibrahim Rugova lindi më 2 dhjetor 1944 në fshatin Cercë, komuna e Istogut. Aty kreu dhe shkollën fillore. Të mesmen e kreu në Pejë në vitin 1967. Fakultetin Filozofik, dega e gjuhës dhe e letërsisë shqipe, e kreu në Prishtinë.

Gjatë vitit akademik 1976-1977 qëndroi në Paris, në Ecole Pratique des Hautes Etudes, nën mbikëqyrjen e prof. Roland Barthes-it, ku ndoqi interesat e veta shkencorë në studimin e letërsisë, me përqendrim në teorinë letrare. Bëri doktoraturën në fushën e letërsisë në Universitetin e Prishtinës në vitin 1984.

Në vitin 1996 dr. Ibrahim Rugova u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës. Në fillim ishte redaktor në gazetën e studentëve “Bota e re” dhe në revistën shkencore Dituria (1971-’72), që botoheshin në Prishtinë. Një kohë punoi edhe në revistën “Fjala”. Për dy dekada dr. Ibrahim Rugova veprimtarinë e vet shkencore e zhvilloi në Institutin Albanologjik si hulumtues i letërsisë. Ai ka qenë kryeredaktor i revistës “Gjurmime albanologjike” të këtij Instituti. Me krijimtari letrare u mor që nga fillimi i viteve gjashtëdhjetë.

Dr. Ibrahim Rugova më 1988-n u zgjodh kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, që u bë bërthamë e fuqishme e lëvizjes shqiptare, e cila kundërshtoi sundimin komunist serb dhe jugosllav në Kosovë. Më 23 dhjetor 1989 u bë që nga themelimi kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, partisë së parë politike në Kosovë, që sfidoi drejtpërdrejt regjimin komunist në fuqi.

Në bashkëpunim me forcat e tjera politike shqiptare në Kosovë, si dhe me Kuvendin e atëhershëm të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova dhe LDK-ja përmbyllën kornizën ligjore për institucionalizimin e pavarësisë së Kosovës. Deklarata e pavarësisë (2 korrik 1990),

shpallja e Kosovës Republikë dhe miratimi i kushtetutës së saj (7 shtator 1990), referendumi popullor për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës, mbajtur në fund të shtatorit 1991, qenë prelud për zgjedhjet e para shumëpartiake për Kuvendin e Kosovës të mbajtur më 24 maj 1992. Dr. Ibrahim Rugova u zgjodh President i Kosovës në mars të vitit 2002 dhe u rizgjodh edhe më 2004.

Ibrahim Rugova ka botuar veprat: “Prekje lirike, Rilindja, Prishtinë”, 1971; “Mjerim”, “Kah teoria”, Rilindja, Prishtinë, 1978, “Bibliografia e kritikës letrare shqiptare 1944-1974”, së bashku me Isak Shemëm; “Kritika letrare, nga De Rada te Migjeni me Sabri Hamitin; “Strategjia e kuptimit; “Vepra e Bogdanit 1675-1685”; etj., të cilat përmbledhen me botimin së bashku në kompletin e veprave të tij në tetë vëllime, Faik Konica, Prishtinë, 2005.

Më 1995 dr. Ibrahim Rugovës iu dha çmimi për paqe i Fondacionit “Paul Litzer” në Danimarkë.

Më 1996 dr. Ibrahim Rugova u shpall Doktor Nderi (Honoris Causa) i Universitetit të Parisit VIII, Sorbonë, Francë.

Më 1998 dr. Ibrahim Rugovës iu nda çmimi Saharov i Parlamentit Evropian.

Në vitin 1999 dr. Rugova mori çmimin për paqe të qytetit Mynster, Gjermani, ndërsa u shpall qytetar nderi i qyteteve italiane: Venedik, Milano dhe Breshia.

Në vitin 2000 dr. Ibrahim Rugova mori çmimin për paqe të Unionit Demokratik të Katalonisë “Manuel Carrasco i Formiguerra” në Barcelonë, Spanjë.

Në vitin 2004 dr. Ibrahim Rugova u nderua me Çmimin e Evropës, Senator Nderi nga Fondacioni panevropian Coudenhove-Kalergi.

U nderua gjithashtu nga Komonuelthi i Pensilvanisë (SHBA), “Mik i Shteteve të Bashkuara të Amerikës”.

Më 2004 dr. Ibrahim Rugova u shpall Doktor Nderi (Honoris Causa) i Universitetit të Tiranës.

Dr. Ibrahim Rugova u nda nga jeta më 21 janar 2006 në Prishtinë.

Në përvjetorin e vdekjes së Ibrahim Rugovës, më 21 janar 2007, Presidenti i Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu e dekoroi presidentin historik të Kosovës me Urdhrin “Hero i Kosovës”.

www.akad.gov.al

Përkujtojmë në ditën e lindjes akademik Farudin Hoxhën, projektues i disa veprave madhështore të energjitikës në Shqipëri



Akademik Kristaq Prifti, profesor, historian dhe turkolog lindi në Berat më 21 janar të vitit 1932. Aty kreu edhe shkollën e mesme.

Ndoqi studimet e larta në Fakultetin e Historisë në Institutin Pedagogjik në Moskë (1951–1955). Në vitet 1955–1975 ka punuar si pedagog i Historisë së përgjithshme dhe të Shqipërisë në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Tiranës, ku ka qenë edhe përgjegjës i katedrës së Historisë (1960–1975). Në vitin 1962 ka qenë zëvendësdekan dhe në vitet 1969–1975 dekan. Ka mbajtur ligjërata në kursin e magjistraturës në Universitetin e Prishtinës (1972–1980). Nga viti 1982 është punonjës shkencor në Institutin e Historisë të Akademisë së Shkencave dhe në vitin 1991–1993 drejtor i këtij Instituti. Veprimtarinë shkencore e ka zhvilluar në fushën e historisë së Shqipërisë nga periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare deri në themelimin e shtetit shqiptar, si Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Lidhja Shqiptare e Pejës, shqiptarët në periudhën e revolucionit xhonturk, lëvizja politike-kulturore në Shqipëri në prag të Pavarësisë, Kongresi i Manastirit dhe njësimi i alfabetit të shqipes, shpallja e Pavarësisë dhe Qeveria e Përkohshme e Vlorës.

Veprimtaria kërkimore-shkencore e Kristaq Priftit u shtri edhe në historinë e Kosovës në shek. XX, sidomos në zhvillimin demografik të saj.

Akad. Kristaq Prifti është autor i disa monografive e botimeve me dokumente, si: “Lidhja Shqiptare e Pejës. Lëvizja Kombëtare 1896–1900” (1984, 2002, botim frëngjisht 1889), “Dervish Hima. Jeta dhe vepra” (1987, 1993), “Dr. Ibrahim Temo. Jeta dhe vepra” (Prishtinë, 1996), “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane 1878–1881 (Dokumente)” (1978), “Popullsia e Kosovës” (2014), “Shkrime historike për Rilindjen Kombëtare” (2016), “Genocidi antishqiptar i serbomëdhenjve” (2017); bashkautor në monografinë “Kongresi i Manastirit ngjarje me rëndësi në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare” (1968, 1978, 2004), dhe bashkëpërgatitës i vëllimit “La Ligue Albanaise de Prizren” I (1988). Është bashkautor dhe bashkëredaktor i veprës “Historia e Shqipërisë” (vëll. II, 1984), autor i një vargu artikujsh studimorë, të botuar në revistat shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Ka drejtuar gjatë viteve 1998–2007 projektin “Historia e popullit shqiptar” në katër vëllime dhe është bashkautor e redaktor shkencor i vëll. II (2002) dhe redaktor shkencor i vëll. III (2007). Është bashkëpërgatitës dhe bashkëredaktor i disa vëllimeve me dokumente e studime të Akademisë së Shkencave, si : “Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit” (1972), Sami Frashëri, “Vepra” (vëll. I e II, 1988), “E vërteta mbi Kosovën dhe Shqiptarët në Jugosllavi” (edhe anglisht: “The Throuth on Kosova”, 1993), “Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual” (dhe anglisht: “The Kossova issue – a historical and current problem”), Tiranë, 1996; bashkautor dhe bashkëredaktor i veprës “Himara në shekuj” (2004) etj.

Është dekoruar me Urdhrin “Flamuri i Kuq i Punës” i kl. I; ka marrë Çmimin e Republikës të shkallës së dytë.

Akad. Kristaq Kristaq Prifti u nda nga jeta më 10 dhjetor 2017.

www.akad.gov.al

Përkujtojmë në ditën e lindjes shkrimtarin, përkthyesin dhe intelektualin e shquar Skënder Petro Luarasin



Skënder P. Luarasi, ishte atdhetar demokrat, luftëtar antifashist, publicist e përkthyes, veprimtar i arsimit dhe i shkollës shqipe.

Lindi në Luaras të Kolonjës më 19 janar 1900. Ishte i biri i patriotit të shquar Petro Nini Luarasit.

Arsimin fillor e kreu në gjuhën shqipe në Korçë e Negovan (1909-1911) dhe më pas studioi në Kolegjin Amerikan Robert në Stamboll (1912-1913). Vijoi shkollimin në Akademinë Easton në Nju Jork, (1914-1916) dhe më pas në Kolegjin Ndërkombëtar në Springfield në Massachusetts SHBA, 1916-1920.

Kthehet në Shqipëri si mësues i Kryqit të Kuq Amerikan në Elbasan. Më 1922-1926 ndoqi gjimnazin klasik në Fraishtadt, në Vjenë. U kthye në atdhe pas Lëvizjes së Qershorit, por u rikthye në Vjenë pas dështimit të saj për t'u diplomuar në Fakultetin e Filologjisë, Vjenë 1930.

Skënder P. Luarasi, i cili spikati në krijimtarinë letrare që në moshën 17-vjeçare, në vitet '30 ishte arsimtar, publicist, gazetar, përkthyes, dramaturg dhe si drejtues e bashkëpunëtor i disa organeve të shtypit përparimtar. Ka qenë editor-përgjegjës në revistat: "Studenti", SHBA, 1920; "Djalëria", Austri, 1927-1928, dhe kryeredaktor i

revistës “Vullnetari i Lirisë”, Spanjë, 1937, organ i vullnetarëve shqiptarë në luftën antifashiste të Spanjës.

Më 1930-1936 punoi si mësues në Vlorë, Shkodër dhe në shkollën profesionale në Tiranë.

Në vitet 1939-44 u internua nëpër kampet e përqendrimit në Francë. Kthehet në atdhe në mars të 1945-s.

Pas çlirimit të vendit, është nismëtar në themelimin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe anëtar i Kryesisë deri në nëntor 1949, kur me dënimin e Sejfulla Malëshovës u përjashtua për disa vjet nga Lidhja për qëndrimin e tij antikonformist ndaj metodave e qëndrimeve jodemokratike që ndiqte Kryesia e Lidhjes në fushën e letërsisë e të arteve e nënshtruar ndaj diktatit të partisë në pushtet.

Ishte deputet në vitet 1946-50. Më 1950-n nisi punë në ndërmarrjen e botimeve të Institutit të Shkencave. Më 1956-’60 punoi si pedagog.

Skënder Luarasi la pas rreth 20 vepra monografike dhe studimore. Për veprimtarinë e tij të shquar patriotike-antifashiste-demokratike, edukative e letrare është nderuar me urdhrat e lartë: Urdhri i Flamurit (1960) dhe Nderi i Kombit (1996).

U nda nga jeta më 27 prill 1982.

www.akad.gov.al

Përkujtojmë në ditën e lindjes akademik Teki Tartarin



Akademik Teki Tartari (1933-2007) është një nga figurat më të spikatura vetëm për kontributin në shkencën bujqësore shqiptare, por dhe në përgatitjen e brezave të tërë specialistësh të rinj dhe në modernizimin e prodhimit bujqësor e blegtoral.

Akad. Teki Tartari lindi në fshatin Vranisht të Vlorës më 16 janar të vitit 1933. Arsimin fillestar e mori në fshat, ndërsa 7-vjeçaren e mbaroi në qytetin e Vlorës. Në vijim, i doli e drejta për të studiuar në Teknikumin Bujqësor të Tiranës, shkollë që e përfundoi me rezultate të shkëlqyera falë edhe ekipit mësimdhënës, të cilët vinin aty të përgatitur në shkolla prestigjioze të Perëndimit.

Studimet e larta i bëri pranë Akademisë të Shkencave Bujqësore “Gjergj Dimitrov” në Sofje, të cilin e përmbylli me rezultate të shkëlqyera. Krahas fakultetit të zooteknisë ai vazhdoi paralelisht një fakultet të dytë, atë të filozofisë.


Punoi si pedagog, përgjegjës i katedrës së gjenetikës dhe dekan i Fakultetit të Zooteknisë (1955–1962) në Institutin e Lartë Bujqësor (sot UBT).

Më pas u emërua drejtor i Institutit të Kërkimeve të Zooteknikës (1972–1975) në Institutin e Blegtorisë (1975–1978), drejtor i Qendrës së Kërkimeve Biologjike (sot IKB, 1978–1993). Është autor i tekstit “Gjenetika” (1961, 1967, 1972, 1984), i librit “Rritja e gjedhit” (1964, bashkautor) dhe i një varg monografish si: “Hibridizimi për prodhim mishi në gjedhë, dhen e shpendë” (1984), “Gjenetika e tipareve sasiore” (1987), “Transformimi gjenetik i kulturave bujqësore” (2002, bashkautor). Ka studiuar dhe zbatuar në praktikën blegtorale të vendit kryqëzimet për prodhimin e qumështit tek lopët dhe kryqëzimet industriale për prodhim mishi tek gjedhët e dhentë, për krijimin dhe përhapjen e grurit transformant në disa mijëra ha.

Akad. Teki Tartari ka marrë pjesë në grupin hartues të “Fjalorit bullgarisht-shqip” (1959). Është dekoruar me Urdhrin “Mjeshtër i Madh i Punës”, ka marrë titullin “Punonjës i Shquar i Shkencës dhe i Teknikës” dhe “Çmimin e Republikës” të shkallës së parë.

www.akad.gov.al

Përkujtojmë në ditën e lindjes veprimtarin e shquar të Rilindjes Kombëtare Bajram Curri



Bajram Curri, "Heroi i Popullit, ishte njëri nga udhëheqësit më të mëdhenj politikë e ushtarakë të kryengritjeve popullore për Pavarësinë dhe demokratizimin e Shqipërisë, që gjithë jetën e tij ja dedikoi çështjes shqiptare.

Lindi 16 janar 1862 në Krushë të Madhe, Rahovec, të Kosovës. Ishte djalë i Shaqir Agë Currit, pjesëmarrës i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, i cili u plagos në luftën, të cilën forcat e Lidhjes shqiptare e zhvilluan kundër Maxhar Pashës, në verë të vitit 1879, në Gjakovë.

Bajram Curri ishte nënkryetar i klubit "Bashkimi" të Shkupit nga viti 1908. Ndihmoi kryengritjen e armatosur të Malësisë së Mbishkodrës të vitit 1911, duke u bërë një qëndresë të fortë ushtrive osmane në Qafën e Morinës.

Në maj të vitit 1912 u bashkua me vendimet e mbledhjes së Junikut, mori pjesë në kryengritjen e përgjithshme të armatosur, ku u shqua si një nga tribunët popullore që theu forcat osmane në Qafën e Prushit në korrikun e 1912 dhe në Fushë Kosovë. Me Hasan Prishtinën në krye, Isa Boletinin, Idriz Seferin dhe Riza bej Gjakovën në krye të forcave kryengritëse hyri në Shkup.

Në vitin 1913 qe një nga drejtuesit e kryengritjes së armatosur popullore në Kosovë kundër zgjedhës serbo-malazeze.

Më vitin 1914 mori pjesë në qëndresën kundër Revoltës së Shqipërisë së Mesme në Durrës. Po ashtu me Hasan Prishtinën, Ahmet Zogun dhe Isa Boletinin ishin organizatorë të kryengritjes antiserbe të vitit 1915.

Në vitin 1918 u zgjodh anëtar i Komitetit "Mbrotja Kombëtare e Kosovës" dhe u bë një nga veprimtarët e saj kryesorë. Në Kongresin e Lushnjës u zgjodh anëtar i Këshillit Kombëtar, i cili e caktoi ministër pa portofol të qeverisë dhe komandant të përgjithshëm të forcave të armatosura.

Veprimtaria e shumanshme atdhetare e Bajram Currit, spikati edhe në jetën politiko-shoqërore shqiptare të viteve 1920-1924. Ai dha një ndihmesë të madhe për konsolidimin e shtetit të pavarur shqiptar dhe në demokratizimin e jetës politike në Shqipëri.

Në vitin 1925 nisi një kryengritje e re, qe synonte t'i sillte vendit një regjim liberal demokratik, kurse Kosovës, shpresën për t'u çliruar e bashkuar me Shqipërinë. Në Shpellën e Dragobisë ishte përballja e fundit heroike e Bajram Currit, kur luftoi i rrethuar nga forcat qeveritare. Ai zgjodhi të mos dorëzohej.

U vra më 29 mars të vitit 1925, në Shpellën e Dragobisë nga forcat zogiste dhe agentët e shovinistëve serbë.

www.akad.gov.al

Akademia e Shkencave kujton me nderim shkrimtarin dhe përkthyesin Ernest Koliqi



Poeti, prozatori, dramaturgu, përkthyesi e studiuesi i madh i letërsisë shqipe Ernest Koliqi përkujtohet me nderim në përvjetorin e vdekjes.

Ernest Koliqi lindi në Shkodër më 20 maj të vitit 1903. Aty mori mësimet e para dhe mbaroi studimet në Kolegjin Saverian në Shkodër. Më pas u transferua në Itali për të studiuar në Brescia, ku studioi më vonë edhe në Universitetin e Padovës. Ai filloi të shkruante nën pseudonime, si Hilushi, Hilush Vilza dhe Borizani.

Në vitet 1920 dhe 1930 Ernest Koliqi ishte themeluesi i revistave kryesore në Shqipëri, si revista "Illyria", "Ora e Maleve", "Shkëndija" dhe revista të tjera, si "Shejzat" në Itali.

Në vitin 1924 mori pjesë në shoqërinë patriotike "Bashkimi", themeluar nga Avni Rustemi. Për t'u shpëtuar forcave zogiste, emigroi pesë vjet në Jugosllavi. U rikthye në Shqipëri në vitin 1929 dhe filloi punën si mësues në Vlorë e në Shkodër. U diplomua në universitetin e Padovës me tezën "Epika popullore shqiptare" (1937).

Në prill 1939 ai ishte Ministër i Arsimit në kohën e Mbretërisë së Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur kontribuoi në krijimin e bibliotekave publike në Shqipëri. Po atë vit u largua në Itali si shef i Përfaqësimit të Delegacionit të Shqipërisë.

Ai ishte anëtar i Akademisë së Shkencave të Mbretërisë së Italisë dhe profesor i Universitetit të Romës.

Nga janari 1942 deri në nëntor 1942 ka qenë drejtues i Institutit të Studimeve Shqiptare, krijuar nga vetë Koliqi, në vend të katedrës së gjuhës shqipe pranë Universitetit 'La Sapienza' të Romës.

Në fund të nëntorit të vitit 1942 ishte Kryetar Parlamenti.

Nga maji 1943 ishte kryetar i Delegacionit Shqiptar në Romë. Pas majit 1943 nuk u kthye më në Shqipëri.

Veprat e tij kryesore ndahen në disa kategori:

Prozë (Tregimet), të cilat e bënë atë të njohur si "themeluesin e novelistikës moderne shqiptare", si veprat "Hija e Maleve" (1929); "Tregtar flamujsh" (1935).

Poezi: "Gjurmata e stinve" (1933); "Symfonia e shqipevet" (1959); "Kangjellat e Rilindjes" (1959).

Roman: "Shija e bukës së mbrume" (1960).

Dramaturgji: "Kushtrimi i Skanderbeut" (1924).

Studime dhe Përkthime: "Antologjia e lirishtësve shqiptarë": Studim mbi letërsinë shqipe; Ka përkthyer në shqip kryevepra të letërsisë italiane (si Dante Alighieri, Petrarka, Ludovico Ariosto, Torquato Tasso, Giuseppe Parini, Vincenzo Monti, Ugo Foscolo dhe Alessandro Manzoni etj), vëllimi "Poetët e mëdhenj italianë".

Koliqit vazhdoi krijimtarinë e tij në Itali, ku themeloi edhe revistën e rëndësishme kulturore "Shejzat" (Le Pleiadi). U nda nga jeta më 15 janar 1975. Trupi i tij prehet në Romë.

www.akad.gov.al

Akademia e Shkencave kujton me nderim akademik Eduart Sulstarovën



Akademiku Eduart Sulstarova, një personalitet i shquar i shkencës shqiptare dhe një nga themeluesit e sizmologjisë moderne në vendin tonë, kujtohet me nderim nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, sot, në përvjetorin e ndarjes nga jeta.

Akademia e Shkencave e vlerësoi me botimin “Vepra të zgjedhura në fushën e sizmologjisë” (në katër vëllime) akad. Eduart Sulstarovën dhe me organizimin e ceremonisë së përvjetimit të veprës, si dëshmi të një rruge të gjatë kërkimore e përkushtimi.

Inxhinieri gjeofizikan, profesori dhe akademiku Eduard Sulstarova (1934–2014), lindi në Korçë. Shkollën e mesme e kreu në Tiranë. Ndoqi studimet e larta dhe u diplomua në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave (1963). U emërua në katedrën e gjeofizikës në atë fakultet dhe është një nga themeluesit e Shërbimit Sizmologjik Shqiptar. Ka qenë drejtuesi i Stacionit të parë Sizmologjik të Shqipërisë (1968) pranë UT dhe drejtor i Qendrës Sizmologjike të ASH, që nga ngritja e saj (1973–1993). E.S. ka ndërmarrë kërkime e studime për sizmicitetin e vendit e të rajonit, për vlerësimin e rrezikut sizmik në shkallë vendi dhe rajonal etj. Është autor dhe bashkautor i monografive e librave “Harta sizmike e Shqipërisë” në shkallën 1:1.250.000, “Catalogue of Earthquakes of Balkan Region - Katalogu i tërmeteëve të Shqipërisë” (1975), “Rajonizimi sizmik i Shqipërisë - Seismic Hazard of Albania” (1980) etj., si dhe i teksteve “Përdorimi i metodave gjeofizike për zgjidhjen e detyrave gjeologjike” (1971), “Tektonika dhe rilevimet. Strukturat e thella të kores së tokës” (1983). Ka botuar një varg artikujsh në revista shkencore. Ka mbajtur ligjërata në disa universitete e institucione shkencore (Japoni, Greqi, Maqedoni, Gjermani). Ka përfaqësuar Shqipërinë në organizmat ndërkombëtarë të sizmologjisë dhe ka qenë Kryetar i Komitetit të Përhershëm për Pakësimin e Riskut Sizmik në Ballkan (1985–1988), anëtar titullar në Komisionin Sizmologjik European etj. Sekretar shkencor i ASHSH (1999–2007). Ka marrë titullin “Punonjësi i Shquar i Shkencës dhe i Teknikës”.

www.akad.gov.al

Akademia e Shkencave kujton me nderim akademik Ylli Popën në ditën e lindjes



Ylli Popa (1930–2017), mjek kardiolog, profesor, akademik.

Lindi në Elbasan, ku kreu dhe Shkollën Normale. Ndoqi studimet e larta dhe u diplomua në Institutin Mjekësor-Farmaceutik të Bukureshtit (1948–1954). Filloi punën si përgjegjës i katedrës së biokimisë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës (1954–1957), më pas pedagog në katedrën e terapisë spitalore (1957–1958).

Në vitin 1958 filloi studimet pasuniversitare për kardiologji në Moskë, të cilat i përfundoi më 1961. Më pas shërbeu si kardiolog në Spitalin Klinik nr. 1, ku bashkë me Petrit Gaçen ngritën shkollën e kardiologjisë shqiptare. Në vitet 1967–1970 qe përgjegjës i katedrës së terapisë spitalore, përgjegjës i pavijonit të kardiologjisë në klinikën e propedeutikës (1970–1973), përgjegjës i katedrës së propedeutikës (1973–1983), përgjegjës i katedrës së kardiologjisë (1983–1993). Ka botuar një varg artikujsh dhe është bashkautor në tekstet “Leksione të kardiologjisë” (1986, 1988) dhe “Kardiologjia” (1991). Më 1972 futi për herë të parë në vendin tonë konceptin mbi miokardiopatitë idiopatike, çka u referua në një konferencë ndërkombëtare kardiologjike në Paris. Ka qenë kryetar për Shqipërinë i “Union Medicales Balcanique” (1987–1993) dhe anëtar i Komitetit Shqiptar të Helsinkit që nga themelimi i tij (1990).

Për 10 vite me radhë ka qenë kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (1997–2007). Ylli Popa ka qenë deputet i Kuvendit Popullor të Shqipërisë për dy legjislatura (1982–1990). Për veprimtarinë e tij shumë të dobishme në shërbim të shkencës dhe popullit është nderuar me titullin “Hero i Punës Socialiste” dhe me urdhrin “Flamuri i Kuq i Punës i kl. I”.

www.akad.gov.al

Ndahet nga jeta akademik Nexhat Daci, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë



Letër ngushëllimi

Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës

E nderuar akad. Justina Pulaj,

Të nderuar kolegë,

Akademia e Shkencave e Shqipërisë shpreh ngushëllimet më të ndjera për ndarjen nga jeta të akademik Nexhat Dacit, personalitet i shquar i shkencës, arsimit universitar dhe jetës institucionale e politike në Kosovë.

Akademik Nexhat Daci do të kujtohet për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në zhvillimin e shkencës së kimisë, për përkushtimin shumëvjeçar në formimin e brezave të rinj të studiuesve dhe pedagogëve si dhe për angazhimin e tij aktiv në ndërtimin dhe forcimin e institucioneve akademike dhe shtetërore të Kosovës.

Veprimtaria e tij shkencore, e shoqëruar me përvojë të gjerë ndërkombëtare, ka kontribuar ndjeshëm në afirmimin e shkencës shqiptare në hapësirën akademike evropiane dhe më gjerë.

Si anëtar e drejtues i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në periudhë të rëndësishme të historisë së saj, ai dha një kontribut të çmuar në konsolidimin e rolit të Akademisë si institucion kyç i mendimit shkencor dhe kulturor, duke nxitur bashkëpunimin ndërakademik, dialogun shkencor dhe ruajtjen e standardeve të larta akademike. Në periudhën kur akademik Nexhat Daci ushtronte detyrën e Kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u konsoliduan marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, të materializuara përmes protokolleve të bashkëpunimit dhe nismave të përbashkëta shkencore, duke kontribuar në forcimin e lidhjeve ndërinstitutionale dhe në bashkërendimin e komunitetit shkencor shqiptar.

Për gjithë këtë kontribut të vyer si shkencëtar e drejtues, Akademia e Shkencave të Shqipërisë pati nderin ta zgjedhe anëtar të jashtëm të saj.

Njëkohësisht, gjatë angazhimit të tij në jetën politike dhe institucionale të Kosovës, përfshirë ushtrimin e funksionit të Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, u shfaq si një figurë publike me cilësi të veçanta që e konsideronte dijen, përgjegjësinë institucionale dhe shërbimin ndaj shoqërisë si vlera të pandashme.

Në këto momente dhimbjeje, i shprehim në emër të Asamblesë së ASHSH-së, solidaritetin tonë të plotë Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ngushëllimet më të ndiera familjes së akademik Nexhat Dacit, si dhe gjithë bashkëpunëtorëve dhe kolegëve të tij.

Me respekt të thellë,

Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Tiranë, 2 Janar 2026

www.akad.gov.al